

Prof. Dr. BEQIR META

POLITIKAT SHQIPTARE DHE GREKE NDAJ MINORITETEVE MIDIS DY LUFTRAVE BOTËTORE

Shteti grek, në periudhën midis dy luftave ushtroi një presion të fuqishëm kundrejt çdo mase që ndërmori qeveria shqiptare për të vendosur autoritetin e shtetit në zonën e minoritetit grekofon dhe për integrimin e tij në shtetin shqiptar. Nga ana tjetër, ajo ndoqi me konsekuencë politikën e spastrimit etnik të minoritetit etnik shqiptar në Greqi, duke u përpjekur të shfrytëzonte çdo rrethanë e konjunkturë ndërkombëtare.

Pasi Greqia fitoi të dy Luftat Ballkanike ajo thujse dyfishoi territorin dhe popullsinë e saj, por gjithashtu ajo u bë më pak homogjene. Sipas regjistrimit të popullsisë të zhvilluar në provincat e aneksuara rishtazi, popullsia e Greqisë u rrit me 2.203.038 banorë, duke e çuar popullsinë e përgjithshme të saj në 4.734.990 banorë¹. Kështu, përshembull sipas regjistrimit të vitit 1913, Maqedonia Greke kishte 528000 grekë, 104000 bullgarë, 465000 myslimanë (një pjesë e tyre ishin shqiptarë) dhe 98000 izraelitë. Grekët në këtë krahinë përbënin vetëm 44% të popullsisë së saj.²

Elementet heterogjene të popullsisë megjithëse mund të konsideroheshin si një pengesë për realizimin e Megalidesë, në të vërtetë e përforcuan atë dhe i dhanë asaj një nuancë të re. Megalidea arriti të krijonte një Greqi të madhe dhe njëkohësisht ta bënte atë një shtet homogjen nga pikëpamja etnike.

Më 10 gusht 1920 u nënshkrua me solemnitet Traktati i Sevres midis Fuqive Aleate e Shoqe dhe Turqisë. Ai përbënte kulmin e triumfit të Megalidesë dhe realizimin e ëndrrës së vjetër pesëshekullore greke.

¹ A. Andreades, *Les Effets Economiques et Sociaux de la Guerre en Grece* (publications de la Dotation Carnegie pour la Paix Internationale, Paris: Presses Universitaires de France, 1928) f.134.

² A.A. Pallis, *Racial Migrations in the Balkans During the years 1912- 1924* në *The Geographical Journal*, vol LXVI, Nr.4 oct 1923, f.330.

Sipas këtij traktati Greqia angazhohej të siguronte mbrojtjen e plotë të jetës dhe lirive të të gjithë banorëve të saj, pa dallim të vendlindjes, kombësisë, gjuhës, racës apo fesë. Të gjithë banorët e Greqisë do të lejoheshin të ushtronin lirisht publikisht e privatisht fenë e besimin (kap I, art 2). Greqia pranonte dhe deklaronte se do të ishin shtetas grekë *ipso facto* dhe pa kërkuar ndonjë formalitet individët e kombësive bullgare, turke (ose Shqiptare) të cilët ishin rezidentë në territoret që i ishin dhënë Greqisë prej traktateve ndërkombëtare qysh prej 1 janarit të vitit 1913. Ata që largoheshin kishin të drejtë të mbanin pasurinë e tyre të paluajtëshme në territorin grek dhe mund të merrnin me vete pasurinë e tundshme të çdo lloji. Për këtë transferim, ata nuk do të paguanin taksa eksporti. (Kap. I, art. 3). Ky paragraf ka rëndësi, pasi siç do ta shohim më poshtë Greqia e dhunoi atë sistematikisht në vitet që pasuan, deri në përfundim të Luftës II Botërore, kur realizoi spastrimin e përgjithshëm e të përgjakshëm etnik të minoritetit shqiptar.

Ky ligj vijon të dhunohet edhe sot nga shteti grek, i cili nuk pranon t'u rikthejë tokën e grabitur në mënyrë ilegale e të dhunshme minoritetit shqiptar të Greqisë.

Por qysh në këtë Traktat, qeveria greke bënte një dallim thelbësor ligjor midis trajtimit të minoritetit shqiptar dhe minoriteteve të tjera. Konkretisht Greqia zotohej të zbatonte brenda tre vjetësh pas hyrjes në fuqi të këtij Traktati një sistem elektorale i cili merrte në konsideratë të drejtat e minoriteteve. Por kjo dispozitë ishte e zbatueshme vetëm për territoret që iu dhanë Greqisë pas gushtit të vitit 1914 (kap I, art. 7). Në këtë mënyrë përjashtohet nga kjo e drejtë minoriteti shqiptar i Çamërisë.

Qytetarët grekë që u përkisnin minoriteteve raciale, fetare ose gjuhësore kishin të drejtë të krijonin, drejtonin e kontrollonin me shpenzimet e tyre institucionet mirëbërëse sociale, fetare, shkollat dhe institucionet e tjera edukative, me të drejtën që të përdornin gjuhën e tyre dhe fenë e vet lirisht në këto institucione (kap I art 8). Këtë dispozitë shteti grek nuk e zbatoi ndaj minoritetit shqiptar.

Greqia angazhohej të krijonte në sistemin arsimor publik në qytete dhe distrikte, në të cilat një pjesë e konsiderueshme e

qytetarëve grekë flisnin gjuhë tjetër, lehtësira adekuate që në shkollat fillore mësimi të jepej në gjuhën e tyre. Në qytetet e distriktet, ku kishte një popullsi të konsiderueshme të minoriteteve raciale, gjuhësore ose fetare, këto minoritete do të përfitonin një shumë të caktuar nga fondet publike të shtetit, nga buxhetet komunale etj. për qëllime mësimore, fetare e mirëbërëse. Parashikimet e këtij artikulli, zbatoheshin për territoret, që i ishin dhënë Greqisë pas 1 janarit të vitit 1913, pra këtu përfshihej edhe minoriteti shqiptar. (Kap I, art 9). Por, as kjo dispozitë nuk u zbatua në vitet që pasuan. Sipas Traktateve të Sevres, Greqia zotohej gjithashtu të siguronte mbrojtje të xhamive dhe institucioneve të tjera islame. Ajo do të njihnte plotësisht vakëfet dhe do t'u krijonte të gjitha lehtësitë. Ajo nuk do të refuzonte krijimin e institucioneve të reja fetare e mirëbërëse dhe do t'u krijonte lehtësitë e nevojshme institucioneve private të kësaj natyre. (Art. 14).

Greqia prante, që artikujt e lartpërmendur për minoritetet raciale, gjuhësore e fetare përbënin detyrime ndërkombëtare dhe do të vendoseshin nën garancinë e Lidhjes së kombeve. Ata nuk mund të modifikoheshin pa miratimin e shumicës së Këshillit të L.K. Ajo gjithashtu, prante që ndonjë ndryshim pikëpamjesh për zbatimin e këtyre artikujve midis qeverisë greke dhe ndonjë anëtar të LK do të shkaktonte një diskutim më karakter ndërkombëtar në bazë të Art. 14 të Konventës së LK. Ajo prante që ndonjë problem i tillë do t'i referohej Gjykatës së Përhershme Ndërkombëtare nëqoftëse këtë gjë e kërkonte ndonjëra nga palët. Vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare do të ishte përfundimtar dhe do të kishte të njëjtën fuqi dhe efekt si ato që do të kishin subjektet e caktuara në art. 13 të Konventës (art. 16). Këtu bie qartë në sy hapësira që kishte LK në vitet 1923 – 1926 për të mbrojtur minoritetin shqiptar në Greqi dhe përse ajo nuk e shfrytëzoi këtë dispozitë.

Më 23 korrik 1923, u nënshkrua Traktati i Lozanës për shkëmbimin e popullsisë greko – turke. Qeveria greke ishte përgjegjësja kryesore, që qëllimisht nuk bëri dallimin midis shtetasve grekë me kombësi shqiptare dhe atyre me kombësi turke. Për këtë arsye, në bazë të së drejtës ndërkombëtare ajo duhej të zgjidhte dhe të korrigjonte e vetme këtë gabim. Nga

refuzimi i vazhdueshëm i saj, për të bërë këtë gjë, logjikisht, në bazë të parimeve të paritetit në marrëdhëniet ndërkombëtare, ajo nuk do të kishte në të ardhmen asnjë të drejtë të kërkonte prej palës shqiptare respektimin e të drejtave të pakicës grekofone në Shqipëri.

Pas Traktatit të Sevres, minoritetet në Greqi kapnin shifrën e 1 milion vetëve duke arritur në 23% të popullsisë së Greqisë. Ndërsa, pas shkëmbimit të popullsisë greko - turke të përcaktuara nga traktati i Lozanës gjendja ndryshoi rrënjësisht dhe Greqia bëri hapin kryesor drejt shndërrimit në një shtet homogjen. Kjo politikë, vijoi edhe në dekadat, që pasuan kundrejt të gjithë minoriteteve të tjera që nuk ishin prekur, ose që ishin prekur pjesërisht nga shkëmbimi i popullsisë greko - turke e greko - bullgare.

Tashmë, kombësia e gjuha po injoroheshin “për arsye të vështirësive të interpretimit të këtyre termave” dhe kështu u krijua një mjegullnajë e qëllimshme për të penguar dallimin dhe afirmimin e shqiptarëve, vlllehëve, serbëve, pomakeve dhe maqedonosllavëve.

Duke shkelur hapur detyrimet ndërkombëtare, shteti grek ndoqi një politikë asimiluese të spastrimit etnik ndaj minoritetit shqiptar, e cila, midis dy luftrave pati këto rezultate:

- Spastrimi i plotë etnik nga shqiptarët i viseve të Follorinës, Kosturit, Janinës, Konicës, Voshtinës duke larguar rreth 40 000 shqiptarë myslimanë³.

- U krye spastrimi i pjesshëm i Çamërisë nga shqiptarët myslimanë duke larguar rreth 20 000 vetë⁴.

- U grabitën në masë pronat dhe pasuritë e shqiptarëve të Çamërisë, i cili ishte një hap tjetër parapërgatitor për spastrimin e plotë etnik.

- Popullsisë shqiptare iu mohuan të gjitha të drejtat politike, shoqërore dhe arsimore, që i njihnin traktatet ndërkombëtare dhe kjo politikë, u përdor si argument për të vënë në dyshim karakterin dhe ndërgjegjen shqiptare të kësaj popullsie.

³ Fjalimi i Përfaqësuesit të Shqipërisë, Mehdi Frashëri në Sesionin e 50-të të Këshillit të Lidhjes së Kombeve, 5 qershor 1928, në botimin e Agim Tartarit me titull: Një rrugë ende pa krye, Tiranë, 2000.

⁴ Po aty.

Ndërsa, qysh në momentet e para të jetesës së pavarur të shtetit shqiptar u vërejtën qartë dy tendenca kryesore në politikën ndaj minoriteteve. Së pari, u ruajt gjithë statukuoja e mëparshme e jetës politike, kulturore, arsimore e sociale të minoriteteve; së dyti u bënë përpjekje për të rritur standartin e të drejtave të tyre.

Në vitin 1920, qeveria shqiptare gjendej nën presionin e fortë grek për të fuqizuar helenizimin në Shqipërinë e jugut. Drejtimet kryesore të ekspansionizmit grek ishin:

Beteja për të marrë Sarandën. Kapitali grek i fuqishëm dhe i organizuar me një mbështetje politike të fuqishme nga ana e qeverisë greke, u përpoq me të gjitha mënyrat të shtinte në dorë tregtinë dhe të gjitha objektet tregtare të Sarandës, me qëllim që t'a shndërronte këtë qytet në avanpost të helenizmit. Qeveria shqiptare u përpoq të rezistojë.

Beteja tjetër u zhvillua për Himarën, qeveria greke duke derdhur para dhe duke korruptuar shumë fshatarë, duke shfrytëzuar edhe disa elementë grekomanë, u përpoq t'i jepte kësaj krahine karakterin e një zone minoritare. Qeveria shqiptare me durim, arriti të bënte një marrëveshje të vështirë me banorët e kësaj zone, duke ulur disi presionin grek.

Nxitja e një lëvizje të armatosur në zonën e Përmetit, nëpërmjet një çete andartësh. Por, kjo lëvizje u shtyp brenda pak ditësh prej veprimeve energjike të xhandarmërisë shqiptare, dhe atdhetarizmit që tregoi popullsia e këtyre fshatrave. Qeveria nga ana tjetër ndoqi një politikë shumë paqësore ndaj banorëve të zonës së minoritetit, duke bërë kujdesin më të madh që të mos cënohej ndonjë banor i pafajshëm dhe për të mos u dhënë shkak ndonjë ngatërrese me grekët dhe me ushtritë italiane, që ishin në Shqipëri

Beteja tjetër u zhvillua për shkollën dhe kishën autoqefale shqiptare. Greqia u përpoq me të gjitha mjetet që, ajo ta pengonte procesin e konsolidimit të identitetit kombëtar të shqiptare dhe konsolidimin e institucioneve kombëtare shqiptare.

E gjithë kjo betejë, la gjurmë të vrazhda në marrëdhëniet shqiptaro-greke. Presioni grek i krijoi shumë andralla e vështirësi shtetit shqiptar dhe e mpaki reagimin e tij ndaj

politikës shtypëse, asimiluese e asgjësuese, që ndoqi shteti grek ndaj minoritetit shqiptar në Greqi.

Minoriteti grekofon i Shqipërisë dhe Minoriteti etnik Shqiptar në Greqi kishin diferenca esenciale midis tyre.

1. Minoriteti shqiptar ishte shumë më i madh në numër dhe banonte në një territor të gjerë kompakt.
2. Minoriteti shqiptar ishte një popullsi autoktone e lashtë homogjene, ndërsa minoriteti grekofon përbëhej më së shumti nga një popullsi migratore greke, vllehe e shqiptare e greqizuar në shekujt 18-19.
3. Minoriteti shqiptar, përbëhej nga pronarë ciftliqesh të mëdhenj e të vegjël dhe kryesisht nga pronarë të ekonomive të vogla bujqësore, ndërsa ashtu si shumë vite më parë, katundet grekofone kishin mbetur çifligje.⁵

Qysh kur prefektura e Gjirokastrës u bashkua me qeverinë kombëtare në shkurt të vitit 1920, Ministria e Arsimit, mori nën përgjegjësinë e saj të gjithë shkollat grekofone, dhe rriti rrogat e mësuesve, që më parë ishin paguar shumë keq, pasi ishin mbajtur me të ardhurat e kishave dhe manastireve. Ministria e Arsimit gjithashtu hapi shkolla të reja dhe shtoi klasat në ato shkolla, ku ishte e nevojshme⁶

Pavarësisht nga politika luajale e qeverisë shqiptare, qëndrimet politike të minoritetit grekofon ishin të drejtuara kryesisht nga politika greke. Kështu popullsia grekofone e Dropullit nuk mori pjesë në zgjedhjet e vitit 1921⁷

Në shkurt të vitit 1921, qeveria greke i kërkoi këshillit të L.K., që të merrte një rol specifik për mbrojtjen e minoriteteve në Shqipëri. Ajo i vuri në dukje sekretarit të përgjithshëm të L.K. se “ishte e drejta e saj që informacioni i Këshillit për ndonjë dhunim ose rrezik dhunimi të ndonjërit nga obligimet e Shqipërisë nuk do t’i bëhej vetëm anëtarëve të Këshillit të LK (siç bëhej për gjithë shtetet e tjera), por do t’i sigurohej gjithashtu edhe Greqisë e cila ishte veçanërisht e interesuar

⁵ AQSH, FMPB, 1922 dos.201 f.33-36 Raporti Prefekturës së Gjirokastrës MPB, 22 prill 1922

⁶ AQSH, F.MA, viti 1922, dos.106, f 11,MA- MPJ, 14 mars 1922.

⁷ AQSH , FMPB, viti 1921 dos. 23, f 77, Prefektura e Gjirokastrës MPB,21 shkurt 1921.

për të drejtat e grekëve në Shqipëri”. Ajo gjithashtu, po përpiquej t’i impononte qeverisë shqiptare që ta trajtonte popullsinë ortodokse shqiptare si një minoritet etnik.⁸ Greqia u përpoq që t’i impononte shtetit shqiptar sistemin e kapitulacioneve të Perandorisë Osmane, privilegjet fetare, shkollore e juridike dhe imunitetet, që u ishin dhënë popullsisë jomuhamedane të Turqisë nga Sulltanët me beretë speciale, të cilat Greqia kërkonte që të njiheshin e të respektoheshin nga qeveria shqiptare. Kërkesat greke në thelb, deformonin tërësisht karakterin kombëtar dhe unik të shtetit dhe kombit shqiptar dhe i hapnin rrugën shkatërrimit të tij dhe hegjemonisë greke.

Qeveria shqiptare u rezistoi këtyre presioneve, por nga ana tjetër ajo respektoi me rigorozitet detyrimet ndërkombëtare për minoritetet, të cilat ishin fiksuar në Deklaratën e 5 tetorit të vitit 1921, në Këshillin e Lidhjes së Kombeve.

Rezultatet historike të kësaj politike rigoroze, u provuan atëherë nga komisionet e Lidhjes së kombeve dhe nga shumë vëzhgues të huaj të paanshëm. Ata janë.

- Asnjë fshat apo banor i minoritetit i dëbuar
- Asnjë pasuri private e minoritetit grekofon e grabitur, shtetëzuar apo tjetërsuar.
- Funkcionimi i shkollave minoritare normalisht dhe ndihma dhe financimi i tyre nga shteti shqiptar në masën 70.000 – 100000 fr.ari për cdo vit për një periudhë të gjatë kohe në vitet 20-30. Numri i shkollave në fshatrat grekofone, vazhdimisht ka qenë 2 herë më i lartë se ai i shkollave në fshatrat shqiptare përreth dhe mesatares se vendit.
- Minoriteti grekofon jo vetëm që e ruajti karakterin etnik gjatë viteve 20-30 por erdhi duke e fuqizuar atë.
- Minoriteti kishte të siguruar qeverisjen lokale, dhe gjithashtu kishte akses në administrimin e vendit.

⁸ AMPJ, viti 1921, dos.87, Sekretariati i Përhershëm Grek në LK - Sekretarit të Përgjithshëm të LK, Gjeneve 8 shkurt 1921

Kuptohet, që këto rezultate ishin në kontrast të plotë me rezultatet e politikës greke, gjë që flet se Shqipëria i zbatoi detyrimet ndaj minoritetit grek në mënyrë të njëanshme, pa vendosur kriterin e reciprocitetit.

Këto rezultate historike kontradiktore të kësaj periudhe, patën pasoja të dukshme në marrëdhëniet midis dy vendeve. Ata në vend që ta kënaqnin Greqinë, në supremacinë e fituar në këtë fushë, shërbyen për të nxitur më tej shovinizmin grek që të arrinte caqe të tjera në politikën nacionaliste e ekspansioniste, gjatë Luftës së II Botërore dhe pas saj, deri në ditët tona.

Së pari: atij iu krijua mundësia për të realizuar spastrimin e plotë etnik të Camërisë në fund të Luftës II Botërore.

Së dyti : asimilimin e plotë të popullsisë shqiptare ortodokse të Camërisë e viseve të tjera shqiptare në Greqi gjatë Luftës së Ftohtë e më pas.

Së treti : Rritja e presionit për të aneksuar Shqipërinë e Jugut, i cili vijoi gjatë Luftës II Botërore dhe gjatë gjithë periudhës së Luftës së Ftohtë.

Së katërti : Krijoi mundësinë për të intensifikuar përpjekjet dhe për të siguruar një sukses të dukshëm në fushatën e pandërprerë, politike, kulturore, fetare, arsimore, ekonomike për fuqizimin e helenizmit në Shqipërinë e Jugut, Fushatë, e cila ka marrë një dimension të ri, dhe është rigjallëruar dukshëm pas rënies së regjimit komunist në këto 16 vite të tranzicionit në Shqipëri.

ENVER KUSHI

**KËNGËT E ÇAMËVE NË OPTIKËN E EKSPEDITËS
SHQIPTARO - GJERMANE TË VITIT 1957**

Duke kumtuar për një temë paksa të veçantë, që ka të bëjë me analizën nga pikpamja muzikologjike, “respektivisht muziko-etnologjike të 30 këngëve çame”, siç shprehet studjuesja gjermane Doris STOCKMANN, njëra nga anëtarët e ekspeditës shqiptaro-gjermane të vitit 1957, kam konstatuar një fakt dëshpërues: mungesën e studimeve të këtij lloji në kulturën shqiptare. Kam folur gjerë e gjatë për këtë temë me profesorin e nderuar dhe një nga miqtë e pasionuar të çamëve dhe njeri nga anëtarët e ekspeditës shqiptaro-gjermane, Prof. Ramadan Sokoli. Ai dëshpërimisht më ka pohuar faktin e mësipërm. Në muzikologjinë shqiptare mungojnë botimet në këtë fushë, siç mungojnë ekspeditat e organizuara shkencore për të incizuar dhe transkriptuar këngët e çamëve Çamëria mbeti një njollë e bardhë në hartën e muzikës popullore shqiptare. Fjalën e kam për fushën e muzikologjisë, sepse në atë të folklorit gojor kemi disa përpjekja si ato të Ibrahim Hoxhës, Qemal Haxhihasanit, Abaz Dojakës (në fushën e etnografisë dhe dasmës çame), për të arritur në punën e palodhur e të jashtëzakonshme të një njeriu modest e punëshumë siç është Fatos Mero Rrapaj. Për rrjedhojë, në relievin e çuditshëm sa origjinal dhe të larmishëm të muzikës popullore shqiptare, ndjehet mungesa e relievit po aq të habitshëm “të kulturës së çrrënjësuar me dhunë, të çamëve”, siç shprehet shkrimtari ynë i madh Ismail Kadare. Ky konstatim i përtej

dhimbshëm, ka bërë që tashmë, bashkë me brezin e parë të çamëve të shpërngulur me dhunë nga egërsia e pashembullt zerviste, në botën e Vlorës (po të përdorim kështu vargun e një kënge vaji çame, regjistruar në Babicë të Vlorës) edhe në botën e Durrësit, botën e Rrogoshinës, Elbasanit, Cërrikut, Lushnjës, Fierit, etj. janë mbuluar dhjetra këngëtarë virtuozë, dhjetëra instrumentiste dhe dhjetëra valltarë. Brezi i dytë e trashëgon këtë trashëgimi, por mendoj ajo është disi më e zbehtë, më me pak kolor, se sa ajo e gjysheve e gjysheve, nënave e baballoreve mbuluar me botën mikpritëse shqiptare.

Të huajt që kanë udhëtuar në viset e Çamërisë në fillim shekullin e 19-të e më pas, në veprat e tyre, krahas të dhënave për gjeografinë, historinë, traditat, të folmen, etnografinë etj, kanë përshkruar edhe të kënduarit si dhe vallet çame. Është interesant se thuajse të gjithë konstatojnë të njëjtën gjë: këngët e çamëve janë të veçanta, se ata dallohen për një mënyrë të kënduari impresionuese, pasionante, me shumë pathos, me një shumësi zërash që të kujtojnë koret antike, ku isoja dhe zëri apo zërat e solistëve harmonizohen persosmërisht. Kështu Lord Bajroni, në nëntor 1809, nga brigjet e Çamërisë, do të shkruante se “më të rinjtë i dhanë duart njeri-tjetrit dhe filluan të hidhnin valle rreth zjarrit nën melodinë e këngës së tyre, me një lloj dinamizmi dhe gjallërie të mahnitshme. Ishte një këngë që zgjati më se një orë. Ajo fillonte kështu:
Kur ikën nga Parga
Ishin gjashtëdhjetë

Dhe më pas, ia kthenin me iso shoqëruesit:

Të gjithë komitetët në Pargë,
Të gjithë komitetët në Pargë.

Henri Holand, në librin “Udhëtime në ishujt Jonianë, Shqipëri, Thesali, Maqedoni etj. Gjatë viteve 1812 dhe 1813” shkruan: “Këngët e tyre ishin të natyrës së luftës. Shpesh dy zëra të veçantë zbuteshin dhe nga dy variante të ndryshme, bashkoheshin në një linjë të vetme muzikore dhe harmonike, me tone të shkurtëra dhe të egërsuara. Fyelli ishte vërtetë një mrekulli, ai shfaqej kalimtar dhe i ashpër. Dukej që ai rregullonte pengesat në momentet e ndalimit të zërit të këngëtarit...”

Por ndoshta, piktori i madh Eduard Liri, në librin “Udhëtim në rajonin piktoresk të Shqipërisë” (1815), ashtu si në pikturat e tij më pamje impresionuese të Çamërisë, na ka përshkruar edhe këngët çame. Sipas tij, vija melodike kalonte përmes një përseritjeje të ashpër të korit minor, i ndarë në intervale të një ose dy zërave karakteristike që krijojnë nuanca të reja në boshtin melodik... Çdo strofë e këngës përfundonte duke iu nënshtruar ndërthurjes në një zinxhir rrotullues të vogël të shpejtë, duke përfunduar në një kor me iso Bo, bo, bo, ooo.

Në përfundim të strofës së fundit, kur idolgipsi, që dukej si diçka jo tokësore, ndërpriste zërin e tij dhe rrëmbente kapelen nga koka, duke e tundur atë me dorë në ajër, duke lënë të zbuluar kokën e tij... e në këtë mënyrë dëgjohej vetëm cyla (fyelli) në një harmoni të çuditshme dhe me bo, bo, boooo-në në një ton të ulët, duke theksuar vetëm bo-në e fundit, që vinte papritur si një e shtënë arme, e shoqëruar nga një britmë unanime e këngëtarëve...”

E bëra këtë parashtrësë, për të theksuar një fakt interesant: edhe studjuesit gjermanë në librin e tyre “Muzika popullore shqiptare – Vëllimi I – Këngë të çamëve”, arrijnë në përfundimin se “te këngët çame kemi të bëjmë me një shtresë arkaike të muzikës shqiptare” Libri në fjalë, me autorë Doris Stockmann, Wilfried Piedler dhe Erich Stockmann, botim i vitit 1965, me 302 faqe, përbëhet nga këto pjesë:

Pjesa e parë:

“Gjurmimi i muzikës popullore shqiptare deri në vitin 1957” “Ekspedita e mbledhjes shqiptaro-gjermane e vitit 1957 dhe shfrytëzimi i saj” “Vërejtje etnografike mbi çamët” të shkruara nga Erich Stochman; **Pjesa e dytë** “Gjurmime në muzikën vokale çame” e ndarë në kapitujt “Paraverejtje e të përgjithshme”, “Problemet dhe metodat e transkriptimit”, “Verejtje botimi dhe spjegimi i shenjave”, “Terminologjia”, “Figura dhe dhënia e formës e këngëve çame” “Këngë bordune polifonike”, “Këngë korale jo bordunale”, “Këngë burrash”, “Këngë grash”, “Këngë solo”,

Pjesa “Transkriptime dhe pjesa e fundit përmbajnë tekstet në variantin shqip dhe përkthimin gjermanisht.

Në qoftë se do të bënim një rikthim imagjinar gati 40 vite më parë, pra në vitin 1957, kohë kur u organizua edhe ekspedita shqiptaro-gjermane, nuk ka se si të mos ndjejmë akoma të freskëta plagët dhe dhimbjen e popullsisë çame. Është gjallë brezi që e ka parë me sytë e tij llahtarën dhe gjëmën e madhe. Fëmijët e viteve ‘44-’45 janë më të madhuar, por në sytë e tyre ruhen pamjet e tmerrshme të tragjedisë. Të vdekurit, lënë bokërrimave të tokës çame, u trokasën netëve dhe u prishin gjumin të gjallëve, trazojnë kujtimet. Por jo vetëm kaq. Është zhvendosur relievi i kulturës çame, janë zhvendosur vallet e tyre epike,

këngët, baladat, përrallat, gojëdhënat. Dhe kjo është një zhvendosje e një lloji tjetër, më pak e dukshme, por më ulëritëse dhe më tragjike se plagët e bartësve të tyre.

Sa më lart, ndihet në librin e autorëve gjermanë jo vetëm në përshkrimin që ata i bëjnë popullsisë çame të shpërngulur, por edhe në praninë e tragjedisë në këngët e regjistruara.

Inçizimi i këngëve çame është bërë në Fier, Skelë dhe Babicë të Vlorës. Këngëtarët ishin, siç pohojnë studjuesit, nga i njëjti fshat ose së paku nga e njëjta krahinë. Kështu këngëtarët e Skelës para vitit 1944, banonin në fshatrat Arpicë, Vola dhe Vaje të Gumenicës. Këngëtarët e Fierit ishin nga Mazreku dhe grupi i Babicës nga fshatrat midis Mazrekut dhe Mangëlliçit. Mes shumë të dhënave, më ka bërë përshtypje një fakt që japin studjuesit gjermanë: kur inçizuam këngë vajtimi në Babicë, këngëtarja u prek aq shumë, duke i harruar të gjithë të pranishmit, sa që neve u detyruam ta ndërpresim inçizimin. Teksti i këngës është ky:

Sha (pasha) krietë tat, babatho,

Sha kurmin tënd baba,

Ku do të të gjëjmë ne tani,

Që na lëshoe

Ore babatho e?

Do të të gjuajnë djeltë, baba:

Se neve nuku jemi në dhenë tënë babatho,

Se neve jemi muhexhirë në vend të huaj babatho,

Mos të ka pikunë vendi jot,

Se ke ardhurë në botë të Shqipërisë, Baba ore!

Do të të palosi bot' e Vlorësë,

Se ashtu e kishim të shkruarë babatho,

Sha kurmin tën, ore baba, ore,

Po qe jedh' ndo-jerë të vemi në
Në atë vatanë tën' ore, vatrëz o?
Që jemi berë muhaxhin' o,
Në botë të Shqipërisë o babatho.

Gjithësej janë 30 këngë të incizuara. Nga këto, në Fier 8 këngë ("Çelo Mezani", "Mua më ra taksimi", "Qaj me lot o Çamëri", "Kalesh' e Xhixho s", "Luli me nishan në ballë", "Ditën që u mor nisia", "Mecovë e zeza Mecovë",) në Babicë 8 këngë ("Kjo anë e lumit", "Ç'ke flamur që s'valon", "Janinë e zeza Janinë", "Ne porta të shkova", "Thirri talili në malë" "Kamerini mal me fletë", "Hiq kadale vallen'o", "E mjera merr me zë" në Skelë 14 këngë ("Ulu mal të shoh Kastrinë", "Kënga e Çelo Mezanit", "Ti moj kull' e Livadhisë", "Ti më qesh , ti me ta", "Berbaro, Vasiliko", "Moj Mine, Minusheja", "Ti fletë e lejmonit bardhë", "Ra dielli mbi bajame", "Të martën që me natë", "Trëndelo, moj trëndelinë", "Çu nis djali për kurbet", "Nani-nani more djalë", "Sha kriet tat babatho".

Duke analizuar gjerësisht "nga pikëpamja muzikologjike, respektivisht muziko-etnologjike 30 këngët çame", ata konkludojnë se ky material "përmban një të tillë larmi praktikash, stilesh dhe formash që lexuesin e njeh me pasurinë e këngëve të Shqipërisë Jugore.

Interes paraqet analiza e thellë shkencore e këngëve të mbledhura, ku dallojmë këtu këngët bordume polifone, veçoritë e kësaj mënyre të kënduari tek çamët. Ja vlen të citojmë një përfundim interesant, që të kujton përshkrimet e udhëtarëve të huaj mbi këngët çame: "Neve i kemi përmendur disa herë mënyrat e këndimit të këngëtarëve çamë, si pjesërisht emocionale, pjesërisht të përmbajtur... Këngëtarët këndojnë zakonisht me sa fuqi kanë. Gjatë

këndimit kori dhe solistët bëhen nganjëherë si të dehur (ose të dalldisur)”.

Ata analizojnë edhe këngët korale jo bordunale, që përbëjnë 6 këngë burrash dhe 12 këngë grashë. Këto këngë këndohen me një zë ose më një praktikë këndimi që ndryshon midis monofonisë dhe polifonisë.

Interes paraqesin për veçoritë e tyre tri pjesët solo: një këngë djepi dhe 2 këngë vajtimi. Të dyja këto gjini i përkasin repertorit të grave. Në librin në fjalë përmenden edhe emrat e grave, njera është 37 vjeçarja Hatixhe Qemali (Babicë) dhe tjetra Hamide Shabani, 40 vjeç nga Skela.

Vlera të mëdha për studjuesit e muzikës popullore ka transkriptimi i të 30 këngëve, bërë me profesionalizëm dhe kritere rigoroze shkencore. Po kështu edhe tekstet e botuara në dialektin çam, përveç pasurisë gjuhësore, paraqesin interes edhe për elegancën e vargut dhe mjetet shprehëse si dhe finesën karakteristike të folklorit çam.

Libri “Muzika popullore shqiptare, këngët e Çamëve”, është edhe një homazh për bartësit e folklorit të mrekullueshëm çam, një libri kujtëse gjithmonë të pagjumë e të trazuar. Ai e pasuron bibliotekën evropiane dhe ndihmon studjuesit për t’ju rikthyer këngëve të çamëve.

Prof. dr. Bashkim Kuçuku

SHKRIM-KËNDIMI DHE SHKOLLA SHQIPE NË ÇAMËRI

Çamëria gjatë gjithë historisë, deri në Traktatin e Londrës (1913) ka qenë pjesë përbërëse natyrore e hapësirës shqiptare, prandaj të gjitha proceset historike, shoqërore dhe kulturore kanë patur po atë ecuri dhe po ato karakteristika dalluese, që kanë patur edhe në trevat e tjera shqiptare. Kështu, edhe zanafilla dhe përhapja e shkrim-këndimit dhe e shkollës shqipe në Çamëri kanë qenë pjesë përbërëse e atij procesi të gjerë që përftoi shkollën shqipe në periudhën e Rilindjes Kombëtare dhe të përpjekjeve për pavarësi. Një kahje tjetër, përgjithësisht, rrënuese, morën proceset historike, shoqërore dhe kulturore në Çamëri, pasi kjo krahinë shqiptare u përfshi në shtetin grek pa asnjë të drejtë të identitetit politik, kulturor dhe arësimor. Në Çamëri, për shkak të rrethanave gjithmonë tejet të vështira, mund të flitet për shkrim-këndimin shqip dhe jo për shkollën shqipe. Sheti osmano-turk, më parë, dhe shteti grek, më pas, nuk lejuan asnjëherë që shkolla shqipe në Çamëri të ishte një institucion i vërtetë zyrtar, i mbajtur dhe i mbrojtur prej tyre. Përkundrazi, edhe kur formalisht e lejonte ligji, praktikisht mësimi dhe shkolla shqipe pengoheshin dhe ndaloheshin me mënyra nga më të ndryshmet. Edhe kur hapeshin me stërmundime ekonomike dhe sakrificë jetësh, herë ndaleshin në hapat e parë, dhe, herë të tjera, mbylleshin fare, pa arritur në ndonjë sistem arsimor, pak a shumë të rregullt dhe të plotë. Për këto arsye, arësimimi kombëtar në Çamëri, kryesisht, ka qenë për të mësuar shkrim-këndimin shqip, dhe, pak e rrallë, për të marrë dituritë në gjuhën amtare. Megjithatë, përpjekjet si për shkrim-këndimin, ashtu edhe për shkollën shqipe kanë qenë të vazhdueshme, të mundimshme gjer në sakrificë dhe vetmohim.

Përhapja e shkrim-këndimit dhe e shkollës shqipe në Çamëri, gjatë Rilindjes Kombëtare, hasi në të njëjtat pengesa e vështirësi, dhe, po ashtu, pati të njëjtën ecuri e mbarëvajtje, të paktën, si në krejt Shqipërinë e Jugut.

Në Çamëri kishte dy lloje shkollash: në turqisht-arabisht, që ishin për shqiptarët e besimit mysliman, dhe, në greqisht, që ishin për shqiptarët ortodoksë. Në krahinën e Filatiti, p. sh., më 1888, kishte një medrese (shkollë fetare) në arabisht, në qytetin e Filatit, dhe 57 shkolla nëpër fshatra, prej të cilave 32 ishin shkolla turke me 600 nxënës myslimanë, dhe 25 shkolla greke me fëmijët e ortodoksëve, kryesisht, shqiptarë,

dhe, kuptohet, nuk kishte asnjë shkollë shqipe (H. Isufi *Musa Demi dhe qëndresa çame 1800-1947*, faqe 21). Në fshatrat ortodokse të Filatit e gjetkë shkollat greke kishin filluar të hapeshin që më 1850, të cilat u shtuan dhe u hapën edhe në qytetet : Filat, Paramithi, Pargë, Margëllëç, etj. Në Janinë, sikurse dihet, ishte gjimnazi i njohur *Zosimea*, në të cilin mësimet merreshin në greqisht, turqisht, arabisht, sikurse mësoheshin edhe gjuhë të tjera perëndimore dhe lindore. Këto dy lloje shkollash jo vetëm që ruanin me mure të pakapërcyeshëm ndarjen arsimore dhe fetare midis shqiptarëve me besime të ndryshme, por edhe e nxisnin dhe e thellonin atë. Prandaj, për të formuar vetëdijen kombëtare dhe për të kapërcyer ndarjet fetare, në periudhën e fundit të Rilindjes dhe të përpjekjeve për pavarësi, veçanërisht në periudhën e Kushtetutës së Turqve të Rinj (1908-1910), edhe në Çamëri pati një lëvizje të dukshme, plot pasion dhe përkushtim, për përhapjen e shkrim-këndimit dhe të shkollave shqipe. Këto shkolla mbaheshin me të ardhurat e shoqërive dhe të klubeve atdhetare, që ishin hapur në të gjitha qytetet: Janinë, Prevezë, Filat, Margëllëç, Konispol, si dhe në jo pak fshatra. Në statutin e këtyre shoqatave dhe klubeve, hapja dhe ndihma financiare e kurseve të shkrim-këndimit dhe e shkollave të shqipes parashihej si detyrë parësore.

Më 25 gusht 1908, në qytetin e Filatit, u hap shkolla e parë shqipe në Çamëri. Në telegramin, e botuar te gazeta *Liria*, shkruhet: *Me gas të madh u apim sihariqin se sot çelëm me shumë lavdi një shkollë shqipe dhe bëmë disa fjalë mëmëdhetarisht*. Mësuesi i shkollës së parë shqipe të Filatit ishte Musa Demi, figurë e shquar e historisë kombëtare. Një ish nxënës i kësaj shkolle e ka përshkruar, kështu, ditën e parë të mësimin shqip: *në oborrin e shtëpisë ishin mbledhur shumë banorë të qytetit dhe nga fshatrat përreth, përfaqësues të administratës turke. Hymë në një nga dhomat e shtëpisë që ishte caktuar për klasë mësimi. Nuk kishte as banga dhe as dërrasë të zezë. Ne u ulëm nëpër disa çilte që ishin shtruar rreth e rrotull dhomës. Në fagen e murit ishte vendosur një flamur i vogël me shqiponjën me dy krerë në mes. Është flamuri ynë, na tha mësuesi Musa Demi, dhe e lëmonte me kujdes. Ishim gjithësej 25-30 nxënës ditën e parë të shkollës. Musa Demi na shpërndau Abetaret dhe na tha se me atë do të mësonim të shkruanim dhe të lexonim shqip* (H. Isufi *Musa Demi dhe qëndresa çame 1800- 1947*, faqe 32-33). Shkolla shqipe u hapën edhe në qytetet e tjera: Paramithi, Prevezë, Margëllëç, Konispol si dhe në fshatrat: Mazrek, Koskë, Janjar, Lopës, etj.

Përhapja e shkrim-këndimt dhe e shkollës shqipe, në dhjetëvjetëshin e parë të shekullit XX-të, është e lidhur fort me mbrojtjen e abece-së latine, që ishte vendosur në Kongresin e Manastirit (1908). Pushtuesi turk, për të lenë gjurmët e veta të përjetshme në arësimin shqip, me agjentët e vet shqiptarë, me klerikët myslimanë si dhe me policinë, përgatiti dhe shpërndau, edhe në Çamëri, Abetare me gërma arabo-turke. Për këtë pati kundërshtime të mëdha dhe të ashpra, që u shndërruan në manifestime dhe mitingje. Te gazeta *Shqipëtarë*, shkruhet: *Sapo u muar vesh në Shqipëri marrëzia e ca deputetëve për shkrimin e shqipes me gërma turqisht, mbuluan protestat nga Elbasani, Tirana, Leskoviku, Preveza e gjetkë* (*Shqipëtarë*, nr. 4, 21 janar-3 shkurt 1910). Në një letër nga Filati, botuar te gazeta *Dielli*, shkruhet: *me kërkesën e oficerëve të ushtrisë ishin dërguar në Filat disa abetare shqipe me gërma arabo-osmane-persiane. I morën me gas të madh, deshën t'i shpërndajnë si zyrtarisht falas nëpër fshatarë. Por për fat të mirë s'u a vari torbën ndonjë. Neve shqipëtarëve na gëzoi shumë kjo ngjarje, se xhonët e këtushëm (xhon turqit apo, siç do të thotë në shqip, turqit e rinj) shpresojnë se do ta çajnë vëllazërimin e Çamërisë me ca abetare të këtilla...Por u gënjyen derëzestë...Sa shtrëngohen xhonët për propagandë në Shqipëri, aq më shumë na ngjallin kombësinë tënë* (*Dielli*, nr. 42, 14.1.1910).

Më 27 shkurt 1910, në Korçë, është zhvilluar një miting i madh me mbi 12 mijë vetë për të mbrojtur shkrimin shqip me abece latine. Në këtë miting, Shoqëria *Vëllazëria* e Filatit kishte dërguar një telegram në të cilin shkruhej: *Ne do të derdhim edhe pikën e fundit të gjakut për alfabetin latin*. Po ashtu, banorët e Paramithisë shkruanin se *qëndronin vendosmërisht anëtarë të shkrimit kombëtar dhe këtë qëndrim do ta mbanin deri në fund*.

Natyrisht, shkollat shqipe u bënë qendra të vetëdijësimit dhe të identitetit shqiptar. Në një letër, të botuar te *Zgjimi i Shqipërisë*, që dilte në Janinë, shkruhet: *Kur kryeqeveritari osman në Prevezë... ndërmoi një udhëtim nëpër krahinë, i u vunë pas edhe disa nga paria atdhetare e Prevezës, ndër ta edhe atdhetari i dëgjuar Sabri Preveza. Në Margëllëç, shoqëruesit e shpunë kryeqeveritarin në shkollën shqip të qytetit, ku mësuesit me nxënësit e pritën me këngë shqip. Sabri Preveza u foli djemve dhe i uroi me një fjalë shqip. Më në fund, duke përpjekur duartë thërritën të gjithë me zëra të përqielltë: Rrofshin shqiptarët! Rrofshin shkronjat kombëtare!* (*Zgjimi i Shqipërisë*, nr.81, 31.5.1910)

Mësuesit kombëtaristë, në një pjesë të shkollave turke, futën mësimin e shqipes. Ndërsa, në disa shkolla të tjera turke, një pjesë të nxënësve i tërhoqën edhe në shkollën shqipe. Kështu, në gjimnazin turk të Prevezës zhvillohej mësimi i shqipes me 25 nxënës. Edhe në Filat, në shkollën turke ruzhdije (gjysëm të mesme) u fut mësimi i shqipes dhe, pak nga pak u shndërrua në shkollë shqipe, ku turqishtja ishte lëndë e dytë, si gjuhë e huaj. Pranë shkollave shqipe kishte edhe kurse të mbrëmjes për të rriturit.

Përhapësit e shkrim-këndimit shqip, mësuesit, nisjatorët e çeljes së shkollave, financuesit e tyre, shpesh herë kishin qenë më parë edhe luftëtarë ose organizatorë të shoqërive dhe klubeve atdhetare. Edhe klasat e mësimin ishin në shtëpitë dhe tregëtoret e atdhetarëve më të zellshëm. Disa nga figurat më të shquara të Rilindjes dhe të pavarësisë, sikurse ishin Rasih Dino, Rexhep Demi, Veli Gërra, Tahir Mete, Vesel Rusi, etj., që ishin edhe përfaqësues të Çamërisë në ngritjen e flamurit në Vlorë, ishin përhapës të Abetares, mësues dhe financues të shkollave. Rasih Dino, kryetar i dërgatës shqiptare të qeverisë së Vlorës, që shkoi në Londër për të mbrojtur tërësinë tokësore të shtetit kombëtar shqiptar, mbante me pagesë katër shkolla dhe kishte filluar ndërtimin e një shkolle në Filat. Kurse, Rexhep Demi, atdhetar dhe luftëtar i njohur i Pavarësisë, për t'u mësuar të tjerëve shkrim-këndimin shqip, në moshën 62 vjeçare ndoqi kursin për mësues në Labovë të madhe, në shkollën e Thoma Papapanos, si dhe një kurs tjetër në Gjirokastër.

Në këtë periudhë fillestare të shkollës shqipe, Çamëria i jepet pa drejtësisht shtetit grek (1913), i cili, me ndonjë përjashtim të rrallë, nuk u njohu dhe nuk u lejoi çamëve asnjë të drejtë kombëtare, politike, kulturore dhe arsimore.

Kurset apo shkollat e sapoformuara të shqipes, në vitet e fundit të pushtimit osman, nën trysinë e madhe dhe të organizuar prej mekanizmave të shtetit grek, u shpërbënë. Shkrim-këndimi shqip filloi përsëri të mësohej vetëm në familje dhe fshehtas. Qëllimi kryesor i shtetit grek ishte zhdukja e çdo shenje të identitetit kombëtar dhe shpërbërja e plotë e Çamërisë si trevë shqiptare. Shpronësimi dhe dëbimi i shqiptarëve myslimanë në Turqi dhe në Shqipëri, që përdori me të gjitha mjetet shteti grek, tronditi nga rrënjët jetesën e tyre normale. Në rrethanat e një rreziku qeniesor (ekzistencial) dhe të një shpërbërjeje të vazhdueshme, mësimi i shqipes, thuajse, ishte i pamundur. Megjithatë, në përpjekjet për të ruajtur qenien njerëzore dhe pronat e

tyre, janë edhe përpjekjet për të patur mësimin shqip. Banorët e qyteteve dhe të shumë fshatrave, herë pas here, në kërkesat e tyre, drejtuar qeverisë greke dhe Lidhjes së Kombeve, për t'u siguruar jetën dhe pasurinë, kërkonin edhe mësimin e shqipes. Deri në vitin 1936 nuk kishte asnjë shkollë zyrtare, ku të mësohej shqip. Madje bëheshin kontrolle dhe sekuestroheshin librat dhe gazetat që kishin vajtur nga Shqipëria. Shprehja kërcënuese: “ në do të lexosh shqip shko në Shqipëri”, që përdorte policia gjatë përndjekjeve dhe sekuestrimeve të librave shqip, në të vërtetë, ishte parashenja psikologjike dhe strategjike e programit që përgatitej për t'i dëbuar ata nga vendi i tyre me dhunë, më 1944. Ndërsa, në Këshillin e Kombeve, për të përligjur këtë shkelje të hapur të pakicave, përfaqësuesi i Greqisë, me ndjenja raciste të thella, e paraqiste popullsinë e Çamërisë joarsimdashëse. Përfaqësuesi i Greqisë, në Këshillin e Kombeve, më 1927, kur u shtrua problemi i shkollës shqipe në Çamëri, tha kështu: *Përsa i përket ankimit të myslimanëve të Epirit se ata nuk kanë shkollë, ai mund të shkaktojë vetëm habinë e atyre që i njohin nga afër këto popullsi. Të paaftë gjithmonë për çfarëdo kulture, duke i u shmangur sistematikisht çdo përpjekjeje intelektuale, ata e kufizojnë arësimimin e tyre vetëm në disa elemente të njohurive fetare dhe të turqishtes ose të shqipes, që u japin tradicionalisht fëmijëve hoxhët në xhami. Ata nuk kanë paraqitur kurrë kërkesa për hapje shkollash... kaq nuk e duan këto popullsi shkollimin.* (Dokumente për Çamërinë, Dituria, Tiranë, 1999, faqe 547, përgatitur nga Kaliopi Naska).

Vetëm në vitin 1937, pas shumë kërkesave dhe përpjekjeve, si të çamëve ashtu edhe të qeverisë shqiptare, më në fund, u hapën gjashtë shkolla me dhjetë mësues shqiptarë, por dhe ato me kusht që të hapeshin njëkohësisht disa shkolla greke në Himarë. Konsulli i Shqipërisë në Janinë, shkruante në njoftimin zyrtar se *fatkeqësisht në Çamëri nuk kemi shkolla shqipe në kuptimin e vërtetë të fjalës; atje janë emnue 10 mësues, të cilët kanë për detyrë me u msue gjuhën shqipe çamëve të vegjël qi mësojnë nëpër shkollat greke* (Dokumente për Çamërinë, faqe 694). Qamil Izeti, Avdul Sejko, Fejzo Beqiri, Hasan Çeço, Jahja Dauti, Avdul Zeqirjai, Shaban Kipe, Saqe Demi kanë qenë disa nga këta mësues të përkushtuar të shqipes në ato vite.

Përballë këtyre pengesave të pakapërxyeshme, për të ndihmuar, sadopak, arësimimin në gjuhën amtare, shteti shqiptar kishte hapur në Sarandë, nga fundi i viteve 20-të të shekullit XX, konviktin *Çamëria*, me afro 100 nxënës, që vinin, kryesisht, nga ajo trevë. Shumica e mësuesve

të lartpërmendur, si edhe dhjetra mësues të tjerë familjarë, që u mësonin vetiakisht të tjerëve shkrim-këndimin shqip, kishin kryer, pikërisht, shkollën e konviktit *Çamëria* në Sarandë. E tillë, ndriçuese, por edhe sakrifikuese dhe e dhembshme ka qenë historia e shkrim-këndimit shqip, në Çamëri, sikurse ka qenë edhe fati i vet popullatës së saj. Ajo, natyrisht, është pjesë përbërëse e historisë së arësimit kombëtar, në të cilën është edhe ndihmesa e vyer e të gjithë atyre që e përhapën me përkushtim, sidomos në atë trevë të martirizuar për qenien shqiptare.

VEESHJET POPULLORE TË KRAHINËS SË ÇAMËRISË

SIPAS KËNGËVE POPULLORE

Këngët popullore çame vazhdimisht kanë tërhequr vëmendjen e dëgjuesve të kategorive të ndryshme si për melosin e bukur, edhe për përmbajtjen e subjekteve të tyre. Mjafton të sjellim ndërmend këngën e Çelo Mezanit, e cila për nga vlerat historike e artistike vazhdon njësoj të na drithëroj kur e dëgjojmë ashtu si herën e parë.

Por këto këngë paraqesin interes të veçantë edhe për studiuesit e fushave të ndryshme të trashëgimisë kulturore. Kështu p.sh. Folkloristët vlerësojnë forcën emocionale dhe figurat artistike që përmbajnë tekstet e tyre. Ndërsa studiuesit e muzikës janë befasuar nga trillet e melodive të tyre, ndërkohë që krijuesit e kësaj fushe janë frymëzuar nga linjat e tyre melodike. Të gjithëve na ka pëlqyer shumë dhe e kemi kënduar në gëzimet e festat familjare këngën e bukur çame “Tumankuqe”, përpunuar nga etnomuzikologu B. Kruta.

Edhe historianët disa herë, për të dokumentuar e verifikuar ngjarje e figura historike, u janë referuar teksteve të këngëve të ndryshme. Po aq me vlerë dhe interesante janë subjektet e këtyre këngëve edhe për etnologët. Veçanërisht kur mungojnë dokumentet e shkruar dhe kur kujtesa popullore nuk arrin në thellësi të shekujve termat dhe përshkrimet e fiksuara në vargjet e këngëve popullore të zhanreve të ndryshëm, shërbejnë si burimet e vetme dhe me mjaft vlerë për të dokumentuar historinë e zhvillimit të veshjeve popullore të mbajtura nga popullsia çame në periudha të ndryshme. Njëherazi nëpërmjet tyre informohemi edhe për nivelin e zhvillimit ekonomik e kulturor të kësaj krahine si dhe për zakonet, ritet, ceremonitë e ndryshme familjare, burimet ekonomike, gatimet tradicionale, veglat muzikore, vallëzimet popullore etj. etj.

Duke shpresuar se takime kulturore shkencore si ky i sotmi do të zhvillohen përsëri, kësaj here do të ndalem në paraqitjen e disa të

dhënave që dëshmojnë për veshjet popullore të mbajtura në qytetet dhe fshatrat e ndryshëm të krahinës së Çamërisë.

Kur popullsia e kësaj krahine u detyrua të largohet nga trojet e saj, të vetmen pasuri që nuk mundën t'ia përvetësojnë, ishte kujtesa e tyre në të cilën ruheshin zakonet, traditat, këngët, vallet, veshjet popullore, ngjarjet e ndryshme familjare e ato shoqërore etj. Për fat të mirë një pjesë e tyre arritën të fiksohen në fletoret e shënimeve apo të incizohen nga studiuesit e Institutit të Folklorit në fillim të viteve '60 të shek. XX, kur ajo kujtesë ende nuk ishte mbuluar nga pluhuri i harresës. Midis këtyre studiuesve ndihmesë të madhe ka dhënë folkloristi i mirënjohur Q. Haxhihasani, i cili arriti të gjurmojë e të regjistrojë dëshmi të shumta të krijuara në qytete e fshatra të ndryshëm të Çamërisë.

Pikërisht në këto materiale, të cilat ndodhen në ruajtje pranë arkivit të shkruar të IKP, janë mbështetur për hartimin e këtij shkrimi.

E dimë se popullsia e Çamërisë deri në fillim të shek. XVIII në masën më të madhe, ishte e besimit ortodoks. Pas kësaj periudhe feja islame gradualisht u bë fe mbizotëruese, vecanërisht në zonat fushore. Tashmë jo vetëm orientimi politik por edhe ai ekonomik, tregtar dhe kulturor ishin kthyer kryesisht nga kryeqendra e Perandorisë, ashtu siç ishin orientuar edhe krahinat e tjera shqiptare, por edhe ato të vendeve të tjera ballkanike. Në qytetet çame të asaj kohe dukshëm ndjehej prania e kulturës orientale në shumë aspekte të mënyrës së jetesës, përfshirë edhe modën e veshjeve që siç dihet përhapet më shpejt se çdo gjë tjetër.

Veçanërisht në fillim të shek. XIX në qytetet kryesore të Çamërisë si në Janinë, Filat, Gumenicë, Prevezë, Pargë, Paramithi etj, që krijuar një elitë shoqërore që dëshironte të jetonte me salltanete të njëjta, si ato në qendrat e zhvilluara të perandorisë. Këtë prirje e vërejmë edhe nëpërmjet vargjeve të këngëve popullore çame. Sipas tyre personazhet e shtresave të pasura të qyteteve të lartpërmendura që sjellin jehonën e kësaj kohe jetonin në mjedise të pajisura "me çilte e kadife", të qëndisur

me fije ari e të mbuluara me pëlhuara mëndafshi, ndërsa tavanet dritaret dhe dollapët e vendosura në mur, përshkruhen të zbukuruar me gdhendje artistike në dru. Ndërsa gratë dhe nusët në ditën e dasmës paraqiten të veshura në mënyrë luksoze sipas modës orientale të asaj kohe, e cila përbëhej nga çitjanet apo tumanet e qepura me pëlhuara prej mëndafshi nga këmishët e mëndafshita, të endure në avlëmend shtëpiak e të zbukuruara me oje e dantella, nga anteritë, xhybet, sakotë, jelekët e qëndisur me fije ari apo argjendi, llojet e brezave të punuar me filigranë, këpucët apo pantoflat e zbukuruar me fije ari, njësoj si xhybet dhe anteritë.

Gradualisht veshjet e modës orientale u përhapën edhe në shtresat e tjera të popullsisë qytetare, ndërsa në fshatra, kjo modë u përhap më vonë ose pëlqej më shumë ditën e ceremonialit të dasmës kur lipsej më shumë se kurrë ai luks e shkëlqim i krijuar nga zbukurimet e bëra me fije ari e argjendi. Në veshjen e përditshme ndikimi i kësaj kulture ndjehej më pak

Në një këngë të kënduar në Arpicë thuhet:

Hiqe kadale vallen-o, moj si zezë;

pluhuron çitjanet-o, moj si zezë;t'i bie beu që të ka, haj sako, haj dullama...

Një tjetër e kënduar në Prevezë, thotë:

terëzi do bëhem

t'u pres kondoxhupet (xhybe me gëzof (A.Onuzi))

Ndërkohë sipas dokumenteve të shkruara gratë ortodokse çame, por edhe ato të disa familjeve qytetare të besimit mysliman visheshin me fustane të gjatë prej kadifeje ose funde të shoqëruara me sako sipas modës perëndimore të kohës. Por nuk mungojnë edhe xhybet apo anteritë e qëndisura me fije ari. Këtë fakt e dëshmojnë edhe disa këngë dasme në vargjet e të cilave përmenden këto pjesë

P sh. Diku thuhet kështu:

Si e kish fustanë? Mëndafsh Prevezhanë (i prodhuar në Prevezë
A.Onuzi)

Ose : Dil moj të të shoh gjerdhanë

Fustan me kërcof të larë

Qëndisur gajtan-gajtanë

Ndërsa në një këngë tjetër thuhet:

Hiqe vallen me javash

Fustan kuqa me mëndafsh....

Sipas disa këngëve të kënduara në Margëlliç, informohemi se gratë visheshin disa me fustane e disa me tumane prej atlas, shoqëruar me këmisha të qëndisura me fije metalike, me jelek, mitanë gjithashtu të zbukuruara me sërma.

Përsa i përket veshjes së burrave edhe nëpërmjet këngëve vërtetohet se veshje mbizotëruese ishte ajo me fustanellë, e cila bën pjesë në fondin e vjetër të veshjeve popullore shqiptare. Është pikërisht kjo veshje e përhapur në të gjitha krahinat e banuara nga shqiptarët. Veç fustanellës në vargjet e këngëve gjejmë të përmenden edhe pjesë të tjera si:

O Vasil, ore kristian

Hire jashtë në liman

Veshe shark'edhe fustan

Edhe pëshline kadife

Ose:

Mino, mos më dil te lëmi

Se të sheh silahergjëndi

Pjesë shoqëruese të veshjes së burrave çamë ishin edhe armët.

U do shes armët e mia

Fushekllek edhe harbia

Në një këngë dashurie veç poezisë së bukur, bien në sy edhe pjesët e veshjeve, të përdorura nga burrat, të cilat bëjnë pjesë në fondin e veshjeve tradicionale shqiptare

Ka vatur vasha në krua

Të më lanë fistanë mua
Erdhe m'u kumise pranë
Më zbërtheve dullamanë

Me interes janë dhe dëshmitë që specifikojnë veshjen e komitëve:

Hate Resul Varfanji
Veshe një fustan të zi
Bëre lart për Revani

Në këngë të tjera përmenden silahet, qostekët, dizget, fermeletë, sherqet e barinjve, pëshlitë, llojet e festeve etj. Etj.

Në këngët e kënduara në zonat baritore, vërejmë se ndikimi i modës orientale në veshje është më pak i pranishëm, si në veshjen e burrave dhe të grave. Veshja e grave sipas përshkrimit në vargje, rezulton si ajo e paraqitur në gravurat e periudhës së parapushtimit turk, me këmishë të gjatë dhe sherqe apo lëkurçe. Edhe pse në ndonjë rast për emërtimin e tyre përdoren terma në gjuhën turke, pjesët e veshjes i përkasin tipit të veshjeve popullore shqiptare.

Gjithsesi këngët e bukura popullore çame mbeten edhe si një burim i pasur për të dëshmuar për kulturën materiale të kësaj krahine me trashëgimi kulturore tepër të pasur e të larmishme.

Prof. Dr. Afërdita ONUZ

Tirane, 20.12.2006

TITULLI: KONTRIBUTI CAM NE VISARIN BOTEROR

Sami Frasheri diku ne enciklopedine e tij “Kamus’ul Alam”, “Fjalori I Botes”, duke folur per shqiptaret, thote se camet jane me te zgjuarit e toskeve, dhe kur flet direct per ata vete I shquan per inteligjencen dhe mencurine e tyre, ndersa Robert d’Anzheli ne librin Enigma duke shkruar per Epirin e konsideron ate si “djepi I burrave te medhenj” ne Bizant e me gjere gjate historise, I cili vec personalitete te shquara ka nxjerre. Cameria apo e thene ndryshe Epiri, ka qene vater trimerie por edhe nje vater diturie qe e ka deshmuar kete ne shekuj deri ne ditet tona. Ajo I ka dhene jo vetem kombit shqiptar personalitete te spikatura por edhe mbare botes. Ndiheza e saj ne raport me territorin qe ze dhe popullaten qe e banon eshte do te thoshim e jashtezakonshme. Le ti referohemi fakteve.

Cameria I dha botes dy stratege te medhenj ushtarake. Njeri Aleksandri I Maqedonise shkoi deri ne Indi. Cam nga e ema, Olimbia ai mori me vete ne fushatat e veta ushtarake dhe camet. Ata ishin nder gjeneralet me te mire te tij si Lagosi. Ne kthim nga India nje pjese e ushtrise se tij perfshi edhe camet u vendosen ne pllajat e Indokushit ne Afganistan ku pasardhesit e tyre jane edhe sot dhe kane ruajtur deri vone perkatesisht shqipen e lashte. Pirroja I Epirit me trupat e tij dhe elefantet u erdhi ne ndihme vellezerve te tij iliri te Tarantos ne Itali dhe u kalli tmerrin romakeve. Ishte gjak cam nga Ledheza e Gumenices si mbare dinastia e tij qe sundoi per shekuj ne Epir.

Shqiptaret dy here I kane kontribuar Egjyptit me dy dinasti, nje ne kohen e re me Mehmet Aliun e Oparit qe ringjalli dhe lulezoi Egjyptin ne kohen e re, ekonomine dhe kulturen e tij e cila vazhdoi nje shekull e gjysem deri ne 1952 dhe ne lashtesi per rreth 3 shekuj dinastine came te Ptolemejve gjate se ciles u krijua qyteti I Alkesandrise me biblioteken dhe akademine e vet. Dhe per tre shekuj para eres sone dhe ne fillim te saj lulezuan vec zhvillimit ekonomik edhe shkencat dhe dijet. Ky lulezim vazhdoi edhe ne sundimin romak edhe per 3-4 shekuj te tjere. Shkolla Aleksandrine e famshme e dijes ka ne themel ndihmesen e kesaj dinastie came per shqiptarsine e se ciles na sigurojne dy eruditet tane, Sami Frasheri dhe Faik Konica. “Ptolemejte ishin fjeshte came, shqiptare” do te shkruaje Samiu. Nuk eshte rastesi qe nje dijetar nga Aleksandria me culture helene si Klaud Ptolemeu do te permende per here te pare ne histori Albanet dhe qytetin e tyre Albanopolis. Ne mendojme se ky duhet te jete nje pinjoll I deres came te Ptolemejve, nje sternip I tyre por per kete duhen bere kerkime.

Cameria I dha Krishterimit ne fillimet e tij nje Pape si Shen Eleuteri (Lefteri= greqisht Liria) ne shekullin e dyte I cile e coi Krishterimin deri ne Angli. Nje shenjtor tjetër I Kristianizmit eshte Shen Donati (shekulli IV) . Populli e perjetesoi duke ja dhene emrin nje qyteti atij te Paramithise, I cili ne kohën bizantine dhe ate osmane u njoh me emrat Ajos Dhonatos apo Ajdonat. Cameria eshte ajo qe I dha Bizantit dhe Patriakanes se Stambollit shume personalitete ne shekuj dhe mijevjecare por ne po permendim vetem patrikun Atenagora, I cili vdiq ne 1972 dhe ishte nga nje fshat I Konices as dy hapa matane kufirit shqiptare, perballe me Leskovikun . Ne bashkepunim me Papen Gjon Pali Katert ai u perpoq per afrimin e Kishes Ortodokse me ate Katolike dhe kudo manifestoi shqiptarizmin e tij dhe faktin qe ishte bir I Epirit, I Camerise.

Qysh prej plot 450 vjetesh ne Manastirin e Troickut ne periferi te Moskes ku eshte qendra e Kishes Ortodokse Ruse, digjet nje qiri qe nuk shuhet kurre ne nje ode te tij. Ne te sipas deshmitareve okulare ruhen reliket e humanistit shqiptar me fame boterore te Rilindjes Evropiane, Mihal Artioti- Trivoli, I njohur ne Rusi dhe me emrin Maksim Greku (ne kuptimin Ortodoksi). Ky shenjtor I Kishes Ruse , bir I Artes se Camerise ka dhene nje kontribut te jashtezakonshem me mbi 150 veprat e tij, Kishes dhe kultures Ruse dhe asaj mbareboterore. Veprat e tij I gjen te botuara vec rasishtes ne gjuhët kryesore te Evropes por per fat te keq, s'ka asgje prej tyre ne shqip, ndonese ai ka folur edhe per Skenderbeun dhe se harroi kurre atdheun e tij. Familja nga rridhte ishte nje familje fisnike aristokrate shqiptare e camerise, qe kishte stemen e vet, kishte nje biblioteke te pasur me libra per te cilen familja e Mediceve te Firences dhe zatem kjo u be shkak qe djali I ri Mihali te studioje ne shkollat me te mira humaniste te kohes si ne Itali, France, Spanje etj. Mihal Artioti eshte nje vigan I mendimit humanist boteror qe pret studiuesit e rinj te vepres se tij te lavdishme. Mos lejohet qe me emrin dhe vepren e tij te mburren te tjeret sic eshte bere deri me sot, por te zotet e punes, camet shqiptare....

Te dy nga trojet e Epirit, Camerise dhe Mehmet Esat Janinasi dhe Jani Koduni. I pari ne shekullin XVIII filozof dhe dijetar do te perktheje ne osmanisht me celjen e shtypshkronjes se pare osmane (afersisht ne nje kohe me ate te Voskopojes) nga Ibrahim Muteferrika komentaret e vepres se Aristotelit te bera me competence te plote nga humanisti I Rilindjes Evropiane Jani Koduni ne latinisht. Te dy bota I kujton se jane njeri turk dhe tjetri latin por te dy as me shume dhe as me pak jane shqiptare te Epirit "Ka Cameria" , sic do te shprehej ndonje cam "gjaku ine". Ironi e fatit! C'te thuash!

C'te them per Evgjen Bullgarin, camin ortodoks I cili eshte njeri nga themeluesit e Akademise Ruse te Shkencave, nje pus dijesh, nje nga me te diturit e kohes se vet. Vec e shpreh keqardhjen qe e njohim pak shume pak per te mos then aspak Fqinjët tane kete filozof dhe erudite te kombit tone nuk mungojne ta lakojne ne te gjitha rasat si te vetin.

Emri I Profesor Hoxha Hasan Tahsin Filatit eshte I degjuar per auditorin shqiptar por vepren e bemat e tij te nivelit boteror ne Perandorine Osmane e ne France pak I njohim. Nje personalitet qe krijoi Universitetin I Osman, nje perfaqesues I shtetit Osman ne France qe njihej personalisht dhe me Napolonin III, me akademiket e Frances se Kohes, me shkencetare te kalibrit te Lauavazerit qe futi dijet dhe shkencat e reja I pari ne krejt perandorine, nje kryemesues I tere rilindasve shqiptare, nje personalitet qe do te krenohej cdo shtet po ta kishte te vetin dhe sdo te kishte lene asnje presje te tij pa studiuar. Sokrati I Greqise se lashte nuk shkroi vete asnje germe por ai ka mberritur deri ne ditet tona sepse ishte nje korife I dijes. I tille ishte dhe Hasan Tahsini yne I cili nuk la vepra ne perputhje me dijet e tij, por edhe ato qe la me turp duhet ta themi, pak I njohim per te mos thene ndonje fjale me teper... Kete kryerilindes nuk na falet te mbetet keshtu. Shteti Francez, pa u shkarkuar mire nga posti I rektorit te Universitetit te Stambollit, I propozoi ta bente rector te Universitetit te Bordose. Hasan Tahsinin I Filatit kaloi nje pjese te jetes ne Perendim dhe e perfundoi ne Lindje te Europes ne Stamboll. Dora d'Istria, bashkekhohesja dhe bashkevendesja e tij me rrjenje nga Parga e Camerise kaloi nga Lindja ne Perendim ne tere Evropen Perendimore dhe vdiq ne Firenze te Italise. Ajo dha nje ndihmese ne fushen e letrave jo vetem per shqiptaret por per mbare Ballkanin dhe per kombet e Evropes. Kjo grua famoze njihej me personalitetet me te shquar te Evropes Perendimore e me gjere, akademike, shkrimtare, publiciste etj. Dhe I hyre bile qe ne te gjalle te vet ne enciklopedite e Evropes, per me teper ishte grua shkencetare. Camet me krenari mund te thone "Ishta ka Epiri". Xhaxhai I saj Jani apo I njohur ne Rumani si Jon Gjika eshte themelues I Akademise Rumune te shkencave dhe perkrahes dhe mbeshtetes I pakursyer I shoqatave shqiptare ne Rumani gjate Rilindjes Kombetare.

Do te shkonte gjate te flisnim per stratiotet came qe dhane ndihmesen e tyre me gryken e armeve ne shtetet e ndryshme Evropiane dhe ja zbardhen faqen dhe I ngriten lart emrin e shqiptarit dhe te camit.

Nuk mund te la pa permendur vellezerit Zosimea, shqiptare te Janines qe punuan dhe jetuan dhe vune pasuri ne Rusi, ne Odese. Ata ngriten nje vater diturie te kultures helenike, ne gjuhen greke qe ishte gjuhe e kultures per mbare Ballkanin sic qe latinishtja ne Perendim dhe arabishtja ne Lindje. Te tjeret nuk mungojne ti pervetsojne sic I kane pervetesuar deri me sot. Gjimnazi I famshem "Zosimea" I Janines ishte shkolla e ngritur nga camet shqiptare per camet, per veten e tyre pra shqiptaret ne nje gjuhe te kultures se kohese sic qe greqishtja. Aty u shkolluan nje pjese e rilindesve tane si Jani Vreta, Ismail Qemali, Vellezerit Frasheri perfshi dhe camin e madh Abedin Dino. Detyra jone eshte te nxjerrim ne shesh te verteten..

Abedin Dino qe u be minister I jashtem I Perandorise Osmane dhe ishte njekohesisht kryetar I lidhjes se Prizrenit per Jugun shqiptar beri cmos qe cameri te mos ndahej nga Shqiperia dhe bashke me camin tjetër

Hoxha Tahsin ja arriten. Te njejte gje berit 30 vjet me vone I biri, Rasih Dino ne Londer por pa sukses. Diplomacia Evropiane e kishte dhene verdiktin. Cameria kaloi ne duar te huaja ne 1912 sadoqe camet dhe leberit e lane me gjak Janinen por Rasih s'u terhoq, bashke me te bijen e tij me te madhe Lejlane qe ishte ndihmese, sekretare, keshilltare, perkthyes etj. ne Konferencen e Versajes do te bente te pamunduren te shpetonte Camerine. Pasurine e vet e beri zero vec te shpetonte Cameria. Me kot. Veshi I Evropes ishte shurdh dhe oreksi I fqinjit tone s'kishte kufi si dje dhe sot. Epopeja e Dinove per Camerine s'mbaron me kaq. Djali I madh I Rasih, Ali Dino, piktor I shquar do te mbronte ceshtjen came nga brenda parlamentit grek (si deputet I tij). "Gjysma e Epirit ka shkruar ne kujtimet e tij, vellai I tij me I vogel, piktori I madh Abedin Dino ka qene prone e familjes sone". Gjithe Cameria e coi ne banesen e fundme ne Athine kur vdiq, birin e saj qe mbrojti te drejtat e saj legjitime. Fatkeqesisht ne s'dime asgje per Dinot e brezit te trete qe u shkrine per komb e atdhe per Camerine. Ali Dino ka qene karikaturisiti me I madh dhe nje nga piktoret me te medhenj te Greqise dhe pati nderime te shkalles siperore nga shteti Grek.

Ne Panteonin Grek ku shumica e figurave jane te gjakut shqiptar ka dhe shume came por une por permend vetem dy: Marko Bocarin e Sulit dhe Kostandin Kanarin e Parges. Bemat e tyre jane shkruar me germa te arta ne historine greke dhe ate shqiptare. Keta jane sic thote populli ne menyre lapidare "Trimat e Shqiperise qe I dhane lirine Greqise".

Ndihmesa Came per Greqine eshte e jashtezakonshme. Nuk ka liber qe mund ti perfshije. Niko Stillo studiues nga Preveza qe jeton ne Gjermani., shqiptar I qytetit me jugor te trojeve etnike ne librin e tij "Historia e Shenjte e Arvaniteve" tregon se mitologjia greke me fame boterore eshte ngritur mbi shpinen apo ka ne themel mitologjine came. Po ne kete liber ai sqaron se Jazoni ne legjenden e Argonauteve tregon se ishte nga Cameria Epiri. Ai njihet si "njeriu me nje sandale". Sandalja e tij tjetër mbeti ne Amerike. Ai eshte eksploratori I pare I Amerikes ne lashtesi. Camet zbuluan qe ne lashtesi kontinentin e tij. Ne perforcim te kesaj teze qe argumenton shkencerisht studiuesi Niko Stillo mund t'ju them se dihen lidhjet e cameve sikurse Ulqinakeve dhe midis tyre, me detin. Ata I kane rene kryq e terthor deteve dhe oqeaneve dhe ne arkivin tone te shtetit disponohen dokumenta qe tregojne se detaret Came dhe Ulqinake kane shkuar me Tartanat e tyre (anije me vela) deri ne ngushticen e Malajes, ne Indonezi ne Java e Sumatra dhe matane oqeanit Atlantik.

Sot sa kapercen kufirin nga Konispoli ne Sajadhe (Ne Cameri Greqi), banoret e kufirit shkojne per te nxjerre buken e gojes perditte, por ne mesjete skela e Sajaves ka qene nje port ku prodhoheshin anije te medha . Norvegjia vinte bente e veta aty se kishte kantiere te medha per ndertimin e anijeve.

Nuk mund te le pa permendur atdhetarin Refo Capari qe ka bere hymnin e Federates "Vatra" ne Amerike. Eshte po ky Refo qe ka dhene nje ndihmese te madhe ne fene boterore te Bahait dhe e ka perhapur ate ne Shqiperi duke perkthyer dhe librat fetare te saj nga Anglishtja ne Shqip.

Sic ishte Kosove deri dje, 'hambari I drithit' per Jugosllavine, Cameria si ne te kaluaren ne Perandorine Osmane dhe pas 1912 ne Greqine ka qene hambar I agrumeve dhe ullinjve per Greqine. Portokallet dhe sidomos qitrot dhe nerenxat me nam te Camerise, Epirti nepermjet limaneve te Prevezes, Sallaores, Artes, Volos, Parges e Gumenices furnizonin mbare cifuterine e Evropes, lidhur me nje feste fetare te tyre ku perdoren keto. Ato shkonin ne Italia, Austri, France, Gjermani etj. Nje cam me qitro e nxorri rruga nga limani I Marsejes ne Paris, ku takoi Hasan Tahsinin. Ai e mori bashkeatdhetarin e vet veshur me petka kombetare dhe ja u prezantoi ne observatorin e Parisit, shkencetareve franceze, perfshi dhe drejtorin e observatorit, Lauvazerin. Me zgjuarsine e tij cami I thjeshte I ndihmoi ne zgjidhjen e nje problemi qe u kishte dale lidhur me vezhgimet shkencore me teleskop.

Zgjuarsia, aftesia, zotesia, gjenia e shqiptareve te Camerise ka spikatur ne mbare Evropen dhe boten. Ne kohen kur Perandoria Osmane arriti apogjeun e vet ne shek. XVI me Sulltan Sulejman Ligjvenesin dhe ishte superfuqi boterore sic eshte Amerika sot Kryeminster I Shtetit te Shtrire ne tre kontinente me siperfaqe mbi 15 milion km² ishte nje cam nga Parga qe hyri ne histori me mbiemrin e vendlindjes, Ibrahim Pargaliu. Turqit e sotem ketij personaliteti jo vetem I kane kushtuar studime por kane shkruar deri dhe romane per te. I them ketij auditori te nderuar, qe ndihmesa came ne bote eshte e jashtezakonshme por fare pak njihet. Camet qe kane nje diaspore qe shtrihet ne tere kontinetet e globit kudo kane dhene ndihmesen e tyre dhe ne te gjitha fushat. Eshte e pamundur qe ne suazen e nje kumtese si kjo te thuhet te gjitha por me siguri mund te themi se kontributi cam eshte shume I madh sidomos per tere vendet e Ballkanint Europes (Perendim dhe Lindje), Lindjen e Mesme etj. Mund te shkruhen libra te tere mbi kete teme.

Camet nje pjese e vogel e tyre, fisnikeria came, ishin te fundit qe e pranuan Islamizmin ne trojet shqiptare dhe kur e bene kete konvertim e bene te konvertuar per ti shpetuar asimilimit per te ruajtur identitetin kombetar perballe politikës helenizuese ne fillim te Patrikanes se Stambollit e me pas te shtetit Grek. Camet historikisht kane qene ne fqinjesi te perhershme me greket ne mijevejar. Eshte proverbiale dinakeria greke ne bote. Camet dhe pikerisht kjo fisnikeri, kjo elite, pronaret e tokes, lordet, lendlordet e Camerise ne shekuj I rezistuan kesaj dinakeria, mbijetuan, s'u munden bile I munden. Zgjuarsia, mencuria dhe inteligenca came triumfoi mbi dinakerine greke. Se fundi grekeve si u munden perpara mendjes came u mbeti vetem nje alternative, vetem dhuna, ndaj nisen luften kunder fisnikerise came te

muslimanizuar, kunder trurit cam , elites se Camerise. Pas 1912 per 33 vjet rradhazi e zhvilluan kete lufte te paprere dhe ne 1944-1945 e debuan kete fisnikeri came nga trojet e veta. Per ta bere kete gjeten nje bastard suljot nga fisi I nderuar I Zerbave qe vetem shtatin kishte te shkurter njesoj si Napoloni dhe si afrohej ne asgje tjeter. Napolon Zerva u be vegjel qorre per te zbatuar planin e studiuar strategjik te shovinizmit grek per te shtene ne dore perfundimisht Camerine. Cfare si bene ketij truri per ta zhdukur. Ne 1912 me te vene kemben ne Epir, greket 72 veta paresi e Camerise u shkuan ne sater ne perroin e Selanit mbi Paramithi. Pastaj si nuk e asgjesuan kete tru u perpoqen ta debojne. Shfrytezuan mareveshjen e Lozanes Turqi-Greqi per ti vene drune jashte kufijeve. S'ja arriten se pati nje barricade te pakapercyeshme. Vete popullsia came -myslimane dhe I perndritshmi, djali I Abdyl Beut, Mitat Frasherit u be barricade e pakalueshme. Ate qe beri I ati ne kohën e Lidhjes se Prizrenit qe s'e la te binte Camerine ne dore te grekeve, e beri ne kushtet e reja, te njejtën gje, biri I denje I babes se vet, Mitati dhe s'e lejoi shpernguljen e cameve ne Turqi. Camet myslimane, fisnikeria e Camerise, rraces qe s'mposhtet, s'perkulet nga asgje jane truri dhe zoterit e Camerise. Si s'u zhduken identitetin kombetar "turkuallvaneve" sic I quanin shovinistet greke, si s'i shperngulen ne 1923-1924 ne Luftën II Boterore, padrejtesisht kete fisnikeri e cuan ne "eksori", internim ne ishujt e Egjeut per ta zhdukur. Por si ai zogu feniks kjo fisnikeri kjo fisnikeri I mbijetoi te gjithave. S'mbeti vetem nje rruge, per ta zhdukur "trurin e camerise" qe I dha kaq shume kombit shqiptar dhe mbare botes. Ketij genocidi te pashmëbullt ne fund te Luftes II Boterore I vuri pikat mbi "i" bastardi Zerva. Debimin me force drejt Shqiperise te fisnikerise came qe u realizua duke e filluar me masakren e Paramithise, pikerisht kunder njerezve te vet. Dihet boterisht qe Suljotet jane farefis e te nje gjaku me myslimanet e Paramithise. Dy here bastard Napolon Zerva e ngriti doren mbi njerezit e vet si Shqiptar dhe per me teper te fisit te tij, me lidhje soji afersie gjinore, por prape te vonuar greket. Fisnikeria came nuk vdes.

Femijet e vegjel te kesaj fisnikerie qe I shpetuan genocidit apo pasardhesit e kesaj fisnikerie qe eshte ripërteritur si feniksi I kemi edhe ne kete salle. Konflikti me camet nuk eshte nje konflikt fetar sic eshte perpjekur ta paraqese propaganda e Athines ne shekuj e sot por nje konflikt etnik, nje konflikt ekonomik per tu marre token e pronat e tjera pronareve te vertete, landlordeve te Camerise, nje lufte per ta lene pa trurin dhe eliten e vet ate krahine, por kjo s'ka per te ndodhur kurre. Camet jane gjalle dhe ne kembe dhe gjihe vitalitet. Ne dejet e tyre vlon gjaku I shqiptarit, ne genet e tyre ka AND pellazgo, ilire, arbere.....

Pas ketij parashtrimi tani le ta shqyrtojme edhe njehere problemin cam. Kjo Cameri, kjo fisnikeri came e lene ne harrese nga Evropa, e lene ne meshiren e fatit nen nje regjim totalitar komunisit mese gjysem shekulli, e ndjekur e persekutuar e gjakosur mbi nje shekull pas 1912 nga shovinistet greke dhe nga "shovinistet" vendas ne thonjeza e

dengigruar derin ne palce nga nje propaganda shpifese nga jashte dhe brenda vendit; kjo fisnikeri came qe I dha Shqiperise, Greqise, Ballkanit, Perandorive Romake, bizantine, osmane, Evropes, dy feve boterore Krishterimit dhe Myslimanizmit kaq Patrike e Sheh Islame, kaq burra shteti, stratege ushtarake e dijetare etj. etj dhe botes nje Biblioteke te Aleksandrise, kjo fisnikeri qe sot gjendet e debuar nga trojet e veta, nga pronat e shenjta te veta, varret e stergjysherve te vet, e privuar te vere nje kurore me lule mbi to , ti shohe te pakten, kjo fisnikeri, kjo elite e nderuar s'paska te drejte te kthehet ne vendin e vet!!? . Cila e drejte njerezore juridike apo nderkombetare e permban dhe mund ta pengoje te kthehet ne trojet e vetak, ne pronat e veta. Cameria, Epiri duhet te pranoje dhe do ti pranoje se s'ben zoterit e tij. S'ka force ne bote qe ti pengoje ne te drejtat e tyre legitime, camet fisnike!

Pesembedhjetë vjet me pare ne Konferencen Themelvenese te Shoqates Politike Atdhetare Cameria, Abedin Madani , perfaqesues I cameve te Sarandes nga nje salle si kjo ne pallatin e madh te kultures ngrit akuzen ngjethese:

“Kush I vjel ullinjte camit,
Portokallet e Vatanit!”

Dhe ne fund te poemes se tij te dale prej shpirtit cam do te shkruante :

“Sa te kemi kembe e duar
S'kem kurre per te pushuar,
Do kerkojme drejtesine,
Qe na muar Camerine
Mu ne Kombet e Bashkuar!”

Vite me pare kur merresha me kerkime per rilindasin Hasan Tahsin kam gjetur ne Arkivat e Institutit te Kultures Popullore, nje poezi nje strofe te se ciles po e citoj ketu, qe shprehte revolten per debimin e kesaj fisnikerie nga trojet amtare.

“Koha po e solli,
O moj Cameri,
Per ty do luftojme,
Nje mos mbetemi!”

Por kohet kane ndryshuar! Shkojme drejt Evropes se Bashkuar, ka ikur koha e luftrave e nacionalizmave dhe e shovinizmave. Vetem I themi Evropes qe te shikoje realitetin cam dhe te camerise ne sy. Ne Epir, nuk ka kembe greku edhe sot qe po flas nga kjo salle. Ka vetem shqiptare cam ortodokse dhe vllehe. Te ashtuquajturit greke jane vecse surrogate te cameve ortodokse dhe vlleheve qe jane greqizuar tani se fundi ne nje ose dy breza si rezultati I mungeses se shkollave, kishes e mediave, gazetave, radiove televizive ne gjuhen amtare shqipe. Mbi 200000 came myslimane jane ne Shqiperi dhe mbi 300000 came ortodokse jane ne Cameri, ne Epir. Flasin shqipen e vjeter nen dialektin cam te toskerishtes qe aq mire I ruan arkaizmat e shqipes dhe deshmon lashtesine e tij. Autori I ketyre rradheve I ka degjuar si flasin qofte camet ortodokse,

qofte camet myslimane apo ortodokse si ne Shqiperi edhe ne Greqi e gjetke. Per ta perfunduar me lejoni te them nja dy vargje nen kete dialekt te lashte ne respect te ketij auditori.

“Cameri moj Cameri,
Gjalle je s’ke dekur ti!
Ngriji site dhe shiko,
Dita jote eshte kjo!”

“Sa te jete shqiptari,
Trojet qe na la I pari,
Qysh ne shekuj,
Prej qemoti,
Do veje haka tek I zoti!”

“Zerva me gjithë Grqine,
Sic I moren do I bine,
Sa te jete Shqiperia,
Nuk ka mortje Cameria!”

Dr. Laurant Bica

LEGJISLACIONI GREK PËR GRABITJEN E PRONAVE TË SHQIPTARËVE TË ÇAMËRISË (1913-2007)

Ahmet MEHMETI
Drejtor Ekzekutiv i
Institutit të Studimeve për Çamërinë

Historia e të drejtave ligjore të minoritetit shqiptar në Greqi, të çamëve, është një shkelje flagrante e të gjitha normave të së drejtës të vetë shtetit grek si dhe atyre ndërkombëtare. Kjo gjendje filloi me aneksimin e Çamërisë në shtetin grek në dhjetor të 1913 sipas Protokollit të Firences dhe vazhdon deri sot.

Në periudhën 1 - 14 nëntor 1913 u hartua dhe nënshkrua Traktati i Paqes midis Turqisë dhe Greqisë ku përcaktohet qartë se banorët e teritoreve të aneksuara nga kjo e fundit do të ruajnë administrimin e lirë të pasurive të tyre dhe të drejtat për t'i disponuar ato pa pengesa.

Konkretisht në nenin 6 të këtij traktati shkruhet: "... Në vendet e zotëruara nga Greqia, të drejtat e pasurisë mbi pronat e paluajtshme bujqësore, të zotëruara nga persona privatë me dokumente nga shteti osman, para zotërimit të tyre, do të njihen nga shteti grek. Janë të përfutur përsa i përket të drejtave të pronësisë mbi tokën. Në emër të personave ligjorë të regjistruar ose të zotërimeve në sajë të ligjeve osmane të pasardhësve të paqes.

Mund të privohet nga prona e vet, pjesërisht ose terësisht, e cila mbahet për hir të sigurimit të interesit pas një zhdëmtimit të saj".

Plot 4 vjet më vonë, në të njëjtën datë, më 14 nëntor 1917, miratohet ligji nr. 924 dhe me dekret mbretëror në mars të 1918-s në zbatim të tij, ndalohet rreptësisht shitja dhe tjetërsimi i pasurive të paluajtshme që gjendeshin në teritorin e aneksuar nga Greqia pas luftrave ballkanike.

Kjo masë thellësisht e padrejtë që ishte në kundërshtim me nenin 6 të traktatit të paqes e detyroi popullsinë muslimane shqiptare të krahinës së Çamërisë të shikojë veten në prespektivën e trishtuar të të qenit të detyruar të mërgojë duke lënë pasuritë e tyre të paluajtshme dhe fushat e tyre që përbënin, për shumicën dërrmuese, pasurinë e vetme. Zgjedhja e Turqisë në atë kohë duke mos ardhur në Shqipëri, bëhej pasi kësaj nuk i ishte njohur zyrtarisht të qenit shtet i pavarur. Në atë kohë qëndrimi i tyre ishte mjet i vetëm për të ruajtur të drejtën e kërimit, më vonë, të kombësisë shqiptare.

Në këto kushte kryetari i delegacionit shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris Luigj Bumçi (atëhere peshkop i Lezhës) i drejtohet kryetarit të kësaj konference Zhorzh Klemanso, më 25 korrik 1919, të ndërhyjë tek shteti grek për shfuqizimin e dekretit mbretëror dhe për pasojë pengimin e dëbimit të shqiptarëve muslimanë, ku thekson se

Traktati Turko - Grek "përputhet me parimet më të shenjta të drejtësisë" dhe "asnjë pengesë të mos vihet nga qeveria greke për tjetërsimin e lirë të pasurive të tyre të luajtëshme e të paluajtëshme".

Një vit më vonë u nënshkrua Traktati i Sevrës (10 gusht 1920) midis Aleatëve dhe Turqisë, si pjesë e negociatave të Konferencës së Paqes të Parisit.

Përsa u takon shqiptarëve të Çamërisë në artikullin 2 të këtij traktati midis të tjerave theksohet "Greqia pranon të sigurojë mbrojtje të plotë për jetën dhe liritë e të gjithë banorëve të Greqisë pa dallim origjine, kombësie, gjuhe, race apo përkatësie fetare".

Për më tepër në artikullin 8 të po këtij traktati konfirmohet qartë: "Qytetarët grekë që u përkasin **minoriteteve** racore, fetare apo gjuhësore, do të gëzojnë të njëjtin trajtim dhe siguri, me ligj dhe zbatim si dhe qytetarët e tjerë grekë. Në veçanti, ata do të kenë të drejtën e barabartë për të ngritur, drejtuar dhe kontrolluar, me shpenzimet e tyre, institucione sociale, fetare apo bamirësie, shkolla dhe struktura të tjera arsimore, me të drejtën për të përdorur gjuhën e tyre dhe të ushtrojnë besimin e tyre lirisht.

Në artikullin 1 të Traktati të Sevrës theksohet "Greqia pranon se kushtet e përshkruara në artikujt 2 dhe 8 do të njihen si ligje themelore dhe asnjë ligj, përmirësim apo veprim ligjor nuk do të konfliktojë apo do të ndërhyjë me këto kushte, po ashtu asnjë ligj, përmirësim apo veprim ligjor nuk do të mbizotërojë mbi to"

Më në fund Greqia me një dokument ndërkombëtar **njuh de jure praninë e minoriteteve kombëtare** dhe të drejtat e tyre, por Traktati i Sevrës që nga koha e nënshkrimit e deri sot nuk u zbatua asnjëherë nga shteti.

Në Çamëri vazhdoi të mohohej identiteti kombëtar i shqiptarëve nga qeveria greke duke shënuar në letërnjoftimin e tyre vetëm besimin fetar, për ato që i përkisnin fesë muslimane, kurse të krishterët shqiptarë, si në kohën e perandorisë otomane, quhen edhe sot grekë, duke u mohuar kështu të drejtat që gëzojnë minoritetet kombëtare në Bashkimin European e më gjerë.

Një cfilitje torturuese ishte periudha 1923 - 1926 për shqiptarët e Çamërisë, në kohën e Traktatit të Lozanës (24 korrik 1923) midis Turqisë e Greqisë për shkëmbimin e popullsisë.

Megjithse bëhej fjalë për grekë e turq, shteti grek me një mori pafund spekulimesh shfrytzoj rastin të vinte në jetë Megali idenë për çrrënjosjen e shqiptarëve si turq, nga trojet mijëvjeçare. U desh ndërhyrja e fuqishme e shtetit shqiptar dhe e vetë çamëve që vunë në lëvizje të gjitha organizmat ndërkombëtare për shmangien e pjesëshme të spastrimit të dytë etnik (pas atij të periudhës së Konferencës së Londrës), megjithatë u shpërngulën 35 000 shqiptarë autoktonë nga zonat e Konicës, Kosturit e Follorinës si dhe mbi 15 000 të tjerë nga Çamëria.

Në periudhën që pasoi diskriminimi ekonomik dhe heqja e mjeteve të jetesës ishte një tjetër mënyre efikase për t'i detyruar shqiptarët të largoheshin nga vendi i tyre.

Një varg ligjesh dhe aktesh nënligjore të komplikuar qëllimisht drejtoheshin kundër shqiptarëve muslimanë. Kështu ligji numër 3250 sanksiononte zhvlerësimin e tapive prej 100 vjet e tutje. Ky ligj shkelte Traktatin greko - turk të Athinës. E ashtuquajtura "Reforma Agrare" u bë mjet për t'i hequr muslimanëve çamë çdo bazë ekonomike.

Ky çpronësim nuk u bë në favor të refugjatëve të ardhur nga Turqia port ë çamëve ortodoksë për t'i futur në armiçësi dy komunitetet me kombësi të njëjtë.

Shpronësimi do të bëhej kundrejt një shpërblimi që s'u dha kurrë. Ndërkohë vazhdonte mos lejimi për shitjen ose dhënien me qera të pronave të tyre.

Ligji i reformës agrare i hapi rrugë arbitraritetit dhe grabitjes të popullsisë muslimane shqiptare. Kështu një rrënjë ulliri merrej me 25 dhrahmi kur vlera e saj në atë kohë ishte 3000 dhrahmi dhe shpërblimi do të bëhej për 30 vjet. Spekullime u bënë në matjet e sipërfaqeve të tokave, p.sh. fshati Goricë që kishte në fakt 7000 dynym u përlogarit 1400 dynym, Januri nga 5000 në 1500, Turkopallku nga 5500 në 1500, Kanellaqi nga 8000 në 1800 etj., kështu pronarët muslimanë u shndrruan në argatë, pa tokë, pa asnjë shpërblim.

Ndaj kësaj gjendjeje të padurueshme u ngritën në protesta intelektualët e shquar çamë Ali Dino, Haki Sejko etj. duke ju drejtuar kryeministrit Pangalos, i cili për të zbutur gjendjen e acaruar në kulm pranoi: "Në Epir kemi disa mijëra çamë, të njohur prej nesh dhe që formojnë në shtetin tonë **minoritetin shqiptar**. Nëqoftëse në të kaluarën kanë ngjarë disa veprime të dëmshme për ta, nga ana e organeve vartëse, kjo nuk duhet kurrsesi të bëhet një vijë veprimi kundrejt tyre".

Por ky qëndrim i një autoriteti të lartë shtetëror nuk zgjati shumë pasi me ardhjen në fuqi të të diktaturës së Metaksait e deri në sulmin e Italisë gjendja sa shkonte rëndohet më shumë në kushtet e mohimit absolut të të drejtave të njeriut si mohimi i shkollës dhe i gjuhës amtare në publik, mohimi i votës etj. etj. të cilat u sanksionuan me ligje e pa ligje si në një regjim tipik fashist.

Periudha e Luftës së Dytë Botërore dhe spastrimi etnikofetar i tretë dhe i fundit i 35000 shqiptarëve muslimanë nga Çamëria ishte akti final i zbatimit të Megali idesë nga forcat e armatosura të shtetit grek.

Krimet e luftës dhe genocidi i pashoq i ushtruar ndaj njerëzve të çarmatosur dhe të pa fajshëm u kushtoi jetën rreth 2900 vetëve të vrarë e të masakruar dhe rreth 2400 të tjerëve që vdiqën rrugëve nga sëmundjet, uria dhe të ftohtit gjatë spastrimit etnik.

Megjithse mbi 1000 çamë morën pjesë në dy batalione në forcat antifashiste, njeri në Shqipëri dhe tjetri në Greqi, dhe mbi 70 vetë ranë dëshmorë, propaganda shtetërore greke mohon kontributin e shquar të tyre duke ngulur këmbë në akuza false për bashkëpunim me armikun

vetëm e vetëm për të fshehur krimet e luftës dhe për të justifikuar shpërnguljet masive me dhunë.

Këto akuza dhe gjyqet false, që vetë gjykata greke i ka përgënjeshtuar, u kanë hapur rrugë vendosjes së ligjeve drastike në kundërshtim me kushtetutën greke dhe të drejtën ndërkombëtare.

Me administrimin e pasurisë së grabitur të çamëve u morën autoritetet lokale duke spekuluar me ligjin 1539/ 1938, Art.34. Sipas As. Prof. Kyriakos D. Kentrotis në vitin 1947 çamëve ju hoq shtetësia greke në mënyrë kolektive me dy protokolle: Nr. 49 343 / E / 2 / 29.10.1947 i autoriteteve për çështjet juridike në Ministrinë e Jashtëme dhe Nr. 3976 / 8.11.1947 të Ministrisë së Brendëshme. Të dy protokollet janë bazuar në akuza false për “bashkpunim dhe veprime kundër interesave të popullit grek” Grabitja e pasurive të shqiptarëve u bë për të realizuar kolonizimin e ëndërruar e planifikuar të Çamërisë qysh në vitin 1844 me famëkeqen Megali ide duke jua ndarë tokat dhe pasuritë e tjera të shqiptarëve kolonëve grekë dhe duke proceduar me Bankën Agrare.

Sikur të mos mjaftonin të gjitha këto akte ligjore e nënligjore në vitet 1966 dhe 1998 shteti grek miraton dhe dy ligje të tjera me numra përkatësisht 4506 dhe 1664. Ironia e këtyre dy ligjeve qëndron në atë se mbështeten në Ligjin famëkeq të Luftës me Shqipërinë nr. 2636 / 1940 kur çamët ndodheshin në vendet e tyre në Greqi dhe gëzonin të gjitha të drejtat si qytetarë grekë.

Por rasti më flagrant i kohëve të fundit është ligji nr. 2664 “Mbi Kadastrën kombëtare dhe rregulla të tjera” dekretuar më 27 nëntor 1998 nga presidenti Kostandin Stefanopulos dhe firmosur nga 8 ministra. Ky ligj u miratua pas nënshkrimit të Traktatit të Miqësisë Shqipëri – Greqi të vitit 1996 ku në pikën 15 theksohet lehtësimi i marrjes së pronave të shtetasve të të dy vendeve në vendet respektive. Ky ligj shkel të gjitha kartat, konventat e traktatet ndërkombëtare për pronën dhe të drejtat themelore të njeriut duke përligjur arbitraritetin e një shteti tipik racist.

Një gjë është fare e qartë në këtë maskaradë ligjore, Greqia përse u takon minoriteteve asnjëherë nuk ka zbatuar detyrimet që rrjedhin nga kartat, konventat, traktatet ndërkombëtare që ka firmosur e ratifikuar vetë në mardhëniet dy ose shumëpalëshe. Ajo është i vetmi vend i BE-së që nuk ka përafuar legjislationin e vetë kombëtar me atë europian, deri tani nuk ka ratifikuar Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare dhe as e ka firmosur Kartën për Gjuhët Rajonale ose të Minoriteteve.

Karakterizimin më të saktë të sistemit ligjor grek e ka bërë gazeta “The Daily Telegraph” në dhjetor të vitit 2001: “Greqia është një partnere e jona brenda Komunitetit Europian, por sistemi i saj ligjor arkaik, i padrejtë, është si i Botës së Tretë. Është gjithashtu mizor”.

Literatura:

1. **Bunçi L.** Zhorzh Klemensos
Protestë me anën e të cilës kërkohet ndërhyrja e pranë qeverisë greke. Paris, 25 korrik 1919 “Dokumente për Çamërinë”. Tiranë, 1999 f. 58 – 59.
2. **Dino A.**
Raport mbi kriteret bazë për përcaktimin e kombësisë së banorëve të Çamërisë. Athinë, 7 qershor 1924. “Dokumente për Çamërinë” Tiranë, 1999 f. 300 – 310.
3. **Cordell K, Wolf S.** The Ethnopolitical Encyclopedia of Europe, New York, 2004.
4. **Kentrotis K.D.** Problemi i muslimanëve çamë. Die griechisch – albanischen Beziehungen f. 288- 295 (përkthim shqip) në Punimet e Seminarit të Parë Kulturor “ Për Çamërinë” 17 qershor 2000, New York
5. **Mehmeti A.** Si i shkel Greqia konventat ndërkombëtare për të shmangur çështjen çame “Ballkan”, 18 Maj 2004 f.7.
6. **Mehmeti A.** ... Ligji grek që grabit pronat e shqiptarëve “55”, 2 dhjetor 2005.
7. **Minga H., Saqe H.** Genocidi grek kundër Çamërisë vazhdon. Tiranë, 2006. f. 17 – 18.
8. **Palmowski J.** A dictionary of twentieth century world history. Oxford, 1998. f. 550, 354.

Ardian TANA

Kryetar i Përgjithshëm i Shoqërisë “Çamëria”

Marrëdhëniet çamo-greke dhe perspektiva e tyre

Të shpërngulur mizorisht nga trojet e tyre shqiptarët e Çamërisë për asnjë çast nuk e kanë humbur besimin se do të kthehen në këto troje. Me këtë besim ata janë organizuar nga janari i vitit 1991 rreth Shoqërisë Çamëria që është shprehëse e kërkesave dhe vullnetit të tyre të sanksionuara edhe në programin e saj dhe që janë:

1. Kthimi i popullsisë çame në trojet e veta.
2. Të njihet e drejta e pronësisë së popullsisë çame, të hiqen të gjitha kufizimet ligjore greke që e pengojnë këtë.
3. T'i njihet popullsisë çame shtetësia greke që ajo e ka gëzuar nga viti 1913.
4. T'i njihen popullsisë çame të gjitha të drejtat që burojnë nga Kartat apo Konventat Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut.

Prej kësaj kohe përpjekjet e Shoqërisë Çamëria, përfaqësuesve zyrtarë të shtetit dhe politikës shqiptare kanë qenë të pranishme në kontakte dypalëshe me përfaqësues të shtetit grek apo në institucione të ndryshme ndërkombëtare, ndonëse jo me forcën dhe intensitetin e duhur. Në këto marrëdhënie është e qartë se nuk ka patur në asnjë rast paritet për shkak të pozicionit të shtetit grek i pranishëm si anëtar i Bashkimit Evropian, apo edhe për shkak të pafuqisë së shtetit shqiptar, i cili për arsye të varësisë ekonomike dhe të asaj financiare dhe jo rrallë edhe kondicionimit për vazhdimësinë e integritit në NATO apo Bashkimin Evropian nuk ka patur këmbënguljen e nevojshme në trajtimin e Çështjes Çame në këto tryeza.

Kërkesat e komunitetit çam, Shoqëria Çamëria është përpjekur t'i bëjë të qarta që me krijimin e saj kur përmes kryetarit të parë, z. Abaz Dojaka i ka dërguar një Memorandum kryeministrit të atëhershëm të Greqisë z. Kostantinos Micotaqis. Veç të tjerash aty shprehet besimi se “një vështrim dhe zgjidhje realiste në frymën e proceseve të sigurimit dhe bashkëpunimit evropian, bashkëpunimit e mirëkuptimit ballkanik, politikës së fqinjësisë së mirë do të kontribuojë në zgjidhjen e Çështjes Çame dhe do të forcojë marrëdhëniet e fqinjësisë së dy vendeve”.

Prej shtatorit të vitit 1991, me qëndrimin e përfaqësuesit zyrtar të Republikës së Shqipërisë në Konferencën e Sigurimit dhe Bashkëpunimit Evropian, i tërhiqet vëmendja shtetit grek rreth popullsisë çame që u bë pre e një dhunë të pashembullt çnjerëzore. Përfaqësuesi i shtetit shqiptar konstaton një qëndrim aspak konstruktiv të qeverisë e shtetit grek, që në

kontaktet dypalëshe i përmbahen qëndrimit të tyre të vjetër duke mohuar ekzistencën e Çështjes Çame. Kur në mars të vitit 1993 Ministri i Jashtëm i atëhershëm shqiptar z. Alfred Serreqi në Akademinë Diplomatike në Vjenë kërkoi “riatdhësimin e çamëve, të cilët janë përzënë jashtë Greqisë mbas Luftës II Botërore”, pati një valë të jashtëzakonshme deklaratah zyrtare greke që e dënonin këtë deklaratë dhe presione me anë të “fshesës” mbi emigrantët shqiptarë në Greqi, mbi shtetin e brishtë shqiptar, për të heshtur për këtë problem. Të gjithë i kemi parasysh turmat e mëdha të refugjatëve shqiptarë që ktheheshin në pikat doganore midis dy vendeve shpesh të keqtrajtuar sa herë ngrihej Çështja Çame dhe acaroheshin marrëdhëniet ndërshtetërore. Në periudhën janar 1991 deri në maj të vitit 1993 në vizitat e kryeministrave respektivë në të dy vendet, atij grek në Tiranë dhe atij shqiptar në Athinë, ka patur qëndrime të qarta zyrtare greke që kundërshtonin ekzistencën e kësaj çështjeje dhe që tregonin qartë një vazhdimësi qëndrimesh në këtë drejtim.

Dalja në skenë e Çështjes Çame sigurisht që ishte një imponim prej situatave të krijuara, i kërkimit të së drejtës nga ana e popullsisë çame që jeton në Shqipëri, e cila duke përjetuar një rizgjim të vetëdijes së saj pas ndryshimeve demokratike që ndodhën në Shqipëri, kërkonte me këmbëngulje me anë të formave demokratike realizimin e kërkesave të saj. Ishte krijuar më së fundmi hapësira demokratike e munguar që çamët, tashmë të lirë për të folur e kërkuar e kishin aspiruar prej shumë dekadash.

Që prej krijimit Shoqëria Çamëria ka mundësuar organizmin e mjaft tubimeve, simpoziumeve, konferencave apo edhe marshimeve drejt pikës kufitare të Qafë Botës për të treguar se është e vendosur në realizimin e qëllimeve për të cilat ajo është krijuar.

Duke patur të qartë se kjo çështje për të cilën ne përpiqemi është një çështje e drejtë, ne jo vetëm besojmë, por edhe jemi të përgatitur të përballemi me kundërshtitë që na vijnë nga ana e përfaqësuesve zyrtarë të shtetit grek, sepse luftrat për të drejtën kërkojnë durim, këmbëngulje dhe bashkim.

Duke patur një boshllëk në përpjekjet shtetërore shqiptare prej vitit 1947 deri në vitin 1990 kemi ndjerë një vështirësi të madhe në ndërkombëtarizimin e Çështjes Çame. Popullsia shqiptare e Çamërisë e shpërngulur me dhunë nga trojet e veta menjëherë pas kësaj shpërnguljeje e terrori masiv bëri përpjekje për të realizuar kthimin në vatrat e veta duke u organizuar rreth Komitetit Antifashist Çam, i cili u përpoq deri në vitin 1947 për sensibilizimin e organizmave ndërkombëtare, duke i dërguar një Memorandum edhe Komisionit Hetimor të Këshillit të Sigurimit të UNO-s. Më herët edhe shteti shqiptar e kish dërguar këtë çështje në Konferencën e Paqes në Paris dhe në Konferencën e Ministrave të Jashtëm të Fuqive Aleate, jo vetëm duke kërkuar mbështetje për pozitën e vështitë të popullsisë çame që jetonte në kushte jashtëzakonisht të vështira, kur uria dhe sëmundjet në

pasluftë kishin shkaktuar vdekje masive, por gjithashtu kërkonin riatdhesimin e tyre dhe kthimin e pronave.

Komiteti Antifashist Çam në periudhën 1945-1947 nuk i rreshti memorandumet dhe telegramet dërguar forcave aleate, Asamblesë së Kombeve të Bashkuara në Londër dhe New York, Këshillit të Ministrave të Jashtëm Aleatë në Londër dhe Moskë, qeverisë së Britanisë së Madhe, qeverisë së ShBA-së, Shtabit të Përgjithshëm të Mesdheut etj, por mbështetje ndërkombëtare në këtë drejtim nuk pati. Është e kuptueshme situata e asaj kohe, kur bota sapo kish dalë nga një luftë e përgjakshme. Fati i një popullsie prej mëse 30 mijë vetë të shpërngulur nga tokat e veta dhe që endej në kufirin e jetës e vdekjes, u la në harresë.

Është i pashpjegueshëm fakti që fill pas vitit 1947 qeveria shqiptare nuk ka bërë asnjë kërkesë të hapur apo nuk e përmend fare Çështje Çame, por i detyron çamët në vitin 1953 të marrin masivisht nënshtetësinë shqiptare duke legjitimuar kështu përzënieën e dhunshme dhe duke u përpjekur të mbysë tashmë kërkesat e kësaj popullsie për kthimin në trojet e veta dhe gëzimin e të gjitha të drejtave që asaj i takonin. Nuk kish si të ndodhte ndryshe, sepse pushteti komunist nuk përkahte pronën private, por kërkonte kolektivizimin e pronës.

Në këtë kohë qeveria greke dhe institucione të tjera shtetërore bënë të gjitha përpjekjet për të përligjur genocidin e ushtruar prej tyre ndaj popullsisë së pafajshme të shqiptarëve të Çamërisë. U inskenua një gjyq farsë që dënoi 1930 vetë si bashkëpunëtorë të pushtuesit dhe që më vonë Gjykata e Diktimit të Janinës me vendim nr 17835/1976 e hedh poshtë si të pabazuar. Në këtë logjikë në maj të vitit 1992 në vizitën e tij në Tiranë kryeministri grek Micotaqis shpreh qëndrimin zyrtar të shtetit grek se “ çamët muslimanë nuk do të lejohen të kthehen në Çamëri-Greqi, sepse kanë bashkëpunuar me okupatorin italo-gjerman në Luftën II Botërore dhe si të tillë ata janë kriminelë lufte dhe janë dënuar sipas ligjeve greke”. Ironi e madhe kjo kur vetë kryeministri shtrembëron faktet historike apo falsifikon e fabrikon akuza, të cilat janë hedhur poshtë nga institucione të vetë shtetit të tij shumë vite përpara se ai t'i bënte këto deklaratat. Por ai nuk është i vetmi që deklarohet në mënyrë të tillë. Të gjithë shtetarët e lartë grekë në vizitat apo takimet dypalëshe vazhdojnë t'i largohen trajtimit të Çështjes Çame me absurdin e përmendur më lart. Kryeministrat e mëvonshëm të Greqisë e deri te qeveritarët e sotëm, përfaqësuesit e tyre në vendin tonë, ambasadorë në organizma ndërkombëtarë vazhdojnë të deklarojnë se çamët u larguan nga shtëpitë e tyre se gjoja paskëshin bashkëpunuar me armikun. Këto deklarata qesharake i kemi dëgjuar të përsëriten edhe pak javë më parë nga përfaqësuesi i shtetit grek në vendin tonë z. Kokosis, i cili na bind se në qëndrimin zyrtar grek nuk ka ndryshuar asgjë. Ai mbetet i tillë si për të na treguar se shtetit të sotëm grek i mungon kurajua të distancohet nga krimet që kanë bërë 62 vjet më parë bashkëkombasit e tyre me në krye gjeneralin famëkeq Napoleon Zervas.

Ka patur përpjekje të vazhdueshme duke ushtruar dhunë mbi shqiptarët ortodoksë që jetojnë ende sot në Çamëri për të zhdukur tek ata çdo gjurmë të identitetit të tyre shqiptar, duke u ndaluar të drejtën e përdorimit e të mësimit të gjuhës, të zakoneve të tyre, duke realizuar kështu asimilimin me dhunë të kësaj popullsie, e cila e pambrojtur nuk mund t'i bënte ballë këtij invazioni.

Në vijimësi shteti grek ka ndjekur një politikë kolonizuese për krahinën e Çamërisë duke ndryshuar hartën demografike të krahinës. Në tokat e çamëve të shpërngulur me forcë u vendosën popullsi greke etj.

Pronat e shiptarëve të dëbuar iu dhanë vendasve të rinj nga qeveria greke pa të drejta ligjore pronësie.

Kjo politikë vazhdon me çamët edhe sot përderisa qeveria e tanishme greke nuk i lejon të vizitojnë shtëpitë e tyre. Mirëfilli ndaj tyre ndiqet një politikë diskriminuese përderisa çdo shiptari të Çamërisë që në pashaportë shënon vendlindjen: Paramithi, Filat, Gumenicë etj. nuk i jepet vizë.

Duket qartë se qeveria e shteti grek gjatë gjithë kësaj kohe është përpjekur të ligjërojë genocidin e kryer mbi çamët. Ajo mban ende në fuqi de jure Ligjin e Luftës me Shqipërinë (ende i paabroguar nga parlamenti grek si i vetmi organ që ka të drejtën e shfuqizimit të tij).

Qeveria greke kërkon të shmangë kthimin e popullsisë çame në shtëpitë e veta dhe gëzimit të së drejtës së pronës që nuk ka asesi si të ndodhë, sepse kështu Greqia do të ishte shembulli më i keq i mosrespektimit të Konventave Ndërkombëtare në të cilat ajo ka aderuar prej kohësh. Ajo nuk ratifikon edhe pse ka nënshkruar marrëveshje, akte apo traktate ku flitet për të drejtat e minoriteteve për t'ju shmangur kështu detyrimit të zbatimit të tyre. Duke shtyrë apo shmangur ratifikimin e tyre grekët kërkojnë t'u shmangen detyrimeve që rrjedhin nga Traktatet Ndërkombëtare.

Greqia shfaq qëndrim me dy standarde: Një për të kërkuar ajo vetë respektim nga vendet e tjera përfshi këtu edhe Shqipërinë standardet kur i kërkon respektimin e të drejtave të pakicës greke në Shqipëri dhe një standard tjetër kur përballat me zgjidhjen e Çështjes Çame, të cilën kërkon ta mohojë, madje duke bërë presionin politik se rruga e Shqipërisë për në Evropë kalon nga Greqia.

Në vazhden e qëndrimeve shtetërore greke anulimi i vizitës së presidentit grek z. Papulias në datën 1 nëntor të vitit 2005 duket i çuditshëm, kur deklarohet arsyeja e anulimit: frikë nga manifestuesit çamë që ishin mbledhur para vendit të takimit për t'i uruar mirëseardhjen, madje duke shpalosur një parrullë të madhe mirëseardhjeje ku shkruhej "Mirësevjen Presidenti ynë!"

Frika me sa duket vjen nga reagimi politik brenda Greqisë ku krahë të ndryshëm konservatorë mbeten në pozita të palëkundura përsa i përket mosrespektimit të të drejtave të njeriut, të drejtës së shtetësisë, të drejtës së pronës etj.

Në tubimin paqësor të 25 qershorit në pikën kufitare të Qafë Botës ku mijëra çamë u mblodhën për të treguar vitalitetin e tyre, u bë thirrje që qeveria e shteti grek të fillojnë realisht të punojnë në bashkëpunim me shtetin shqiptar në drejtim të zgjidhjes së kësaj çështjeje, e cila do të mund të çlironte nga ngërçi marrëdhëniet midis dy vendeve dhe do të bënte që midis tyre të ketë një urë të vërtetë bashkëpunimi me dy kalime, pra respektim të të drejtave të çamëve ashtu si të pakicës greke në Shqipëri.

Prej disa kohësh në institucionet ndërkombëtare vihet re një vëmendje e shtuar ndaj Çështjes Çame. Në raportin e vitit 1994 të Departamentit të shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës thuhet se “Çamët, shqiptarë etnikë, që u dëbuan nga Greqia veriore... kanë kërkuar rikthimin e shtetësisë greke dhe të pasurisë së tyre. Qeveria greke shprehu njëfarë gatishmërie për të diskutuar për kompesimin e pasurisë, por nuk njeh pretendimet për shtetësinë, të quajtur historike”. Grupi Ndërkombëtar i Krizave deklaroi se “çamët u dëbuan nga Greqia”. Ambasadori amerikan në OSBE, në takimin e organizuar në Varshavë i tërheq vëmendjen Greqisë në drejtim të respektimit të të drejtave të minoriteteve (shqiptarë, turq e maqedonas). Eurodeputetja Doris Pack deklaroi se qeveria greke duhet të lejojë qytetarët çamë të vizitojnë shtëpitë e tyre. Reagime vijnë nga mjaft eurodeputetë dhe grupime politike të përfaqësuara në Parlamentin Evropian. Vjen kështu një reagim gjithnjë në rritje i komunitetit ndërkombëtar, i cili është mjaft i ndjeshëm ndaj problemit të respektimit të të drejtave të njeriut. E ku më shumë se në Çështjen tonë këto të drejta janë shkelur?!

Kërkohet pra të përpqemi të gjithë të sensibilizojmë për këto shkelje tërë institucionet evropiane, amerikane e botërore. Deri më tash këto përpjekje nuk kanë shkuar ashtu si duhet.

Duket se lëvizjet e fundit të drejtuesve të Partisë për Drejtësi dhe Integritet (parti kjo që mbron Çështjen Kombëtare Shqiptare) kanë ngjallur jo vetëm interes, por mbi të gjitha kanë nxitur qëndrime konkrete zyrtare të Parlamentit Evropian në mbështetje të zgjidhjes së Çështjes Çame. Mbetet që të kemi një vullnet të qeverisë greke për t’u ulur më së fundi në tryezën e bisedimeve të zgjidhjes së kësaj Çështjeje. Po ashtu kërkohet që shteti shqiptar të shkundet nga apatia e këtyre viteve të fundit, të marrë pozita më këmbëngulëse dhe të kërkojë asgjë më shumë sesa respektimi i të drejtave për popullsinë çame. Por për këtë duhet të dilet mbi qëndrimet e deritanishme pritëse apo false, mbështetur në Komisionet e pangritura ndonjëherë për zgjidhjen e kësaj çështjeje, apo në shtjellimin e zgjidhjes brenda kornizës së Traktatit të Miqësisë Shqipëri-Greqi, i cili në asnjë rast nuk e përmend çështjen Çame dhe si i tillë s’mund të shërbejë për të mundësuar zgjidhje reale, veçse nëse ai amendohet dhe i shtohen pika që drejtpërdrejt do të flisnin për këtë çështje. Heshtjes së deritanishme institucionale për shkak të presioneve nga ana e shtetit grek, apo konjunkturave politike duhet t’i jepet fund. Ka ardhur koha që zëri i Tiranës zyrtare në drejtim të

mbrojtjes së Çështjes Kombëtare Shqiptare të bëhet më i fortë dhe qëndrimet më të vendosura.

Ne kërkojmë që bisedat për zgjidhjen e Çështjes Çame të bëhen me praninë e një pale ndërkombëtare, mundësisht amerikane, si një vend që ka ndërmjetësuar edhe herë të tjera në zgjidhjen e çështjeve të ngjashme dhe patjetër me pjesëmarrjen në tryezën e bisedimeve të përfaqësuesve të komunitetit çam. Vetëm kështu procesi do të jetë më bindës dhe rezultati i pranueshëm nga të gjitha palët.

Është e nevojshme që në vazhdimësi Shoqëria Çamëria, në bashkëpunim me faktorë politikë, me tërë institucionet dhe organizmat që kanë vullnet në drejtim të zgjidhjes së Çështjes Çame, të shtojë përpjekjet për ndërkombëtarizimin e Çështjes. Duhet të realizohen iniciativa për unifikimin e qëndrimeve të tërë politikës shqiptare ndaj Çështjes Çame dhe patjetër të bëhet e pranishme Shoqëria Çamëria në organizmat shqiptare dhe ato ndërkombëtare që ndikojnë në drejtim të zgjidhjes së kësaj Çështjeje.

Shoqëria Çamëria uron Konferencën për punime të mbara dhe është mjaft e interesuar të dëgjojë përfundimet që do të dalin prej saj në të gjitha rrafshet. Idetë e hedhura këtu do të jenë mjaft të vlefshme për të përcaktuar rrugët më të mira për zgjidhjen demokratike të çështjes sonë. Ne besojmë se ashtu si në Konferencën shkencore të realizuar në qershor të vitit 2004 nga Instituti i Studimeve për Çamërinë edhe në këtë Konferencë do të dilet me një produkt të vlefshëm që do të ndihmojë dhe orientojë edhe më mirë përpjekjet e popullsisë çame për zgjidhjen sa më shpejt dhe më mirë të çështjes së saj.

KOSOVA DHE ÇAMËRIA NË KRIJIMTARINË E BILAL XHAFERIT

Agim Vinca

Gjatë ditëve të rënda të eksodit të vitit 1999, ndërsa i kaloja ditët si “refugjat” në vendlindje, në Strugë, më ndiqnin pas kudo vargjet e poezisë *Baladë çame* të Bilal Xhaferit. Në ato ditë plot ankth, nuk gjeja ndonjë krijim tjetër letrar në tërë letërsinë shqipe që t’i përgjigjej më mirë gjendjes sime shpirtërore - dramës së njeriut që është detyruar të braktisë follenë e tij ekzistenciale, shtëpinë ku jeton - sesa vargjet e kësaj poezie brilante. I përsërisja në vete vargjet tronditëse të Bilalit: *“Na e tregojnë drejtimitin plumbat, që vërshëllejnë në errësi të. / Na e ndriçojnë rrugën flakët, që tërë tokën kanë përpirë / Pas shpinave tona përplas tufani dyert e shkallmuara të shtëpive / dhe rrugët zgjaten e zgjaten në veri. / Ne, popull muhaxhir, ecim nëpër shi... / Lamtumirë, Çamëri!”*. I përsërisja këto vargje gjatë gjithë kohës sa zgjaste fushata e bombardimeve, me shpresë se me Kosovën nuk do të ndodhte, në fund të shekullit XX, ajo që ndodhi me Çamërinë kah mesi i këtij shekulli, por edhe më herët e më vonë.

Vjersha *Baladë çame*, e vlerësuar nga kritika si poezi antologjike, nuk është i vetmi krijim artistik i poetit Bilal Xhaferi, që evokon fatin tragjik të krahinës shqiptare të Çamërisë, në të cilën gjashtëdhjetë e dy vjet më parë ndodhi fenomeni që në gjuhën politike njihet me emrin “spastrim etnik”. E afërt me të, si vazhdim i saj, është vjersha *Natë çame*, në të cilën, nëpërmjet përjetimit të thellë emocional dhe figuracionit të fuqishëm artistik relievohet në mënyrë më të plotë drama tragjike e Çamërisë. Pas dëbimit të dhunshëm të banorëve të saj nga Thesprotia e dikurshme, e bukur dhe e plleshme, me ullinj, vreshta, stane e kullota, me blegërima dhensh e të lehura qensh, pason heshtja dhe vdekja, që shprehet fuqishëm në vargjet: *“Vetëm hëna posi dele e ndarë nga kopeja / Nëpër shtigjet e reve baret e vetmuar”* dhe *“Hesht në errësi të Çamëria shkretëtirë”*.

Gjatë kohës së qëndrimit në Greqi, pas arratisjes nga Shqipëria në gusht të vitit 1969, do të ketë zënë fill vjersha *Janinë, vjeshtë*, që po ashtu hyn në radhën e vjershave çame të Bilalit. Si strukturë tekstore ajo ndryshon pak a shumë nga dy të parat, *Baladë çame* dhe *Natë çame* (është e shkruar në vargje monokolone, kryesisht pa rimë), por si frymë dhe preokupim është në të njëjtën vazhde. Krahas figurës së Ali Pashës dhe lavdisë së dikurshme të qytetit të Janinës, në të spikatet tjetërsimi i pashmangshëm i kësaj selie të krenarisë shqiptare; bjerrja e identitetit të Janinës së dikurshme, e cila: *“Do të humbasë në Joaninën e re me neon”*. Neoni si element i jetës moderne dhe shkronja “o”, që shpreh greqizimin e kryeqendrës së dikurshme të vilajetit, e thellojnë kontrastin mes të djeshmes dhe të sotmes: *“Liqeni i Janinës - luginë plot me ujë / Përkundet i përgjumur në mjegullën mëngjesore”*, ndërsa “tej sinorit me tela”, stërnipat e Pirros, shqiptarët e sotëm, kalojnë kryeulur: *“Me një mendim të heshtur, me një brengë përvëltonjëse”*.

Brenga përvëltonjëse për Çamërinë e shkretëruar, për Shqipërinë nën diktaturë dhe për Kosovën nën sundim e terror, do ta ndjekë pas gjatë tërë jetës poetin Bilal Xhaferi.

Historia tragjike e popullit të tij dhe jetëshkrimi vetjak i një poeti fatkeq e endacak, do të shkrihen në krijimtarinë e tij në një tërësi organike.

Shkrimtar me ndjeshmëri të lartë ndaj përkatësisë etnike dhe kauzës kombëtare B. Xhaferi do të trajtojë në krijimtarinë e tij, krahas temës së Çamërisë, me të cilën ishte i lidhur si mishi me thuan, edhe temën e Kosovës, të cilën po ashtu e kishte shumë për zemër. Në vjershën *Kosova*, të botuar te revista "Krahu i Shqiponjës", ai e karakterizon Kosovën si vend ku shqiptarët "flasin një gjuhë", gjuhën shqipe dhe "dëgjojnë dy gjuhë"; së bashku me gjuhën e nënës edhe gjuhën e UDB-së. Në përditshmërinë e njeriut kosovar shkronjat UDB shfaqen kudo si një makth. Mu për këtë, Kosovën poeti e percepton, nëpërmjet figurës së personifikimit, që është karakteristike për stilin e tij, "me dhëmbë shtrënguar dhe me shpirt ndër dhëmbë", ashtu gjithnjë, në luftë të pareshtur për liri e ekzistencë. "*Kosova - gjithnjë ... ashtu*", shprehet poeti nëpërmjet elipsës dhe reticencës.

Në kundërshtim me ndarjet administrativo-politike, të bëra nga autoritetet serbe (jugosllave) me qëllim dezintegrimit të hapësirës shqiptare, Kosovë për këtë poet nuk është vetëm territori i Kosovës së sotme, ish-krahinës autonome të Kosovës, por të gjitha viset shqiptare të mbetura jashtë kufijve të Shqipërisë - nën sovranitetin jugosllav - nga luftërat ballkanike e gjer më sot. Kosova e Bilal Xhaferit shtrihet nga ujërat e kulluara të Ohrit, te minierat e errëta të Mitrovicës e deri te brigjet e kaltra të Ulqinit. Bile edhe më tej - deri te Qelekulla e Nishit, ku historikisht fillon gjenocidi mbi shqiptarët ose, siç shprehet poeti, me gjuhën e poezisë, ku fillojnë "themelet e gjakut". Nuk mungojnë në vargjet e kësaj vjershe as emrat e qyteteve me rëndësi historike si Manastiri e Prizreni dhe të dy pikave të tjera kyçe të gjeografisë shqiptare - Plavës e Gucisë, që iu shkëputën Shqipërisë nga koha e Kongresit të Berlinit.

Temat dhe idetë e trajtuara në poezi, Bilal Xhaferi do t'i rimarrë edhe në prozë, për t'i trajtuar ato me mjetet shprehëse të një proze me taban të fuqishëm kombëtar e me prosede kryesisht realist. Këtu hyjnë tregimet: *Vdekja në udhët e Çamërisë*, që më shumë se tregim i mirëfilltë është një skicë, pastaj tregimi *Vajza nga brigjet e lumit Kalama* dhe, pjesërisht, edhe novela *Përtej largësive* dhe romani *Krastakraus-Ra Berati*.

Tregimi *Vajza nga brigjet e lumit Kalama* është një himn kushtuar Çamërisë, kujtimit të saj, të ruajtur brez pas brezi në kujtesën e çamëve të shpërndarë anembanë krahinave e qyteteve të Shqipërisë. Gjyshja e vajzës së qytetit verior, infermieres që i mjekon plagën personazhit narrator të këtij tregimi, çdo gjë në jetë e lidh me Çamërinë. Çamëria në kujtesën e saj i ngjan një parajsë të humbur a Edeni tokësor: "*... Çamëria është më e mira nga të gjitha, më e bukura nga të gjitha, më e pasura nga të gjitha. Qumështi, ullinjë e mjalti i Çamërisë, aromat e Çamërisë, delet e Çamërisë e varret e përrallat e Çamërisë, të gjitha janë krejt ndryshe, të pakrahasueshme, të çuditshme*".

Në novelën *Përtej largësive*, një krijim po ashtu antologjik i këtij shkrimtari, Bilali krijon imazhin e Dardanisë antike dhe rrëfen sagën e luftërave të saj kundër pushtuesve romakë. Rrallë ndonjë shkrimtar tjetër yni ka ditur të skalisë me aq

plasticitet figura heronjsh kalorësiakë e me shpirt artisti si Ergysi e Algaldi dhe vajzash të bukura e trime si Amarda, që e dashurojnë edhe njëri edhe tjetri. Portreti i Amardës, vashës dardane, që e flizon veten për hir të paqes mes fiseve kryengritësve, duket si i gdhendur në mermer nga pena e Bilal Xhaferit.

Nga e kaluara e largët, e periudhës ilire, tek e cila gjen analogji me të sotmen, sidomos kur përshkruan plagën e përçarjes, imagjinata krijuese e poetit hidhet tek e sotmja. Në prozën *Përtej Rrajcës në Kalisht*, konform konceptit të tij për tërësinë etnike, Bilali trajton një ngjarje të lokalizuar në atë pjesë të Shqipërisë, që tani quhet "Maqedhoni", si thotë ai. Matricë e tregimit është një ngjarje e vërtetë nga jeta e banorëve të fshatit Kalisht të Strugës, buzë liqenit të Ohrit - një grindje mes dy familjeve, njëra shqiptare, tjetra maqedonase, të cilën Bilali, me gjasë, do ta ketë dëgjuar nga mërgimtarët tanë në Amerikë. Edhe pse ngjarja në fjalë është më e hershme në kohë (e vitit 1968) Bilali duket me qëllim e hedh në vitin 1981 si vit i daljes në skenë të çështjes së pazgjidhur shqiptare në ish-Jugosllavi. Kalishti i Strugës, "përtej Rrajcës", si thotë autori, ka lidhje të forta me Kosovën dhe kjo është pjesë e strategjisë së autorit për ta shtrirë hartën e frymëzimeve të tij në tërë hapësirën etnike dhe për ta forcuar kohezionin shpirtëror të botës shqiptare.

Pikëpamjet e tij për Kosovën dhe Çamërinë, sikundër edhe për çështjen shqiptare në përgjithësi, shkrimtari dhe intelektual B. Xhaferi do t'i shprehë shumë më qartë dhe në mënyrë më të drejtpërdrejtë në publicistikën e tij. Derisa në poezitë për Kosovën dhe Çamërinë ai flet, siç do të thoshte poeti dhe teoricieni i njohur i romantizmit anglez S. T. Kolërixh, "me gjuhën e pasionit dhe të imagjinatës", në shkrimet publicistike, ndonëse as në to nuk mungon patosi emocional dhe shprehja figurative, gjurmon fakte dhe të dhëna historike, politike e të tjera. Me anë të tyre autori synon të dëshmojë dhe të demaskojë politikën shoviniste të zhvilluar një shekull e më shumë nga shovinistët serbë dhe grekë ndaj këtyre dy krahinave shqiptare të shkëputura nga trangu amë, në të cilat, siç thoshte Noli në një artikull të tij të vitit 1921, zhvillohej një tragjedi në tri akte: shpasurim, shpërngulje, shfarosje.

Ngjarjet e vitit 1981, demonstratat e studentëve dhe të rinisë shqiptare të Kosovës, tërhoqën me të madhe vëmendjen e poetit dhe të intelektualit atdhetar B. Xhaferi, i cili kishte vite që jetonte në SHBA. Në revistën me emër simbolik "Krahu i Shqiponjës", të drejtuar prej tij, ai u bëri jehonë këtyre ngjarjeve me shkrimet e veta letrare e publicistike, në të cilat mbështeste kërkesat e studentëve kosovarë dhe sidomos parullën: "Kosova Republikë", që ishte kërkesa kryesore e ngjarjeve të '81-shit; gjykoi ashpër dhunën e organeve shtetërore jugosllave mbi demonstruesit (vrasjet, burgosjet, keqtrajtimet), si dhe heshtjen, në të vërtetë reagimin e vonuar të Tiranës zyrtare, ndaj këtyre ngjarjeve.

Në artikullin me titull *Kosova e tradhtuar*; të shkruar në qershor të vitit 1981, pasi shtjellon gjerësisht, në plan diakronik, qëndrimin e shtetit komunist shqiptar ndaj çështjes së Kosovës, Bilali shqipton këtë fjali profetike: "Ne nuk mund të kemi kurrë Kosovë të çliruar, po nuk patëm Shqipëri të lirë". Demokratizimin e Shqipërisë, daljen e

saj nga diktatura e “sulltanëve të kuq”, siç shprehej në mënyrë sarkastike, Bilali e shihte si kusht për çlirimin e Kosovës.

Publicistika e B. Xhaferit ka vlera të mëdha njohëse, shoqërore e politike, por ajo nuk është e privuar as nga vlerat e saj gjuhësore e artistike. Edhe në publicistikë, sikurse në poezi e prozë, ai është artist i fjalës. Një serie shkrimesh publicistike të “Krahu i Shqiponjës” Bilali i vuri titullin “Fort po shndrit ai diell e pak po nxe”, që është, siç dihet, një nga vargjet më të bukura e më kuptimplote të ciklit të kreshnikëve, një varg, do të thosha, antologjik në përmasa botërore. Duke iu kundërvënë mendësisë krahinoriste e provinciale të mërgatës shqiptare (mendësi kjo që nuk mungon as te një pjesë e konsiderueshme e shqiptarëve që jetojnë në trojet etnike e jo vetëm në diasporë), ai shkruan:

“Ju shqiptarët e Shqipërisë, thonë ata që vijnë nga trojet jashtë kufirit shtetëror. Po si kështu, bre, vëlla? Kur unë jam shqiptar i Shqipërisë, po ti i kujt je? I dreqnisë? Përderisa jemi shqiptarë, ne jemi të gjithë shqiptarë të Shqipërisë, se në këtë plan ekziston vetëm një Shqipëri, vetëm një dhe ne jemi bijtë e saj. Ti vjen nga Kosova e unë nga Çamëria, ai tjetri nga Myzeqeja e ai tjetri nga Mirdita, po këto krahina janë të gjitha pjesë të kombit shqiptar dhe ne nuk duhet ta ndajmë njëri-tjetrin me një logjikë të çmendur principatash. Që t’i bëjmë ballë serbit e grekut, kusht i parë është që të flakim nga mendja jonë kufijtë imagjinarë që ndajnë shqiptarin nga shqiptari”.

Çamëria e ringjallur, Kosova e pavarur dhe Shqipëria e bashkuar, përbëjnë idealin e poetit dhe atdhetarit Bilal Xhaferi. Si në poezi e në prozë, ashtu edhe në shkrimet publicistike, atë e preokupon fati i Shqipërisë në kuptimin etnik e jo politik të fjalës, por edhe fati i njeriut si individ, pa të cilin nuk mund të ketë shtet modern e demokratik. Ky preokupim, i shprehur në mënyrë artistike e jo në formë propagandistike, e përshkon si një pe i kuq tërë krijimtarinë letrare dhe publicistike të Bilal Xhaferit.

(Kumtesë e lexuar në konferencën shkencore kushtuar çështjes çame, të mbajtur në Tiranë më 21 dhjetor 2006)

Ahmet Xhafo

Zgjidhja e ceshtjes came ne menyre paqesore

Te nderuar zonja dhe zoterinj. Me lejoni t'ju falenderoj ne emer te Shoqates per te drejtat e Camerise, deges se USA, per prezencen tuaj ne kete eveniment te rendesishem.

Gjithashtu, dua te falenderoj ne menyre te vecante Z. Beqir Meta, Muzeun Historik Kombetar dhe Institutin per Studimet mbi Camerine, per iniciativen e tyre per organizimin e kesaj konference te rendesishme. Ne i jemi mirenjohes ne menyre te vecante, pasi ne nje forum te tille mund te diskutojme probleme te veshtira duke gjetur zgjidhje paqesore. Historia na ka deshmuar se mund te arrijme shume me teper nepermjet dialogut se konfrontimit. Ne kete kontekst do te mbeshtetet dhe opinioni im per nje zgjidhje te problemit per padrejtesine e bere ndaj cameve mbas 63 vjet vuajtjesh.

Une e vleresoj mundesine qe me eshte dhene si nje nga te mbijetuarit e kesaj masakre, gjithashtu ne te njejten kohe si nje activist i te drejtave njerezore, si nje qytetar amerikan, shqiptar, grek, dhe si nje qytetar i europes se bashkuar ne te njejten kohe, per te kontribuar ne nje zgjidhje paqesore te problemit cam.

Une kam lindur ne Filat, Cameri, Greqi ne Mars te vitit 1937. U largova forcerisht nga vendi im ne vitin 1944 dhe gjeta strehim perkohesisht ne Shqiperi, per ti shpetuar krimeve te qeverise greke te cilat u mbeshteten ne fabrikime dhe falsifikime te se vertetes. Familja ime si dhe mijera te tjere u priten ne menyre shume te ngrohte nga vellezerit tane shqiptare te cileve u jemi mirenjohes perjete. Fati yne i keq vazhdoi gjate sistemit komunist i cili i mbylli rruget e komunikimit me boten perendimore per rreth 50 vjet. Ne vitin 1959 une u arratisa dhe emigrova ne Amerike, ku u diplomova dhe u bera nje qytetar produktiv amerikan, shtet ne te cilin une vazhdoj te jetoj.

Mbas ketij prezantimi te shkurter, me lejoni te prezantoj hapat, te cilat sipas mendimit tim jane shume te rendesishme per te sjelle nje zgjidhje perfundimtare per te tere ne:

Ngritja e problemit Cam ne arenen nderkombetare

Kjo gje mund te arrihet nepermjet konferencave si kjo e sotmja te cilat do te hedhin drite nepermjet paraqitjes se fakteve te verteta mbi masakrat e ushtruara mbi popullsin e came dhe pastrimin etnik ne vitet 1944-45. Organizatat came duhet te bejne te njohur keto fakte EU dhe qeverise amerikane, si dhe te punojne per nje sensibilizim te opinionit per t'iu kundervene propagandes greke.

Gjithashtu, duhet bashkepunuar me organizatat e te drejtave te njeriut per te parashtruar vuajtjet e minoritetit cam si ne Greqi ashtu dhe jashte saj. Vellezerit tane came ortodokse ne greqi nuk lejohen te flasin apo shkruajne gjuhen e tyre. Ne greqi nuk ka shkolla publike apo private ne gjuhen shqipe. Camet nuk lejohen te vizitojne shtepite e tyre apo varret e gjysherve te tyre. Opinioni boteror duhet te dije te verteten dhe ne jemi ata qe duhet t'ia tregojme sa me shpejt dhe sa me mire. Ne duhet te bejme nje pune sa me te mire ne dhenien e informacionit te drejte dhe adekuat mbi pastrimin etnik te cameve duke ia kundervene propagandas greke.

Bashkepunim me qeverine Shqiptare

Popullsia came duhet te bashkohet e te organizohet, dhe ti kerkoje qeverise shqiptare qe nepermjet dialogjeve me qeverine greke, ti jepen te drejtat qe i takojne minoritetit shqiptar ne greqi dhe te lejoje camet te kthehen ne vatrat e tyre. Greqia kerkon hapjen e shkollave greke ne shqiperi nderkohe qe nuk lejon hapjen e shkollave shqipe ne greqi. Kjo gje eshte vice versa.

Qeveria greke duhet te pastroje koshiencen e saj

Qeveria e tanishme duhet te pranoje pergjegjesite e qeverive te meparshme per persekutimin dhe pastrimin etnik ushtruar ndaj popullsise came. Perballohuni me realitetin dhe ndaloni propaganden kundra cameve. Greket e dine shume mire te verteten qe camet nuk bashkupunuan me nazismin. Ishte biri i dashur i populli te tyre Napolon Zerva, ai qe bashkepunoj. Merrni nje shembull nga trajtimi i minoriteteve ne Usa dhe i lejoni ata ate kontribuojne ne mireqenien e puneve ne Greqi. Nqs ndonje qytetar cam ka bashkepunuar me nazismin ai duhet ti nenshtrohet drejtesise, qe te denohet sipas ligjeve perkatese. Na lini te krijojme nje vend ku njerezit te jetojne ne paqe. Punoni me Shqiperine si fqinje te mire dhe partnere te barabarte dhe hiqni dore nga ksenofobite.

Qeveria amerikane duhet te luaje nje rol te rendesishem

Qeveria amerikane duhet te loze nje rol paresor per te zgjidhur kontradiktat midis paleve. Duke perdorur influencen e saj te siguroje qe te tera palet te negociojne ne rruge te drejte. Gjithashtu te ndikojte dhe ne zgjidhjen e ketij problemi ne Greqi apo EU per mbrojtjen e te drejtave humane te minoritetit cam, pavaresisht sa i madh eshte ky minoritet, perkatesise etnike apo besimit fetar.

Pergjegjesite e EU

Une besoj se EU eshte forca me e rendesishme, qe ben te mundur qe anetaret e tij, te jetojne sipas rregullave dhe ligjeve te EU. Camet si anetare te EU kane te drejtat qe ka cdo qytetar tjeter ne Europe. Anetaret e nje komuniteti kane pergjegjesi per veprimet e tyre. Parlamenti european duhet te marre ceshtjen came ne konsiderate dhe ti kerkoje Greqise qe te veproje si nje shtet i EU duke respektuar te drejtat njerezore.

Kthimi i cameve ne tokat e tyre pa ndryshimin e kufijve

Kthimi i cameve ne tokat e tyre eshte ceshtja me e rendesishme. Te drejtat humane, e drejta e besimit, e gjuhes, e shkollimit ne gjuhen amtare dhe mbrojtja e trashegimise kulturore jane nje kusht per nje bashkejetese ne paqe.

Une mendoj se zgjidhja e problemit cam do ti forcoje lidhjet midis shtetit grek dhe atij shqiptar dhe do te krijoje nje atmosfere mirebesimi. Organizatat came jane gati per tu takuar dhe adresuar keto probleme.

Le te shpresojme, qe ne ta shohim kete si nje mundesi dhe si nje pergjegjesi per te sjelle paqe ne kete rajon te trazuar Ballkanit, qe ka hasur veshtiresi per nje kohe te gjate. Popullsia came ka treguar tolerance dhe mirekuptim per nje kohe te gjate. Ka ardhur koha e kthimit ne trojet e te pareve te tyre. Une shpresoj dhe lutem qe qeveria greke do te kuptoje kete fakt dhe do te riparoje ate qe eshte bere ne te shkuaren.

Faleminderit per vemendjen dhe mirekuptimin.

PROF. DR. MUHAREM DEZHGIU

**ÇËSHTJA E ÇAMËRISË NË DOKUMENTET ITALIANE
GJATË LUFTËS II BOTËRORE**

Pas pushtimit të Shqipërisë, më 7 prill 1939, politika italiane synonte të fitonte mbështetjen e shqiptarëve për realizimin e planeve të mëtejshme agresive në Ballkan. Në qëndrimin e tyre ndaj shqiptarëve italianët iu referuan dhe historisë së hidhur të shqiptarëve. Italianët shfrytëzuan për interesat e tyre padrejtësitë që u ishin bërë shqiptarëve nga diplomacia ndërkombëtare, sidomos për çështjen e kufijve.

Nëpërmjet propagandës, në formë të hapur ose të fshehtë u kujtohej shqiptarëve historia e hidhur e trojeve shqiptare të mbetura jashtë kufijve politikë të Shqipërisë. Me anë të një evokimi të tillë të historisë së shqiptarëve italianët shprehnin njëherazi disa synime për t'i arritur:

Së pari, synonin të zgjonin tek shqiptarët sedrën nacionale për të vepruar tani që ishte rasti (duke nënkuptuar ndihmën dhe mbështetjen e Italisë) për të bërë bashkimin e trevave shqiptare, të lëna jashtë kufijve të saj.

Së dyti, italianët synonin t'i nxisnin shqiptarët për të qenë të gatshëm të bënin sakrifica në ndërmarrjen italiane për pushtime të reja në Ballkan.

Së treti, italianët gjenin rastin të godisnin politikën e Zogut, që, sipas tyre, edhe pse quhej “mbret i shqiptarëve”, nuk kishte ndjekur një politikë kombëtare, për të bashkuar gjithë trojet

shqiptare në shtetin e tij. Në këtë rast italianët u ofronin mbështetjen dhe përkrahjen politike për bashkëpunim edhe kundërshtarëve politikë të A. Zogut, të cilët erdhën në Shqipëri pas pushtimit të saj.

Sa herë që ministri i Jashtëm italian, Çiano vinte në Shqipëri, me fjalimet e tij ekzaltonte “shpirtin nacionalist shqiptar”⁹, duke iu referuar ndjenjave të shqiptarëve për çështjen e Kosovës e të Çamërisë.

Me një propagandë të tillë donte të nxiste shqiptarët për t’i angazhuar në veprimet ushtarake që do të ndërmerrnin italianët në drejtim të shteteve fqinjë të Shqipërisë.

Një propagandë e tillë nga ana italianëve u manifestua sidomos në fazën e përgatitjes së fushatës italiane kundër Greqisë.

Gjatë vizitës që bëri Çiano në Shqipëri, në maj të vitit 1940 u prit dhe u shoqërua me parulla për Kosovën dhe Çamërinë. Në ditarin e tij ai do të shprehej entuziast për rolin e shqiptarëve, sepse, sipas tij “Shqiptarët tashmë kanë hyrë mirë në rrugën e ndërhyrjes së armatosur. Ata e duan Kosovën e Çamërinë”¹⁰. Siç duket, italianët e prisnin me interesim këtë dukuri të gjendjes shpirtërore të shqiptarëve, duke e konsideruar një faktor me peshë për realizimin sa më lehtë të planeve të tyre. Ata shpresonin në gadishmërinë e tyre për t’i shfrytëzuar në fushatën e armatosur, paçka se sa realiste ishte kjo shpresë.

Çamëria dhe çamët ishin në fokusin e të dy palëve, italianëve dhe grekëve, për të gjetur aty argumente e kundërargumente, si një pretekst të fillimit të konfliktit ushtarak midis tyre.

⁹ Galeazzo Ciano, *Diario (1937-1943)*, f.93.

¹⁰ *Po aty*, f.254.

U organizuan incidente të ndryshme në zonën kufitare me Çamërinë për t'i shfrytëzuar secila palë për interesat e veta.

Italianët nga ana e tyre, bënë një propagandë të dendur, për t'i paraqitur e trajtuar vrasjet e shqiptarëve, siç ishte ai i Daut Hoxhës, jo si një rast i veçantë e të shkëputur nga ndodhi të tjera me shqiptarët e Çamërisë, por këto ndodhi ishin rezultat i shtypjes së vazhdueshme të shqiptarëve çamë nga ana e Greqisë. Pavarësisht se nga ç'qëllim niseshin italianët gjendja e vështirë e shqiptarëve ishte një realitet në Çamëri.

Çështja çame dhe problemi i Çamërisë, në prag të luftës italo-greke ka gjetur një pasqyrim të dukshëm në dokumentet italiane si një problem i mprehtë diplomatik. Siç del nga informacionet e ambasadorit italian në Athinë, Grazzi konfirmoj se, "Çështja e Çamërisë nuk ka qenë trilluar prej Italisë. Ajo ekziston që prej vitit 1912 ... Disa herë kam pasur rastin, - vazhdon Grazzi, - t'i kujtoj ministrit grek Mavrudis për situatën e shqiptarëve në atë provincë (të Çamërisë), për vështirësitë e ngritura për kalimin e kufirit dhe ushtrimin e lirë të të drejtës së provës, për pengesat në kontaktet midis shqiptarëve për kalimin e kufirit"¹¹.

Çështjen e vrasjes së D. Hoxhës ai e konsideronte, në të njëjtin informacion, një vazhdim i vrasjeve të mëparshme që ka bërë Greqia kundër pjesëmarrjes shumë aktive të çamëve në luftën për çlirim kombëtar të asaj krahine (të Çamërisë)¹².

Fushatën propagandistike gjatë përgatitjes për luftë kundër Greqisë, Italia e intensifikoi në përputhje me përmbushjen e detyrave ushtarake. Kur kjo propagandë kalonte kufijtë e

¹¹ *Documenti diplomatici italiani (DDI)*, Nona Serie (1939-1943), vol.5, dok.409, f.392. Raport i ambasadorit Grazzi nga Athina për Çianon, 13 gusht 1940.

¹² *Po aty*.

interesave italiane, siç ndodhi me gazetën “Tomorri” në Tiranë, nënsekretari i Shtetit për Shqipërinë, Benini, i kërkonte Jakomonit, Mëkëmbësit të Mbretit italian në Tiranë, që “gazeta të pakësojë momentalisht fushatën e mëparshme dhe të heshtë brenda një kohe të shkurtër”¹³.

Mëkëmbësi italian në Shqipëri, Jakomoni ndiqte me vëmendje të gjitha veprimet që kishin të bënin me fillimin e luftës.

Në informacionet e tij për Çianon vinte në dukje atmosferën entuziaste që ekzistonte, për shpirtin rivendikues të popullit shqiptar, për mbështetjen e figurave të njohura si Faik Konica e Mehdi Frashëri, që të dy me kulturë të thellë e shumë të vendosur. Duke iu referuar emisarëve, të ardhur nga Çamëria, bëhej e ditur, sipas Jakomonit, se “çamët presin me ankth çlirimin e tyre. Ata nuk kërkojnë veçse armë për të sulmuar shtypësat në çastin e përshtatshëm”¹⁴.

Në dokumentet diplomatike sillet informacion për misionin e kryer nga Nebil Dino, këshilltar i lartë fashist gjatë shërbimit në Greqi. Duke kaluar në Çamëri, posaçërisht në Prevezë, ku ka takuar dhe me popullsinë çame, informonte për situatën atje. Sipas tij “paria greke që banojnë në krahinën e Çamërisë, ato më të urryerit nga shqiptarët po transferoheshin gjetkë, të tjerë kërkonin të krijojnë një ambjent të favorshëm, disa prej këtyre të fundit kanë vënë në dispozicion të Nebil Dinot shumën e dukshme për vepra bamirësie për mbrojtjen e tyre”¹⁵.

Mbështetur në shpresën se shqiptarët e Çamërisë do të ishin në anën italiane, gjatë sulmit të këtyre të fundit kundër Greqisë,

¹³ *Po aty*, dok.469, f.454, shënimi 2.

¹⁴ *Po aty*, dok.483, f.468. Promemorie e Jakomonit për Çianon, 24 gusht 1940.

¹⁵ *Po aty*, dok.509, f.493. Promemorie e Jakomonit për Çianon, 27 gusht 1940.

Shtabi i Lartë italian, vendosi që sulmin kundër Greqisë ta bënte në dy faza. Në fazën e parë pushtimi do të shtrihej në Epir dhe në ishujt e Jonit dhe në fazën e dytë pushtimi do të shtrihej në të gjithë territorin grek¹⁶.

Gjatë zhvillimit të veprimeve luftarake italo-greke nuk u përlligjën shpresat e Çianos, të Jakomonit apo të hierarkëve të tjerë ushtarakë italianë për mbështetjen e shqiptarëve. Këta të fundit, shfaqën një mungesë të theksuar entuziazmi, qoftë për italianët, qoftë për grekët¹⁷.

Në dokumentet e ushtrisë italiane në Greqi ka mjaft relacione që japin të dhëna demografike-historike, ekonomike e politike me interes për krahinën e Çamërisë. Në një relacion të gushtit 1942¹⁸ thuhet se “Sipas regjistrimit grek të vitit 1936 provinca ka një popullsi rreth 74 mijë banorë të ndarë në këtë mënyrë: grekë-ortodoksë: 20 000; shqiptarë-ortodoksë: 26 000; shqiptarë-myslimanë: 28000. Çamët e gjuhës shqipe dhe të fesë myslimane ... nuk kanë asgjë të përbashkët me grekët. Pjesa e popullsisë myslimane që nuk pranoi Traktatin e Lozanës (1923) për këmbim të popullsisë midis Turqisë dhe Greqisë mbeti në vend dhe u orientuan drejt Shqipërisë. Numri prej 60 mijë, para vitit 1923 ka shkuar duke u reduktuar dora-dorës. Aktualisht banojnë në zonën Perëndimore e Qendrore të Çamërisë (Filat-Paramithi-Margariti) në fshatra të zënë ekskluzivisht prej tyre ose mikse me grekët.

¹⁶ *Po aty*, dok.728, f.699-705. Riunione presso il Capo del Governo Mussolini, Palazzo Venezia, 15 ottobre 1940.

¹⁷ Bernd J. Fischer, *Albania and the Italian invasion of Greece, October 1941*, në librin “Greece and the War in the Balkans, 1940-1941”, Selanik, 1992.

¹⁸ *USSMEI*, Raccogl.22, Fasc.8-22. Relazione del Com. Sup. Forze Armate Grecia (11^a Armata) Carlo Geloso al Comando Supremo, Posta militare 21, 3 agosto 1942.

Qeveria greke përballë Çamërisë zbatoi gjithmonë veprime të dyndjes graduale të elementëve grekë dhe veprime të persekutimit kundër myslimanëve. Kjo politikë e shtrirë në të gjitha aspektet e jetës politike e administrative lokale, duke ngjallur kështu në shpirtrat e shqiptarëve urrejtje të thellë kundër elementit greko-ortodoks.

Në relacion vihej në dukje fakti se “Legjislacioni agrar grek i vitit 1919, me pretekstin e luftës kundër sistemit të latifondeve, të përhapur në Thesproti (Çamëri), ka synuar, mbi të gjitha, të lehtësojë dyndjen e elementit grek”.

Mllefet e vjetra midis dy grupeve etnike (greko-ortodokse dhe shqiptaro-myslimane) janë theksuar prej keqtrajtmeve e dhunës së kryer në dëm të myslimanëve gjatë konfliktit italo-grek me veprën e autoriteteve ushtarake, civile e të policisë greke.

Në fillim të konfliktit, myslimanë të shumtë u pushkatuan në afërsi të Igumenicës, ndërsa të tjerë u mbyllën në një lokal, të përshtatur për burg, ku disa kanë vdekur nga uria dhe keqtrajtimi i pësuar. Shumë myslimanë të tjerë janë internuar në kampet e përqendrimit të Mitilenit e të Kios.

Pavarësisht nga këndi i vështrimit politik të evidentimit të këtyre fakteve e ndodhive në Çamëri, këto të dhëna paraqesin një interes të posaçëm për çështjen çame dhe Çamërinë. Këto të dhëna pohojnë të vërtetën historike mbi diskriminimin e popullsisë çame në mënyrë të vazhdueshme e konstante. Madje, konflikti luftarak botëror u shfrytëzua nga politika greke për të pastruar etnikisht popullsinë shqiptare të Çamërisë. Masakrat greke në verën e vitit 1944 e detyruan popullsinë myslimane-shqiptare të Çamërisë të

largohej përdhunisht drejt Shqipërisë. Çështja çame ka mbetur një çështje që pret rrugën e zgjidhjes historike e reale.

Miranda VICKERS
James PETTIFER

Drejtuar pjesëmarrësve në konferencën e Çamërisë

Viti 2006 ka qenë shumë i sukseshëm në ndërkombëtarizimin e çështjes Çame. Protestat e Qershorit në kufirin grek ndihmuan që komuniteti ndërkombëtar të sensibilizohet dhe një herë për natyrën paqësore, por të vendosur të fushatës së komunitetit çam për njohjen e së drejtës të pronave të tyre në Greqi. Partia për Drejtësi dhe Integrim ka punuar intensivisht në publikimin e çështjes Çame dhe vizita në Strasburg ishte një sukses i plotë. Unë jam e sigurtë që Znj. Doris Pack do ta çojë çështjen që ju ngritët , në parlamentin European për ti hapur rrugë një debati të mundshëm. Nëse jo publikisht ajo do të ndjekë kanale private. Pas punës suaj intensive gjatë këtij viti nuk ekziston asnjë arsye që organizatat ndërkombëtare ose misionet diplomatike të mos jenë në dijeni të çështjes çame përsa i përket çështjes së nënshtetësisë dhe të drejtës së pronës. Shpresohet që në vitin 2007 do të mbahen bisedime serioze ndërmjet qeverisë shqiptare dhe asaj Greke, gjithashtu dhe përfaqësuesve Çam së bashku me vëzhguesit ndërkombëtarë që më në fund ti japin një zgjidhje çështjes dhe të mundësojnë forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve Shqiptaro- Greke. Ky është konkluzioni i raportit tim të ri mbi çështjen Çame i cili do të publikohet në janar të vitit 2007, ku përmenden ngjarjet kryesore në lidhje me çështjen çame që nga publikimi i raportit tim të fundit në Prill të vitit 2002. Shpresohet që periudha e publikimit në fillim të vitit do të ndihmojë në fokusimin e të gjitha palëve të interesuara që kjo çështje të zgjidhet sa më shpejt dhe sigurisht në interes të Çamëve dhe gjithashtu në interes të Shqipërisë për sa i përket perspektivës së saj për antarësim në Bashkimin European.

Urimet më të mira për 2007

Miranda VICKERS

Drejtuar: Konferencës për Çamërinë, Tiranë Dhjetor 2006

Nga Profesor James PETTIFER

UK, December 18th, 2007

Jam i lumtur të dërgoj përshëndetjet e mia Konferencës së Rëndësishme që po mbahet me qëllimin e sensibilizimit të mëtejshëm të çështjes Çame në Shqipëri. Në vitin e fundit, 2006, ka patur zhvillime të rëndësishme për sjelljen e kësaj çështje në nivelet e kërkuara në bisedimet ndërkombëtare, dhe jam i sigurtë që ky process do të vazhdojë edhe në vitin 2007.

MARKO BOÇARI DHE KONTRIBUTI I TIJ NË LËVIZJEN ÇLIRIMTARE DHE NË SHKENCËN GJUHËSORE

(Marko Boçari nga Suli i Çamërisë, 1790-1823)

Marko Boçari lindi në Sul të Janinës më 1790, në një familje të dëgjuar që kishin dalë shumë burra trima si: Kiço Boçari, Kosta, Dhimitri, Jorgji dhe kapedani i madh i Kryengritjes të 1821, Noti Boçari i cili ka lindur në Sul në vitin 1759. Ai është ministri i parë i mbrojtjes i shtetit grek, dhe vdiq më 1841.

Babai i Markos, Kiço Gj. Boçari u martua tri herë. Nga këto tri martesë kishte 18 fëmijë, pesë prej tyre i vdiqën të vegjël. Nga martesë e parë me Krisulla Papazotin Joti, kishte Janin, Lenën, Marinë, Anastasinë dhe Markon.

Kiço Gj. Boçari u vra më 1813 në Artë nga Gjoko Bakola.¹ Në vitet e kryengritjes së 1821, Marko Boçari i dha duart dhe u përqaftua për të mirën e përbashkët me Gjoko Bakola duke i falur gjakun e babait.

Sipas të dhënave banorët e parë që u ngulën në Sul ishin ushtarët e gardës të Gjergj Kastrioti Skënderbe. Mbas vdekjes së Gjergj Kastrioti Skënderbeut, rreth 200 luftëtarë arvanitas me familjet e tyre, si fisi Boçari, Xhavellasit, Llalla, Dangëllinjë, Dragove etj., formuan fshatin e Sulit afër qytetit të Janinës dhe luftonin kundra turqve për lirinë e tyre. Më vonë Suli u zgjerua nga një fshat në krahinë dhe u popullua nga shqiptar ortodoksë çamë. Ata, për t'i

¹ Kalendari i vitit 1990, “ μ 200 (1790-1990)”, Athinë, 1990, “Lidhja e Arvanitasve të Greqisë”.

shpëtuar skllavërisë osmane turke, u shpërngulën nga fshatrat e tyre të Çamërisë rreth viteve 1500-1600 dhe u vendosën në Sul të Janinës, dhe krijuan fshatra të rinj me emra shqiptar. Që një pjesë e popullsisë së sulioteve janë çamër këtë na e deklaroi anglezi V.M. Lik “Suljotët janë një farë e Çamërisë, njëra prej katër degëve të Shqipërisë”.²

Ndërsa studiuesi Ciapolini thotë- “Suljotët nuk dinin fare greqisht, gjuha që ata përdornin është, shqipja e dialektit të Çamërisë”.³

Një pjesë e popullatës së Sulit pasi u nënshtuan Ali Pash Tepelenës u dërguan si dënim në ishullin e Korfuzit dhe ishujt e tjerë për rreth tij.

Ndërsa mbas vdekjes së Ali Pash Tepelenës shumica e popullatës së krahinës së Sulit për ti shpëtuar vrasjeve nga turqit e Sulltanit, morën drejtimin për në malin e Shenjtë të Tomorit duke u vendosur në Leskovik dhe afër qytetit të sotëm të Gramshit dhe formuan krahinën e Sulovës me fshatrat: Shën Mëri, Shën Mitri, Dardhzezë, Sulki, Dushkë, Kushov, Janç, Tunjë etj. Në krahinën e sotme të Sulit në Gramshit ndeshim mbiemrat Llalla, Dragoi, Karaj që i ndeshim sot edhe në krahinën e Sulit të Janinës.

Sulioti Marko Boçari nuk ishte vetëm një nga heronjtë arvanitas më të rëndësishëm të Kryengritjes greke të 1821, i njohur për aftësitë ushtarake dhe guximin e tij, por edhe për dëshirën e madhe për shkrimin dhe edukimin.

Markoja bashkë me Odise Andruçon dhe Gjeorgjio Karaiskaqin u edukuan në oborrin e Ali Pash Tepelenës në artin ushtarak, politik dhe zgjuarsisë.

² Jonuz Kuçuku, “GAZETA SHQIPTARE“, 3 tetor 2001, fq. 12.

³ Po aty.

Ëndrra e Markos ishte që të edukonte suliotët arvanitas që të dilnin nga gjendja e luftëtarit të pamësuar që luftonte pandërprerë, pa një ardhme, të jetojë paqësisht në një shoqëri të lirë e të drejtë. Markoja ndërkohë shqetësohej se mos edukimi mësimor çon në humbjen e disa tipareve të njohura cilësore që e bënin arvanitasin suliot një figurë popullore të veçantë, që edhe brenda mos shkollimit, varfërisë dhe kushteve më të vështira të jetesës, ngjallte adhurim.

“Dua të arsimohesh, i shkruante në letër, djalit të tij Dhimitrit, që gjendej në Ankona të Italisë, por veç kësaj dua të brumosesh me traditat sulioete, të mbetesh përherë suliot siç ka mbetur tata i yt”.⁴

Në atë periudhë të ndryshimeve të shënuara në Ballkan dhe në Europë, dukej qartë se virtyti lirishtës dhe shpata arvanitase nuk ishin të mjaftueshme që të arrihej një jetë më e mirë, një shoqëri më e bukur. Nevojitej edukimi dhe arsimi i popullit dhe kjo nevojë kishte krijuar ankth tek arvanitasit e pas kryengritjes të 1821, që parapëlqenin të shisnin çdo lloj pasurie, me qëllim të mësojë fëmija i tyre.

Dhe sigurisht, në atë periudhë kur thoshim “shkrim e këndim” kuptonim “gjuhën greke” që flitej kryesisht në qytetet e Greqisë së sotme.

Por është fakt, se arvanitasit përbuznin mënyrën e jetesës të shoqërive të tjera, plogështinë, pabesinë, fjalët e shumta, frymën e nënshtrimit, paftërsinë etj.

Karakteri i arvanitas është që ai të jetë kudo i pari, të tregojë përpara të gjithëve kryelartësinë, trimërinë dhe mosnënshtrimin. Arvanitasit e dëshironin edukimin arsimor, por pa rrezikun e

⁴ Arben Llalla, “ESKLUZIVE”, Prishtinë, shkurt 2002, fq. 70.

tjetërsimit dhe bjerrjes së vlerave tradicionale vetjake e të bashkësisë. Kësaj ia ka frikën dhe këtë i theksonte djalin të vet Marko Boçari.

Kur gjendej i internuar në Korfuz, Markoja mësoi greqishten dhe bëri të famshmin “Fjalorin dygjuhësh i greqishtes dhe shqipes së thjesht” (Μ

), 1809, që e shkroi Markoja vetë me ndihmën e babait të tij Kiço Boçari (1754-1813), xhaxhait Noti Boçari (1759-1841) dhe vjehrrit të tij Kristaq Kallogjeri nga Preveza.⁵

Përfundimi i këtij fjalori ishte i nxitjes së konsullit francez Pukëvili, siç pretendonte francezi vet, përpjekje të mësojnë suliotët arvanitas greqisht dhe të merren vesh me grekët.

Si do që të jetë puna, fakt është se kemi të bëjmë me një hero që ka shqetësime kulturore që krijoi një vepër gjuhësore dhe kulturore, si rrjedhim me të drejtë Marko Boçari mundë të quhet si realizuesi i fjalorit të thjeshtë të parë greko-shqip.

Fjalori Marko Boçarit lindi si pasojë dhe e ngjarjeve që po kalonte Greqia, ku mbas dorëzimit të armëve arvanitasit duhet ti përshtateshin jetës civile shoqërore, që për ta ishte e vështirë.

Fjalori ka rëndësi të veçantë se shpreh shumë elementë të gjuhës shqipe në dialektin e çamërishtes, ky fjalor shërbeu edhe si mjet politik për të afruar shqiptarët me grekërit.

Një tjetër detyrim i lindjes së fjalorit greko-shqip ishte se, tregtia në zona të gjera të Ballkanit bëhej në gjuhën greke. Kështu që lindi nevoja e një fjalori dy gjuhësh me qëllim që arvanitasit, pra shqiptarët në një farë

⁵ ,“ .
për botim,

μ

”, Athinë, 1993, fq. 40, përgatiti

mënyre ju detyrua që të mësonin greqisht që po fitonte terren si gjuhë e tregtisë në Ballkan.

Pasi gjuha arvanitase si pasojë e ndjekjeve të arbërve nga pushtuesit e ndryshëm, u duhej që të jetonin të fshehur me shekuj të tërë në male dhe ishuj të vetmuar larg takimeve me popujt e tjerë.

Kështu gjuha arvanitase ngeli një gjuhë e pastër kombëtare, që flitej vetëm nga populli i saj duke ruajtur vjetërsinë dhe pastërtinë gjuhësore, por që nuk u zhvillua në shkrim apo të futeshin fjalë të reja që i përshtateshin zhvillimit shoqëror të kohës apo të njihej nga të huajt e shumtë që vizitonin Ballkanin në atë kohë të pushtimit osmano turk.

Dhe heroi Marko Boçari me një vullnet dhe guxim, në moshën 19 vjeçare na solli fjalorin e parë greko-shqip me titull origjinal “ μ

” (Fjalori dy gjuhësh Greqisht dhe Shqipes së thjeshtë). Fjalori dy gjuhësh përbëhej nga 111 faqe, 1494 fjalë shqipe, dhe 1701 fjalë greke. Origjinali i këtij fjalori gjendet sot në muzeun Kombëtar të Parisit me kodin Supplement Grec 251 numri 244 të faqes, dhe u dhurua në maj të vitit 1819 nga konsulli Pukëvili.⁶

Konsulli i Përgjithshëm francez në Janinë Pukëvili duke studiuar fjalorin e Marko Boçarit, hartoi një fjalor të vogël frëngjisht-shqip, me rreth 440 fjalë dhe origjinali i këtij fjalori gjendet në muzeun Kombëtar të Parisit.⁷

Përpara betejës së madhe në Mesollogji, Markoja mendoi të dërgonte familjen e tij në Ankona të Italisë. Të gjithë suliotët me lot në sy u ndanë me gratë e tyre pa folur, Markoja në ato çaste prekëse i tha gruas -“Në

⁶ Po aty fq. 38.

⁷ Arben Llalla, “EKSKLUZIVE”, Prishtinë, shkurt 2002, fq. 72.

orën e lirisë dua të jemi bashkë, por në orën e betejës dua të jem vetëm”. U ndanë me lot në sy, ishte takimi i fundit.⁸

Markoja ishte komandant i ushtrisë së Greqisë perëndimore. Kur Qeveria i dërgoi diplomën e komandantit të Përgjithshëm, lindën smira e kapedanëve të tjerë. Por Markoja këtyre smirave i përgjigjej me fisnikëri dhe tolerancë duke u thënë- “Kush është i zoti, merr nesër diplomë në betejë” Markoja ishte njeri i dashur dhe fjalë pakët.

Më 9 gusht 1823, Marko Boçari u vra duke luftuar kundra ushtrisë së Mustafa Bushatit, shqiptar edhe ky, Pasha i Shkodrës.⁹

Vdekja Marko Boçarit u bë e njohur në të gjithë Europën, ai i kishte shkruajtur një letër Bajronit kur ky ishte rrugës për në Mesollogji. Poeti i madh anglez Lordi Bajron erdhi kur Marko Boçari kishte vdekur, dhe mbajti një fjalim mbi varrin e Markos i veshur me kostumin e njohur kombëtar shqiptar. Marko Boçari vdiq, por figura e tij u bë legjendë.

Më 1832, Mamuri (i njohur nga vrasja e Odisesë dhe pjesëmarrja e tij drejtpërdrejtë në të) dhe Papakosta në emër të qeveritarëve, bllokuan shtëpinë e Noti Gj. Boçarit në Amfisë dhe i vunë zjarrin. Të gjitha shkresat që për shekuj me radhë ruheshin në sëndukun arvanitas u dogjën.¹⁰

Kështu u zhdukë edhe një arkiv e madhe historike që vërtetonte se arvanitasit, suliotët ishin bijë të Shqipërisë. Qeveritarët grekë të asaj kohe kujtuan se do të zhduknin të vërtetën shqiptare të Boçarëve.

⁸ Po aty.

⁹ Po aty.

¹⁰ . . . , “ . . . ”, . . . , 1996, fq. 360.

Shumë historianë grekë na e deklarojnë Marko Boçarin dhe shumë heronj të tjerë arvanitas të Kryengritjes të 1821, si grekë dhe jo shqiptar, duke pasur parasysh që Markoja dhe të tjerë heronj të 1821, i përkisnin fesë ortodokse.

Është fatkeqësi për atë komb, kur historianët e atij kombi ngatërrojnë fenë me racën.

Që Marko Boçari ishte shqiptar dhe bir shqiptari, këtë na e deklaroi në vitin 1994, nipi i tij me të njëjtin emër Marko Boçari profesor në Universitetin e Kuinslendit në Australi. Kur reagonte ashpër ndaj deklaratës së një deputeti grek që mohonte ndihmërsën shqiptare në kryengritjen e 1821 dhe, origjinin shqiptar të Marko Boçari.

“Komentet e mia të me poshtme kanë të bëjnë me një letër të publikuar të një ministri grek, që ka deklaruar se nuk paska shqiptar në Greqi. Duket qartë se ministri ose nuk ka dijeni çfarë ndodh aktualisht në vendin e tij, ose ka vendosur të injorojë faktet. Është fakt se në Greqi ka më shumë se një milion shqiptar ortodoks. Prindërit e mi nuk kanë folur kurrë greqisht me mua, por vetëm shqip, se ata ishin krenarë për origjinin e tyre dhe fisin e tyre shqiptar”.¹¹

Populli shqiptar i ngriti këngë trimit nga Sulit i Çamërisë Marko Boçarit për trimëritë që tregoi kundra osmanëve turq.

*Moj kalaja në Janinë
mos qaj për vezir Alin
për pallën që drithmën mori
Rumelia vetë Stambolli.
Se doli Marko Boçari
trimi qe se qaste varri*

¹¹ Ilir Tirana, “EKSKLUZIVE”, Prishtinë, maj 2001, fq. 71.

*që sulej si vetëtimë
në Kapnesh, mbi osmallinjtë.
Jepi Marko kapedani
se nuk do të dali xhani
pa tu thye jatagani
shqiponjë e këtij vatani.
Çamëria kur dëgjoji
se u vra Marko fajkoi
ra në zi e ra në goj
kënga i mbeti në gojë.
Sheshi u mbush me dafina
kur në sup dymbëdhjet trima
mbanin Sulin, ngrinin malin
kapedan Marko Boçari.*

Janë të njohura vargjet shqiptare të shkruajtura në shekullin XIX:

*Kjo gjuha arbërishte
është gjuhë trimërie
e fliti Admiral Miauli
Boçari dhe gjithë Suli*

Ndërsa poeti ynë i madhi Naim Frashëri do të shkruante për shqiptarët heronj të revolucionit grek të 1821.

*E kush e bëri Morenë, (Greqinë)
Gjith shqiptarë qenë,
S'ishin shqiptar Marko Suli? (Marko Boçari)
Xhavela e Miauli?
Shqiptar, bir shqiptari,
Me armët e Shqipnis.
I u hodhën themeli Greqis.*

Kemi dhe vargjet:

*Ngrehu Marko trimëria
ngrehu të thërret Greqia
të vijë Marko Shqipëria.*

Në përfundim për emrin arvanitas duhet të sqaroj se gjatë leximit të teksteve dhe librave të ndryshme nga autorë të huaj dhe ata shqiptarë, kam vërejtur se shqiptarët e Greqisë i quajnë arvanitas ose arbërorë. Mendimi im është se këtu hasim në kundërshtim me fjalorët greqisht-shqip dhe shqip-greqisht. Kur botohen shkrime dhe librat në gjuhën shqipe, fjala arvanit dhe gjuha arvanitase përkthehen në gjuhën standarde shqipe, shqiptar dhe gjuha shqipe.

Ndoshta dikujt do t'i duket kjo e gabueshme! Por, mendimi im është i bazuar në fjalorët shkencorë Greqisht-Shqip, dhe Shqip-Greqisht të autorëve grekë. Kështu, çdokush që do të lexojë fjalorët në fjalë do të vërejë që fjala arvanitas përkthehet shqiptar. Në fjalorin më të madh Greqisht-Shqip që e ka bërë profesori i gjuhës greke në Universitetin e Tiranës Niko Gjini, fjalën *arvanitasi* e përkthen në gjuhën shqipe *shqiptar i vogël*, fjalën *arvanitika* e përkthen në shqip *gjuha shqipe*, dhe fjalën *arvaniti* e përkthen *shqiptar*.¹²

Ndërsa, autori tjetër grek Kostandinos Papafili, që ka bërë dy fjalorë Greqisht-Shqip dhe Shqip-Greqisht, fjalën *arvanitas* e përkthen në gjuhën shqipe

¹² Niko Gjini, "FJALOR GREQISHT-SHQIP", Janinë, 1993, fq. 14.

arbëresh.¹³ Kurse, në fjalorin Shqip-Greqisht, fjalën *shqiptar* e përkthen në greqisht *arvanitas*.¹⁴

Në gjuhën zyrtare të shtetit italian, fjalën arbëresh italianët nuk e njohin, por arbëreshët që kanë emigruar në Itali nga Greqia dhe Shqipëria rreth shekullit XV i quajnë me të drejtë albanesi, që do të thotë në gjuhën shqipe shqiptar.

Pra, mendoj se gabimi trashanik që është bërë deri më sot nga studiuesit dhe shkrimtarët e ndryshëm, që arvanitasit në gjuhën shqipe i thërrasim arvanitasit ose arbërorët duhet të ndreqet dhe të zëvendësohet me emrin që u takon shqiptarët dhe gjuha shqipe.

Edhe unë, në këtë ligjëratë, për qëllimin e mirë, po i emërtoj shqiptarët e Greqisë me emrin që njihen nga grekët arvanitas, por, siç u tha më lart bëhet fjalë për një degë të popullsisë së sotme shqiptare që jeton ndër shekuj në Greqi dhe flet në rrethin familjar gjuhën shqipe.

Arben Llalla
Historian

arbillalla@hotmail.com

Bibliografi:

Kalendari i vitit 1984, “ Y
1821”, Athinë, 1984, “Lidhja e Arvanitasve të Greqisë”.

¹³

, Fjalori “GREQISHT-SHQIP”, Athinë, fq. 65.

¹⁴

, Fjalori “SHQIP-GREQISHT”, Athinë, fq. 741.

Kalendari i vitit 1990, “ μ 200 (1790-1990)”,
 Athinë, 1990, “Lidhja e Arvanitasve të Greqisë”.
 Gazeta, “GAZETA SHQIPTARE“, 3 tetor 2001.
 Revista, “EKSKLUZIVE”, Prishtinë, maj 2001.
 Revista, “ESKLUZIVE”, Prishtinë, shkurt 2002.
 „ μ
 „, Athinë, 1993, fq. 40, përgatiti për
 botim,
 „
 „, 1996.
 Niko Gjini, “FJALOR GREQISHT-SHQIP”, Janinë, 1993
 „ Fjalori
 “GREQISHT-SHQIP”, Athinë.
 „, Fjalori “SHQIP-
 GREQISHT”, Athinë.

Luan Malltezi

Mid'hat Frashëri dhe çështja çame (1923-1926)

Mid'hat Frashëri është një nga figurat e shquara të historisë dhe kulturës sonë kombëtare i cili shërbeu në vitet 1923-1926 si Ministër Fuqiptotë i Shtetit Shqiptar në Athinë.

Në këtë detyrë të rëndësishme diplomatike Mid'hat Frashëri u përpoq me të gjithë forcat e tij të ndalonte shtetin grek të dëbonte në Turqi si minoritetet turk popullsinë muslimane shqiptare që jetonte në tokat e veta në Çamëri.

Ai zhvilloi atëhere një veprimtari të dëndur diplomatike me autoritetet e larta greke dhe vuri në dijeni për këtë qeverinë shqiptare nëpërmjet një korespondence të dëndur diplomatike.

Shqiptarët muslimane çamë u dëbuan me forcë në Turqi kundër dëshirës dhe vullnetit të tyre dhe në kundërshtim të plotë me të gjitha Konventat dhe Akte Ndërkombëtare të kohës për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të pakicave kombëtare.

Më poshtë do të përpiqemi të vëmë në dukje këtë veprimtari të tij duke çfytëzuar të dhënat nga libri:

Mid'hat Frashëri.
Ministër Fuqiptotë, Athinë.
Tiranë 2002.

Emërimi

Mid'hati u emërua si Ministër Fuqiptotë i Shqipërisë në Athinë nga kryeministri Pandeli Evangjeli më 9 janar 1923. Atëhere, ai ushtronte detyrën "Ministër Fuqiptotë i Shqipërisë" në SHBA. Në këtë detyrë ai ishte i emëruar më 25 gusht 1922.

Më 11 shkurt 1923, kryeministri shqiptar, i bënte të ditur Mid'hatit se dërgohej në Athinë si i "Dërguar me Mision Special për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike midis Shqipërisë dhe Greqisë".¹⁹

Caktimi i Mid'hat Frashërit në këtë detyrë lidhej me nevojën e normalizimit të marrëdhënieve me Greqinë të cilat kishin qenë mjaft delikate dhe problematike për periudhën pararendëse për shkak të politikës së shtetit grek për pushtimin dhe aneksimin e tokave shqiptare gjatë luftërave ballkanike.

¹⁹ Mid'hati e mirëpriti këtë emërim. Në letrën që i dërgonte kryeministrit shqiptar ai shkruante : "Kam nderin të ju them, se me gëzim të madh e pranoni Misionin që më ngarkoni për në Athinë, duke ju falenderuar për besimin që më rrëfeni, dhe duke ju siguruar, se vullneti s'më ka për të munguar në mbarim të kësaj detyre".

Emërimin e Mid'hat Frashëri në Athinë kryeministri Pandeli Evangjeli ia bëri të ditur ministrit të jashtëm grek Aleksanderis më 3 shkurt 1923.

Duke i shprehur dëshirën për vendosjen e marrëdhëneve diplomatike midis dy vendeve ai i shkruante ministrit të jashtëm grek edhe për të dërguarin e tij Mid'hat Frashëri:

“Cilësitë që e dallojnë këtë diplomat, zelli dhe dhe përkushtimi i tij më japin sigurinë se ai do të bëjë çmos për të rifituar nderimin dhe respektin e Shkëlqesisë Suaj”.

Koha tregoi se në vlerësimet kryeministrit shqiptar për Mid'hat Frashërin ishin të drejta. Gjatë qëndrimit në Athinë ministri ynë fitoi konsideratat më të larta të personaliteteve të shtetit greke, të medias dhe shtypit të kohës, për kulturën e tij të thellë, dhe dëshirën e e sinqertë për vendosjen e marrëdhënieve midis dy vendeve.

Në korrik të viti të 1923 gazeta greke “EMBROS”, duke botuar një intervistë të tij i bënte të ditur lexuesit të vet se : “Z.Frashëri përben një person diplomatik jo vetëm nga më të ditur, më punëtor dhe me kulturë por edhe një person diplomatik bashkëfjalimi me të cilin të bën përshtypje, t’inspirohet dhe të entuziazmon.”

Pritja në Athinë

Emërimi i Mid'hat Frashëri si diplomat i lartë i shtetit shqiptar në Athinë u prit mirë nga të gjithë shqiptarët, si personalitet dhe figurë e shquar në jetën politike dhe kulturore të vendit. Ai ishte autor i shumë shkrimeve, artikujve dhe broshurave të botuar në revista dhe organe të ndryshme të shtypit vendas dhe të huaj që trajtonin me kompetencë një varg problemesh themelore të historisë dhe kulturës së popullit shqiptar, si një nga popujt më të vjetër të gadishullit Ballkanik.

Emërimi i Mid'hat Frashërit Ministër Fuqiplotë i Shqipërisë në Athinë u prit me entuziazëm të veçantë sidomos nga të rinjtë shqiptarë. Me rastin e emërimit të tij ai mori edhe një telegram urimi të nënshkruar nga Halim Xhelo dhe të rinj të tjerë shqiptarë. Në të shkruhej :

“Neve të Rinjtë ose Brezi i Ri, jemi gëzuar për emërimin Tuaj si ambasador i shtetit shqipëtar, i atij kombi, që pak vjete më parë dëshërojshim t’i shihnim Flamurin të valonte mbi ndonjë gërxhë, e sot e shohëm të valojë... nëpër kryeqytete të kombeve, që na kanë luftu sistematikisht e tërbimërisht.

Ju, më tepër se ambasador, do të jini burimi i përhapjes së ndjenjave kombëtare ndër nxënësit dhe studentët shqipëtarë, që ndodhen aty, të cilët të helmu me ëndërrat hellene janë gabuar, e tash juve do t’i përmbledhni në gjirin tuaj e do t’i ndritoni, tue iu xhveshun ndjenjat e hueja”.

Mid'hat Frashëri arriti në Pire me 24 shkurt në orën 2 pas ditë.

Ai u prit nga Dhimitër Popa, sekretari i Misionit shqiptar në Athinë dhe një mik nga Durrësi Harilla Bakalli. Në pritje të tij kishte dalë për ti

uruar mirseardhjen në Greqi edhe një nëpunës i ministrisë së Punëve të Jashtme të Greke.

Duke njoftuar Tiranën Zyrtare për mbritjen e tij në Greqi Mid'hat Frashëri shkruante:

“Në Athinë pata shumë vizita të shqiptarve. Nji tok prej tyre më kërkoi që tani dhe pashaporta. Kam marrë pastaj telegrafe urimi, nentë gjer më tani nga Vodena, Karaferia, Allasona, do personale, do në emër të kolonive shqiptare”.

Shtypi shqiptar

Emrimin e Mid'hat Frasherit në detyrën e Ministrit Fuqiptotë të Shtetit Shqiptar në Greqi e pasqyroj edhe shtypi shqiptar .

Gazeta “DIELLI”, njoftonte me 3 mars 1923 dorëzimin e kredencialeve të tij Ministrit të Jashtëm grek Aleksandris.

Më 15 mars gazeta “POLITIKA” e Vlorës botoi një shkrimin me titull “Ardhja e Shkëlqesisë së tij Mid'hat Frashëri në Athinë” shkruar nga korrespondenti Harillo Bakalli. Sipas Bakallit, Mid'hat Frashëri kishte lajmëruar me një telegram nga Italia z.Dhimitër Popa se do të vinte në Pire më datë 24 janar. Bakalli bën të ditur se Mid'hat Frashëri erdhi me vaporin “CELIO”. Këtu shkuan me barkë për ta pritur z.Popa, së bashku me H.Bakallin. Më pas aty erdhi dr.Naska nga Frashëri. Më pas aty erdhi me një barkë tjetër edhe një nëpunës i posacëm bashkë me një roje të ministrisë së punëve të jashtme greke për ti paraqitur mirëseardhjen në emër të ministrit të punëve të jashtme të Greqisë.

Pas shkëmbimit të fjalimëve të rastit, ata zbarkuan dhe shkuan me automobil për të vendosur në një dhomë të Hotel “GRAND BRETAGNE” të prenotuar më parë nga z.Popa.

Me mbritjen e e tij në Athinë filluan edhe vizitat e shqiptarëve.

“Pas një ore- shkruan H.Bakalli, filluan edhe vizitat e shqiptarëve të këtueshëm”. I pari që takoi Mid'hat Frashërin, shkruan Bakalli, ishte “Spiro Ikonomi nga Narta e Vlorës, Drejtori Politik i Athinës si dhe reporterët e gazetave”.

Këto vizita vijuan edhe më pas. Shtypi shkruan se “Të djelën vazhduan vizitat e shqiptarëve të dëndura, në fytyrën e të cilëve u dallonte gëzimi dhe kënaqësia e saj ditë të shënuar dhe historike për kombin tonë.Të nesërmen gazetat greke njoftuan lajmin e zyrës së shtypit grek për mbritjen në Greqi të z. Mid'hat Frashëri si ministër i shtetit shqiptar”.

Më 21 prill gazeta “ShQIPTARI I AMERIKES” botoi një artikull të korespondentit të saj me titull “Përfaqësonjësi i Shqipërisë në Athinë. Pritje nga ana e Qeverisë Greke dhe nga ana e qytetarëve shqiptarë që jetojnë në Greqi”.

Ministri Fuqplotë i Shqipërisë,-thuhet në artikull- u prit shumë mirë nga Qeveria Greke dhe shtypi i Athinës. U komentua mirëardhja e përfaqësonjësit të Shqipërisë në Greqi për rinisjen e marrëdhënieve miqësore midis dy shtetëve fqinjë dhe të afërt. Shkëlqesia e tij porsa ardhni nisi nga puna me një zell të mjaftë..Sa për shqiptarët që jetojnë dhe punojnë në Greqi, ardhjen e Ministrit Shqiptar e dëgjuan me gëzim të madh se shpëtuan nga grabitjet që u bënin cakejtë, duke çpikur lloj lloj labra, për tu dhënë çertifikata, për tu nxjerrë pasaporta dhe që tu bënin lehtësi të cilat ja u njeh ligji i shtetit në të cilët jetojnë. Gjithë shqiptarët e Athinës dhe të Pireut vizituan Ministrin Shqiptar. Shumë koloni shqiptarësh që jetojnë në qytete të ndryshme të Greqisë i uruan mirëardhjen”.

Sipas gazetës “POLITIKA ” data “3 mars 1923 qe e para ditë që valoi për të parën herë këtu në Athinë flamuri ynë kombëtar në automobilin e shkëlqesisë së tij M.Frashëri me rastin e vizitave që bëri te tërë Ministrat e Greqisë dhe tek Ambasadat e huaja”.

Shtypi grek :

Ardhjen e Ministrit shqiptar e përshëndeti ngrohtë edhe shtypi vendas.

Gazeta “NEA IMERA” shprehte besimin se Përfaqësonjësi i Shqipërisë do të gjente tek populli grek ndjenja të sinqerta si dy popuj që kishin vuajtur së bashku nën robërinë turke. Gazeta shprehte bindjen se mosmarrëveshjet që kishin lindur më parë midis dy vendeve kishin ndodhur për shkak të ndërhyrjeve të huaja.

Gazeta “EMBROS ” po ashtu shprehte me një ton miqësor ndjenja dashurie midis dy popujve. Lidhjet ndërmjet Greqisë dhe Shqipërisë, shkruante kjo gazete, “janë lidhje rrace dhe gjaku që nga vjetët më të moçme. Le të shpresojmë se këto lidhje do ti forcojë më tepër Përfaqësonjësi i Ri i Shqipërisë”.

Audienca me Mbretin eGreqisë.

Ministri Fuqplotë i Shqipërisë u prit nga autoritetet e larta të shtetit grek, dhe trupi diplomatik i akredituar në Greqi Ai pati një bisedë të rëndësishme me Ministrin e Jashtëm grek Aleksandris.

Më 19 mars 1923 Mid’hat Frashëri pati edhe një audiencë me mbretin e Greqisë, Gjergji II. Duke njoftuar ministrinë e jashtme për këtë takim Mid’hat Frashëri shkruante :

Pas kërkesës që i kisha bërë Ministrit të P. të Jashtëm, Mbreti Georges II më priti në audiencë private, në buro të Tij, të hënën, ora 12. Me mbajti ca ma tepër se 1/2 ore.

Mbreti kishte një uniformë oficer marine. Unë qeshë me xhakët, se kështu kishin bërë gjithë Përfaqësonjësit e tjerë, që kishin kërkuar audiencë private.

Kuvendimi rodhi mbi shumë subjekte: Gjendja e brëndshme e Shqipërisë, Paqa me Tyrqinë, bektashijtë...

Dy herë më përsëriti se donte të mësojë shqip, me qenë se ka lindur në Tatoë, ku fshatrat rreth përqark flasin arbërisht, kështu që edhe veten e tij e shikon gjysmë shqiptari.

Prapë në dy raste përsëriti se dëshëronte shumë që marrëdhëniet midis të dy shteteve të jenë miqësore.

I thashë se gjithë Ministrat e Shqipërisë e dëshirojnë këta gjë, dhe se shpresonj që të gjej tërë atë vullnet edhe në Ministrat e Madhërisë së Tij.

Shtoj se, padyshim do të bëhet e lehtë marrëdhënia, po ka influenza të huaja që ndalojnë punë.

Mid'hati njoftonte se gjithashtu se "Mbreti është 33 vjeç, i ngjan shumë t'et pas fotografisë që kam parë; duket me shëndet të mirë, buzaqesh dhe ka pamjen "brave garçon". Bën shumë pyetje, (është) pak si i rrëmbyer në të pyeturë, po i pa duruar në të dëgjuarë përgjegjet, dhe pak i interesuar.

Fuqinë e Qeverisë ..e ka Kryengritja (Plastira me shokë), Mbreti po përpiket (me thonë) qi të rrefejë veten në populli, shëtit në qytet dhe në rrethinat, që të duket.

Georges II kur qe Diadok, më 1913 bëri udhëtimin Leskovik, Gjirokastër, Korçë, udhëtim në të cilin e shoqëronte René Puaux, autori i "La Malheureuse Epire".

Iluzionet e para

Në relacionet e tij dërguar ministrit të jashtëm shqiptar konstatohet se Mid'hat Frashëri ishte i bindur se misioni i tij në Greqi do të ishte ishte i vështirë.

Këtë mendim ai ia shprehu edhe ministrit të jashtëm grek në pritjen e rezervuar prej tij : "Preferova te vinj këtu në Athinë, më mirë se sa të vetë në Ëashington (si ministër fuqiptotë-red) se këtu ka shumë sende për të bërë sa do mbase puna është më e rëndë".

Mid'hat Frashëri shkoi në Athinë me dëshirën dhe vullnetin e plotë për vendosjen e marrëdhënive midis dy vendeve, dhe forcimin e lidhjeve dhe bashkepunimit midis tyre. Kjo, mendonte ai, ishte e vetmja rrugë me interes reciprok në dobi të zhvillimit dhe prosperitetit për të dy vendet. Këtë bindje Mid'hat Frashëri do ta ruante edhe më pas kur marrëdhëniet me Greqinë u përkeqësuan për shkak të palës greke .

Ky predispozicion pozitiv mbështetej në faktin se shteti shqiptar i kishte plotësuar dhe garantuar me ligj dhe konform aktëve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, të gjithë liritë dhe të drejtat e minoriteti grek në Shqipëri. Këtë fakt të rëndësishëm Ministri ynë ua kujtoi në mënyrë të vazhdueshme, gjatë kohës së shërbimit të tij në Athinë, të gjithë autoritetëve të larta greke. Këtë fakt të rëndësishëm ai e përdori edhe si argumentin më me peshë në Lidhjen e Kombeve në Gjeneve kur marrëdhënie me Greqinë filluan të bëhen mjaft problematike për shtetin shqiptar për shkak të shkeljes së konventave ndërkombëtarë nga pala greke për shqiptarët e vendosur në tokat e veta në Greqi.

Këtë dëshirë të sinqertë për zhvillimin e marrëdhënieve midis dy shtetëve Mid'hat Frashëri e shpalosi që në takimin e tij të parë me ministrin e jashtëm grek, Aleksandris.

“Idetë e luftës tani u zhdukën- i tha atij Mid'hati - dhe tani është koha për të punuar për prosperitetin material të Ballkanit”.

Mid'hati besoi në fillim se një predispozitë të tillë pozitive gjeti edhe tek pala greke dhe këto konsideratë ai i përcolli edhe qeverisë shqiptare :

Në takimin e parë me ministrin e jashtëm grek Aleksandris, më 27 shkurt 1923, ky i fundit i kishte deklaruar vullnetin e palës greke për vendosjen edhe zhvillimin e marrëdhënive midis dy vendeve. Sipas ministrit të jashtëm grek “Shqipëria nuk kishte ide imperialiste dhe se eksiztenca e Shqipërisë do të shërbente për të përmirësuar marrëdhëniet midis Greqisë dhe Italisë”

Në këtë takim, ministri i jashtëm grek hidhte poshtë edhe mendimin e hedhur nga italianët se gjoja pala greke kërkonte të maerte Shqipërinë. Sipas ministrit grek, kjo nuk mund të ndodhte sepse “shqiptarët nuk lënë të prekë njeri indipendencën e tyre”. Ministri grek thonte se këtë ai ia kishte deklaruar edhe “trashëgimitarit të Italisë”. Ministri i kishte thënë këtij se shqiptarët beheshin “ djaj po ti prekej indipendence”.

Dëshirën për vendosjen e marrëdhënie miqësore midis dy vendeve kishin shprehur në takime me Mid'hat Frashëri të gjithë autoritetet e larta të greke përfshirë këtu edhe Mbretin e Greqisë.

Një dëshirë të tillë i kishte deklaruar qeverisë shqiptare edhe përfaqësuesi grek në Tiranë, z.Panuaria.

Ai i kishte bërë të ditur palës shqiptare se Greqia dëshëronte të të rronte gjithmonë në miqësi me Shqipërinë.

Një dëshirë të tillë kishte edhe qeveria shqiptare.

Ministri i Jashtëm shqiptar në pritjen e rezervuar ministrit grek Panuria, i bëri atij të ditur politikën konstante të shtetit shqiptar në mbrojtje të të drejtave të minoritetit grek në Shqipëri konform të gjithë konventave dhe aktëve ndërkombëtare. Ai i bëri të ditur ministrit grek praninë e shkollave në gjuhë greke për minoritetin grek në Shqipëri dhe shpenzimet e caktuara në buxhetin e shtetit në këtë drejtim.

Duke e vënë në dijeni Mid'hat Frashërin lidhur me takimin që kishte pasur me ministrin grek në Shqipëri z.Panuria, ministri i jashtëm shqiptar i shkruante këtij se :

“(Ministri grek-red) më pyeti në një mënyrë partikulare se Qeverija Shqiptare a u ka dhënë të drejtat minoriteteve grekë. I u pergjigja se Shqipëria është i vetmi vend ku janë siguruar plotësisht të drejtat e pakicave, dhe për të konfirmuar këtë arsye i dhashë një listë e cila përmbante emrat e 26 katundeve grekofone ku ndodhen shkolla në gjuhën greqisht. Sikundër që e dini, kjo Ministri gjëndjen e minoritetëve në Shqipëri ja kish bërë të njohur dhe Shoqërisë së Kombëve që me kohë, duke dhënë gjithë shpjegimet e duhura. Për shembull, dua të rrëfenj se për mbajtjen e shkollave për minoritetet, Ministria e Arsimit ka ndarë një shumë prej 100.000 franga ari (një qint mijë). Me këtë rast i kujtova se dhe Greqia duhet t`u japë të drejtat minoriteteve shqiptarë në Greqi”.

Nisur nga binda se një dëshirë të tillë të sinqertë për vendosjen e marrëdhënieve midis dy vëndëve kishte edhe pala greke, ministri shqiptarë në Athinë u udhëzua nga qeveria shqiptare të merrej me punët e zakonëshme konsullore, siç ishte dhënia e vizave, çertifikatave, pasaportave etj. Në këto udhëzime të para, të bëra më 22 mars 1924, ministrit të jashtëm shqiptar në Athinë i tërhiqej vëmendja të zgjidhte edhe çështje që kërkonin zgjidhje si “probleme të mbetura nga ngjarjet e kaluara” :

“Sikundër që e dini, i shkruante ministri i jashtëm shqiptar, në Greqi ndodhen shumë shqiptarë origjinarë nga viset e Shqipërisë së 1913-s. Shumica e këtyrëve kanë lënë vendet e tyre nga shkaku i ngjarjeve të 1914-s, por këta janë nështetas shqiptarë. Pra është e domosdoshme që këtyre t`u jepet “Certificat de Nationalite” që kësisoj të drejtat e tyre të mos merren ndër këmbë. Kështu dhe Tyrqija ju njofti pa as një kundërshtim nënshtetësinë Shqiptare gjithë Shqiptarëve që banojnë në Tyrqi dhe janë nga viset e Shqipërisë të 1913-s.”

Deziluzonet e ministrit fuqiplotë

Ky fillim i lumtur në marrëdhëniet midis dy vendeve për fat të keq nuk vazhdoi gjatë dhe kjo për faj të palës greke.

Përplasaja e parë serioze e ministrit fuqiplotë të Shqipërisë në Athinë me autoritetet greke lindi për shkak të zbatimit nga pala grekë të ligjit mbi shpronësimin e pronës së madhe tokësore edhe për popullsinë shqiptarë të vendosur në tokat e veta në Greqi .

Mid'hat Frashëri u përpoq të mos lejonte palën greke të zbatonte këtë ligj mbi popullsinë shqiptare si pakicë kombëtare. Sipas ligjit asnjë shtetas nuk mund të kishte pronë tokësore private mbi 300 streme. Mbi

këtë masë toka shpronësohej. Nga zbatimi i këtij ligji, shqiptarët që kishin prona të mëdha humbnin 350 mijë napolonë flori. Këtë ligj qeveria greke kishte kohë që e kishte vënë në zbatim. Dukë bërë fjalë për këtë problem, Mid'hati e njoftonte Tiranën zyrtare se shqiptarët e Maqedonisë (Selanik, Karaferia Allasonë etj) kishin mbi 10 vjet që dëmtoheshin me rekuizime dhe konfiskime. Dëmi që kishin pësuar shqiptarët e lartpëmendur mund të llogaritej e pakta 20.000.000 dhrami ndërsa dëmi që kishin pësuar 20 mijë shqiptarë të Kosturit dhe të Follorinës, mund të llogaritej 20.000.000 dhrami.

Këtë çështje jetikë për fatin e shqiptarëve në Greqi, Mid'hat Frashëri e ngriti edhe në Lidhjen e Kombëve më 24 shtator 1924.

Sipas tij, zbatimi i këtij ligji do t'i detyronte shqiptarët myslimanë që të largoheshin nga Greqia për shkaqe ekonomike, pra nga pamundësia për të jetuar pa tokë, mbi të cilën mbështesnin ekonominë e tyre.

Kërkesën për moszbatimin e këtij ligji mbi shqiptarët, ministri ynë e mbështeste, në atë, që ky ligj, binte në kundërshtim me zotimet që Greqia kishte marrë më 1913 në lidhje me pronat e myslimanëve. Ky zotim ishte ripohuar në deklaratën lidhur me pasuritë e muslimanëve në Greqi "të nënshkuar në Lozanë nga zotërinjtë E.K.Venizellos dhe D.Caclamanos më 24 korrik 1923"

Ministri ynë njoftonte Tiranën se si pasojë e këtij ligji gjendja e shqiptarëve myslimanë në Greqi ishte keqësuar shumë sepse :

1-"Që prej shtatë vjetësh shqiptarëve myslimanë, që përbënin pjesën më të madhe të pronarëve, u ishte hequr e drejta të shesin dhe të japin me qira pronat e tyre, ç'ka u ka shkaktuar atyre tashmë dëme të mëdha"

2- Sepse pronarët myslimanë kishin pasur kufizime mbi të drejtën e tyre të pronësisë, të korrat e tyre qysh prej disa vjetësh kishin qënë të konfiskuara nga qeveria greke ose kishin qënë të detyruar, po nga këto autoritete, të jepnin me qira pronat e tyre me çmime qesharake".

Mid'hat Frashëri i sygjerronte Këshillit të Lartë të Lidhjes së Kombëve që kjo çështje të zgjidhej si më poshtë:

"Pasuritë (tokat-red) që u përkisnin shqiptarëve, të vlerësoheshin me vlerën e tyre faktike nga një autoritet gjyqësor i lirë dhe shuma e vlerësimit t'i paguhej atyre tërësisht në të holla"

Dëbimi i shqiptarëve muslimanë.

Krahas këtij problemi, në marrëdhëniet e Shqipërisë me Greqinë lindi edhe një çështje tjetër tjetër e mprehtë që kishte të bënte me dëbimin me dhunë të popullsisë nga tokat e veta në Greqi. Ky problem lindi pas nënshkrimit të marrëveshjes në Lozanë të Zvicrës për shkëmbimin e pakicave kombëtare midis Greqisë dhe Turqisë. Pala greke

e përdori këtë marrëveshje për të dëbuar nga tokat e veta në Greqi popullinë myslimane shqiptare, duke e paraqitur atë si popullsi turke për shkak të besimit osman.

Njoftimin e parë për pikënisjen e kësaj politike Mid'hat Frashëri e mori rastësisht nga ministri i jashtëm italian Montaga. Ky i bëri të ditur se delegati grek kishte deklaruar në Lozanë se Qeveria greke nuk do të konsideronte muslimanët shqiptarë të Greqisë si turq dhe nuk do të përfshinte ato në shkëmbim me popullsin greke të vendosur prej kohësh në Turqi. Zhvillimet politike treguan se në fakt se kjo deklaratë e delegatit grek në Lidhjen e Kombëve në Lozanë ishte thjeshtë një alibi, sepse gjerat filluan të ecnin në drejtim të kundërt.

Kështu Mid'hat Frashëri e informoi Tiranën zyrtare se Prefekti i Janinës kishte botuar në qarkore se shqiptarët do të shkëmbeheshin si pakicë kombëtare turke me grekët. Kjo deklaratë- sipas Frashërit - kishte terrorizuar popullsinë shqiptare në Greqi. Po kështu, edhe deputeti grek Bakëllbashi, njoftonte Mid'hati, kishte deklaruar në gazetë se do të shkonte në Epir për të sistemuar aty refugjatët grekë, që do të ktheheshin nga Turqia në kuadër të shkëmbimit të popullsive respektive greko-turke.

Akte të tilla të këtij deputeti tregonin për një qëndrim të përcaktuar të qeverisë greke për dëbimin me dhunë të popullsisë myslimane shqiptarë nga tokat e veta në Greqi, me qëllim grabitjen e pronave dhe pasurive të tyre, dhe vendosjen në tokat, dhe shtëpitë e tyre të refugjatëve grekë të rikthyer në Greqi si pasojë e zbatimit të marrëveshjes së Lozanës.

Këtë qëndrim të mbrapshtë Mid'hat Frashëri e konstatoi edhe në takimet e drejtpërdrejta me autoritet greke përfshirë këtu edhe kryeministrin grek Venizellos.

Më 25 janar 1924 duke i relatuar ministrit të jashtë shqiptar lidhur me takimin që kishte pasur me kryeministrin grek, Mid'hati shkruante:

“Me gjithë fjalët e ëmbla të kësaj komunikate, me gjithë buzëqeshjet dhe sigurimet e tij, unë dolla nga kjo pjekje me konviktimin (bindjen-red) se Venizellua ka vendosur që të mohojë angazhimet që ka marrë, dhe se do të kërkojë me çdo mënyrë që të shpëtojë prej shqiptarëve, duke i përzënë dhe duke u grabitur pasurinë”

Një qëndrim të tillë të qeverisë greke e konstatuan me kohë edhe përfaqësuesit e Trupit Diplomatik të akredituar në Athinë.

“Grekët e dinë mirë- i kishte thënë ministri francez në Athinë Mid'hat Frashërit, se cilët janë turqë dhe cilët janë shqiptarë, po duan që të grabisin pasurinë e shqiptarëve prandaj duan dhe ti përzënë. Venizello- kishte shtuar ai- nuk do të jetë më pak grek se grekët e tjerë”.

Reagimi i popullsisë

Qëndrimi i autoritetëve greke kishin ngjallur një shqetësim të madhe tek popullsia myslimane shqiptare. Një përfaqësi nga popullsia myslimane çame kishte takuar në korrik të vitit 1923 disa personalitete të larta greke, përfshirë këtu ministrin e jashtëm dhe kryeministrin grek, por nuk kishin marrë asnjë fjalë të prerë prej tyre se çfarë do të bëhej me shqiptarët që kërcënoheshin të dëboheshin në Turqi.

Një peticion i nënshkruar nga 130 vetë nga Filati u dërgua në korrik në Athinë në të cilin deklararonin se nuk donin të iknin nga vendi si turq. Po kështu 173 vetë në Ajdonati kishin shkuar në Athinë për të takuar komisionin turk. Në mars 1924 Mid'hati njoftonte Tiranën Zyrtare se deri në këtë kohë kishin ardhur në Athinë gjashtë përfaqësi nga Çamëria për tu interesuar për problemin e tyre. Me dhjetra telegrame të tjera ishin dërguar në emër të popullit të Filatit, Margëllicit, Ajdonatit. Një përfaqësi kishte ardhur nga Selaniku në Athinë ku kishte ndënjur katër muaj me radhë për t'u interesuar për fatin e tyre "në emër të shqiptarëve të Maqedonisë".

Në korrik të vitit 1923 Mid'hat Frashëri njoftonte Tiranë së autoritetet greke kishin konfiskuar pronat e shqiptarëve të tërë fshatrave, duke konsideruar popullsinë e tyre si popullsi turke. Njoftime të kësaj natyre me kohë bëhen të shpeshta.

Kleri musliman

Për të kandisur shqiptarët muslimanë të iknin në Turqi, autoritetet greke kishin blerë dhe bërë për vete klerin mysliman, hoxhallarët dhe myftinj të shqiptarë. Këta bënë propagandë në popull për të mërguar në Turqi.

Më 31 tetor 1923, 22 përfaqësues të krahinave të ndryshme të Çamërisë (Margëllicit, Filatit, Paramithisë, Gumenicës) i kërkonin qeverisë shqiptare të ndërhynte pranë qeverisë turke për të mos pranuar në Turqi shqiptarë të mashtruar nga propaganda e këtyre klerikëve të shitur.

"Kur qeveria greke (nën presionin e Lidhjes së Kombëve-red) urdhëroi të deklarohet zyrtarisht racën tonë- thonin përfaqësuesit në fjalë- çamët vrapuan të deklarohet racën e tyre të vërtetë (shqiptarë-red), por si u pa ky sulm, doli Myftiu i Filatit, Mehmet Zeqiraj dhe ish Myftiu i Gumenicës, Halil Hilmiu, duke e gënjyer popullin që të mos rrëfëjnë se janë shqiptarë".

Aty u shtruan disa çështje :

1-Pasuninë që po e grabit dhe konfiskon qeveria në emër të shpronësimit

2-Myslimanët (çamë etj) (autoritetet greke-red) po i përzijnë me turqit dhe i bën që të vdesin. Gjëndja e myslimanëve (qofshin këta-red) nënshtetas shqiptarë ose grekë, po bëhet tragjike me instalimin me dhunë të refugjatëve, me rekuizime drithit, me ndalimin e shitjes dhe të blerjes”.

Në janar 1924 Mid’hati njoftonte se në Arpicë autoritetet greke kishin vendosur më tepër se 100 familje greke të Anadollit; shqiptarët, shkruante Mid’hati-janë mbledhur dy tre familje në një shtëpi kurse shumë refugjatë grekë (janën mbeldhur-red) vetëm dy njëz në një shtëpi. Muhaxhirët (dmth grekët e kthyer nga Turqia) por mbledhin për hesap të tyre vallanidhin, fiqtë, ullinjë, zarzavatet, presin drurët, dhe pemët, kështu që zotërit e shtëpive (dmth shqiptarët-red) janë pa asnjë prodhim. Disa arpiciotë kanë dashur të ndalojnë garbitjen e refugjatëve, por qeveria arrestoi pesë vetë, të cilët i çoi në Margëlliç, në Pargë dhe Prevezë, nga burgu në burg 15 ditë”.

Hajdutët dhe kriminelët

Me kohë kjo dhunë u bë edhe më brutale nga autoritetet greke, sepse këta filluan të përdornin kundër shqiptarëve ushtrinë dhe xhandarmërinë greke. Për të terrorizuar popullsinë dhe për të detyruar atë të largohej në Turqi, autoritetet greke aktivizuan edhe kriminelë e banditë të njohur.

“Hajduti Cile Mastora me shokun e tij Kiamo- njoftonte Tiranën Mid’hati në maj të viti 1924 - po terrorizojnë sheshit katundet e Paramithisë me qëllim që të shtërngojnë shqiptarët që të ikin dhe këtë e bëjnë para syve të autoritetëve greke”.

Për të terrorizuar popullsië autoritetet arrestonin, burgosnin dhe keqtrajtonin, burrat më në zë të çamëve që kundërshtonin dëbimin në Turqi.

Në prill të vitit 1924 Mid’hati njoftonte se ishin arrestuar Musa Demi, Haki Musa, Mehmet Zekeri, etj. Këta ishin arrestuar më 27 mars dhe ishin dërguar në burgun e Janinës. “Autoritetet greke- shkruante Mid’hati duan të terrorizojnë dhe të eliminojnë ata që përpiqen të mbeten në Greqi dhe të mos dëbohen në Anadoll”.

Në mars 1924, duke relatuar për situatën e shqiptarëve në Greqi Mid’hati shkruante :

“Rrojtja e shqiptarëve këtu në Greqi është bërë e poamundur. Si mund të jetojë njeriu kur shtëpinë i’a kanë marrë, kur drithin, bagëtinë, kafshët, ia kanë rekuizuar, kur të huajt i janë bërë zotër në arat dhe kopshtet e tij ? ”

Reagimi i popullsisë

Përballë rrezikut të dëbimit nga tokat e veta në Greqi, popullsia myslimane shqiptare reagoi duke dërguar peticione pranë qeverisë greke në të cilat shprehte përkatësinë e saj shqiptare dhe dëshirën për të qendruar në tokat dhe pronat e veta.

Në këto peticione ajo shprehte dhunën dhe terrorin që ushtrohej nga autoritetet greke, dhe denonconte arrestimet dhe burgimet që bëheshin mbi përfaqësuesit më në zë të shqiptarëve. Në përpjekje për të gjetur mbështetje dhe mbrojtje në kërkesat e tyre të drejta, popullsia shqiptare kërkoi edhe mbrojtjen e shtetit amë. Për këtë qëllim ajo vendoi lidhje dhe kontakte të ngushta me Mid'hat Frashërin, dhe e informoi për gjithshka që po ndodhte në komunitetin e tyre. Shqiptarët e sinjalizonin Mid'hatin për dhunën e ushtruar nga autoritetet greke dhe njerzit e tyre. Mbi bazën e faktëve të shumta, ministri shqiptar në Athinë kërkoi dhe realizoi takime të shumta të drejpërdrejta me autoritetet më të larta greke. Në këto takime ai kërkoi me forcë të hiqej dorë nga kjo politikë dhe të respektoheshin aktet dhe konventat ndërkombëtare për popullsinë shqiptare në Greqi sikundër i respektonte këto edhe shteti shqiptar për pakicën greke në Shqipëri.

Mid'hat Frashëri bën të ditur se në këto takime ai kishte dorëzuar 200 nota ministrisë së punëve të jashtme greke. Këto nota Mi'hati i'a percillte edhe Tiranës Zyrtare. Mbi bazën e këtyre notave dhe relacioneve, Ministria e Jashtme Shqiptare kishte, siç thonte vetë Mid'hat Frashëri "një dosar të plotë të çështjes çamë, dhe të politikës së përdorur nga autoritetet greke" për dëbimin me dhunë të shqiptarëve nga tokët e tyre, për grabitjen e pronave dhe të pasurive të tyre, për vendosjen në shtëptë e tyre të refugjatëve grekë. Në këto dosje përfshiheshin të gjitha kopjet e lutjeve dhe të ankesave që kishte bërë pranë qeverisë greke popullisa myslimane e vendosur në tokat e veta në Greqi..

Krahas takimeve të shumta me palën greke, Mid'hat Frashëri u përpoq të sensibilizonte edhe Lidhjen e Kombeve për çfarë po ndodhte me popullsinë shqiptare myslimane në Greqi. Për këtë ai shkoi edhe vetë në Gjenevë si kryetar i delegacionit shqiptar ku mbajti një fjalim të shkëlqyer në mbrojtje të popullsisë shqiptare të vendosur në tokat e veta në Greqi. Megjithatë duhet thënë se Mid'hati pa atje edhe pafuqinë Lidhjes së Kombeve për t'iu imponuar qeverisë grekë. Kjo vinte për shkak të konfliktëve dhe interesave të ndryshme që ekzistonin midis shtetëve anëtare të Lidhjes së Kombeve.

Të denoncohet grekët në gjyqin e Hagës

Me fillimin e detyrës së tij në Athinë Mid'hat Frashëri kishte konstatuar një realitet të hidhur të shkeljes brutale të të drejtave të popullsisë shqiptare muslimane, dhe të grabitjes së pronave dhe pasurivë të tyre. Ai i kishte sygjëruar Tiranës Zyrtare për të apeluar në gjyqin e Hagës grekët dhe serbët për krimet e tyre ndaj popullsisë shqiptare. Ai sygjëronte se “duhej bërë memorandum në Konferencën e Ambasadorëve ose në Gjykatën e Hagës për të kërkuar zhdëmtim prej Greqisë për 300 katundet e shkretuara (nga ana e saj-red) më 1914. Një memorandum identik duhej paraqitur edhe kundër Serbisë për afro 200 fshatra të djegura dhe të rrenuara prej tyre më 1920 dhe 1921”

Hedhja e Serbisë dhe e Greqisë në tribunalin e Hagës duhej bërë-sipas Frashërit- për mbrojtjen e interesave tona shtetërore dhe private. Ministri ynë mendonte se duhej bërë edhe një fushtatë shtypi “për të ndritur opinionin e vetë shqiptarëve dhe të kombëve të qytetëruara”.

Këtë sygjërim ministri ynë i përsërit Tiranës Zyrtare edhe më 23 mars 1925. Sipas tij, kjo duhej bërë për “ të pasur në dorë një armë për të luftuar pretendimet e reja të fqinjëve tanë”.

Frashëri u rikthye në sygjërimin e tij të hershëm sepse, siç thonte ai, grekët dhe serbet-çdo ditë po i shtonin pretendimet e tyre dhe kishin tendenca ta shihnin Shqipërinë si një provincë jugosllave ose greke, e cila sot ose nesër ishte e destinuar të bashkohej “me trupin e madh helenik e serb”

Instalimi në Shqipëri

Ministri ynë ndoqi në vijimësi edhe fatin tragjik të shqiptarëve të dëbuar në Turqi. Sipas informacioneve të tij të shumta, popullsia e ikur atje, ishte katandisur në një gjëndje tepër të vështirë. Mid'hati njoftonte se një pjesë e mirë e saj po vdiste nga urija dhe nga kushtet e rënda të jetesës. Duke përjetuar thellë mjerimin dhe fatkeqësinë e tyre, Mid'hati i sygjëroi autoritetëve shqiptare sistemimin e tyre në Shqipëri. Propozimin e parë ai e bëri në janar të vitit 1924.

“Nuk di në gënjehem-i shkrunte ai minsitrit të jashtëm shqiptar-po më duket se në këtë marazmë ekonomike që ka rënë sot Shqipëria, sot që 2/3 e tokës rrinë pa punuar prej shkakat që mungon krahu i njeriut; më duket se edhe një njeri i vetëm të vejë në Shqipëri nga Çamëria, do të kemi një fitim të madh”.

Sipas Mid'hatit vendosja e tyre në Shqipëri duhej të bëhej e organizuar dhe e studjuar me angazhimin e strukturave të posaçme shtetërore që duhej të ngriheshin për këtë qëllim.

“Do të qe mirë-shkruante ai- sikur të elaborohesh një projekt,..për ata shqiptarë të Greqisë që do të gjenden të shtrënguar të imigrojnë në Shqipëri

1-Ku dhe si do të vendosen ?

2-Ç’ndihmë mundet që t’u japë qeveria ?

3- A do të vendosen dot edhe në ca prona private si bujq ?

4-Cilat kategori mund të dërgohen, në cilat vende ?

Sygjerime të tilla ai i ngriti në disa relacione të veta që nisi nga Athina. Problemin e sistemimit në Shqipëri të shqiptarëve të dëbuar nga Greqia Mid’hati e ngriti edhe kur erdhi me shërbim në Tiranë në periudhën gusht - tetor 1924.

Ai kishte kërkuar të krijohet një “Drejtori e Përgjithëshëm për Rikonstruktim të vendëve të shkretuara dhe për Instalimin të refugjatëve që gjindën në Sarandë dhe Delvinë”. Këtë problem Mid’hat Frashëri e kishte biseduar edhe në takim me presidentin e Republikës Ahmet Zogun. Mid’hati shkruante se ai kishte gjetur mirëkuptimin e tij. Zogu e kishte siguruar madje se në këtë detyrë dot të caktohet një njeri i zoti dhe i ndershëm. Duke u nisur nga fakti se presidenti i kishte inkurajaur atë që t’i shkruante atij drejpersedretji për problemiet që ai do t’i konsideronte të rëndësishme, Mid’hati i kujtoi atij në nëntor 1924 premtimin e dhënë për ngritjen e Drejtorisë së lartpëmëndur. Ai e ngriti këtë problem meqënëse “puna e shqiptarëve të Greqisë” kishte “ardhur në një fazë kritike” që nuk mund të duronte më tepër “kështu e mvarur.” Kjo gjë sot - shkruante Mid’hati, më duket edhe më e madhe akoma, sepse çështja na kanoset me një katastrofë kombëtare të rëndësishme”

Të dëbohet minoriti grek.

Përpyekjet e qeverisë shqiptare dhe të ministrit të saj në Athinë për të ndaluar autoritetet greke të dëbonin me dhunë popullsinë muslimane shqiptare në rrugë diplomatike, rezultuan të pasukseshme.

Duke bërë bilançin e politikës greke për dëbimin shqiptarë në Turqi ministri ynë i tërhiqte vëmendjen Tiranës zyrtarë se:

Më 1922 në Greqi kishte pasur 100.000 shqiptarë myslimanë.

Prej këtyre autoritetet grek kishin arritur të dëbonin 35.000 nga prefektura e Kosturit dhe e Follorinës dhe 20 mijë nga Janina, Preveza, Parga. Kjo popullsi, theksonte ministri ynë u dëbua kundër vullnetit të saj me shtërngime të zyrtarëve grekë (gjindarmë ose myftinj) ose më keq akoma me dru dhe me shkop të gjindarmit. Shqiptarët e përzënë me përdhunë ishin atëhere të shpërndarë në krahina të ndryshme të Anadollit, ku vuajinin nga uria “me qënë se pasuria e tyre u grabit dhe u rrëmbye prej Greqisë”

Pas parqitjes së kësaj tabloje të rëndë Mid’hati i sygjeronte ministrit të jashtëm masa të ashpra të jashtzakëshme :

1-Të merrte masa kundër elementit grekofon në Shqipëri
2-Të thërriste në Shqipëri cdo çam që ishte përzënë ose do të përzihej paskësaj dhe të instalohet në pasuritë dhe shtëpitë e elementit grekofon.

Sipas tij, kjo duhej bërë detyrimisht meqënëse Greqia kërkonte të dëbonte shqiptarët që kishin mbetur në Greqi në kundërshtim me të gjithë aktet dhe detyrimet ndërkombëtare ndaj minoriteve.

Pasuria e grabitur-2.700.000 napolana ar.

Në shtator 1925 Mid'hati shkruante se "politika helenik" për dëbimin e elementit mysliman nga Epiri dhe Maqedonia kishte nisur "që të nesëremen e luftës ballkanike". Ajo kishte filluar të zbatohet "me anë të çetave të hajdutëve dhe të sjelljeve të autoritetëve civile dhe militare". Sipas tij, kjo politikë mori një ngjyrë të re pas motit 1920":Lidhur me këtë ai shkruanme se :

1-U përzunë me dru dhe më të rrahur prej gjindarmërisë greke 35. 000 shqiptarë të Follorinës dhe të Kosturit.

2-Në kundërshtim me deklaratën që bëri delegati grek në Lozanë, z.Caclamanos në janar 1922 , u përzunë me pahir dhe me dru:

A- Të tërë shqiptarët e Prevezës.

B-Një pjesë e madhe e shqiptarëve të Konicës.

C-Të tërë shqiptarët e Pargës.

D-Një shumicë e shqiptarëve të vetë Çamërisë

3-Shqiptarët myslimanë në Epir ose Maqedoni s'kanë të drejtë as të shesin as të japin më qera as të marrin të hollat pasurite e tyre.

4-Asnjë shtëpi nuk ka mbetur e lirë : kudo kanë kallur më pahir refugjatë, duke hedhur rrugëve të zotërit e shtëpive.Shumë shtëpi rrinë të zbrazura, refugjatët (grekë-red) qeveria greke i instalon në shtëpitë e shqiptarëve.

5-Refugjatët me lejen e autoritetëve grabisin pasurinë, kopshtet, ullinjë, fiqtë, vreshtat dhe drithrat e shqiptarëve.

6-Pasuria e grabitur gjer më sot .. arrin vlerën 2.700.000 napolona ar.

7- Dyert e drejtësisë janë të mbyllura për shqiptarët dhe të rrahurët, të grabiturët, të burgosurët, janë buka e perditëshme për to.

Qëllimi i këtyre sjelljeve është të shtërngohen shqiptarët të ikin nga Greqia dhe të grabitet pasuria e tyre

10-Shqiptarët në Greqi s'kanë :

-të drejtë votimi

-s'kanë deputetë

-s'kanë të drejta për shkolla

D- Xhamitë dhe Teqetë e bektashinjve janë konfiskuar prej qeverisë.

Të këmbëjmë grekofonët me çamët

Më 15 tetor 1925 përballë revanshit të grekëve për dëbimin e shqiptarëve Mid'hat Frashëri i shkruante ministrit të jashtë shqiptar:

“Zoti ministër !

Do të përseris edhe një herë atë fjalë që kam thënë në më tepër se 50 raporte të mija; më duket se është e nevojshëm të merren masat:

1-Të emërohet një njëri në Gjenevë pranë Ldhjes së Kombëve që të mund të ndjekë punët tona pranë sekretariatit.

2-Të merren disa masa të lehta (në mos daçim që të jenë të renda) kundër grekofonëve si psh, të bëjmë disa instalime refugjatësh çamë në shtëpitë e tyre, të ndalohen grekofonët për blerjen e dhe shitjen e pasurive të patundëshme, masa të cilat do të duken fare të buta në krahasim më ato që po zbaton qeveria greke kundrejt elementit shqiptar”.

Më 17 tetor 1925 Mid'hat Frashëri shkoi akoma më larg në këto qendrime.

I paautorizuar nga qeveria, ai kishte deklaruar kryministrit grek Pangallo që “nëqoftë se Greqia ka qëllim, t'i përzërë çamët ose t'i shtërngojë derisa të ikin, atëhere më mirë të marrim masa që tani për të bërë edhe ne si Tyrqia, domethënë për të këmbyer grekofonët tanë me çamët e Greqisë”.

Duke njoftuar Tiranën Zyrtare për hapa të tilla Mid'hati i shkruante ministrit të jashtëm : Me këtë rast, zoti ministër, do të përseris ato që pata nderin të parashtroj në raportin tim të datës 15 se është më mirë që të na qahen dhe të na luten neve grekët se sa ne atyre”.

Më 29 tetor Mid'hati i sygjeroi Tiranës të hyhej në bisedime me grekët për këmbimin e popullsisë çamë me atë të minoritetit grek:

“Zoti ministër ! - shkruante Mid'hati-

Në qoftë se e shihni të udhës unë propozoj këtë politikë:

Meqënë se Greqia po refuzon drejtësinë për elementin shqiptar dhe meqënë se në çdo mënyrë po i shtërngon dhe i ndalon të rrojnë, atëhere të propozojmë këmbimin e elementit grekofon të Delvinës me Çamërit e Epirit. Më jipni instruksione”.

Duhet të dimë të mbrojmë veten tonë, zoti ministër

Si gjithmmonë instruksionet nga Tirana nuk erdhën dhe Mid'hat Frashëri mori vetë përgjegjësinë të diskutonte këtë çështje me autoritetet greke.

Më 2 nëntor ai njoftoi Tiranën zyrtare se kishte takuar kryeministrin Pangallo dhe pasi i kishte bërë të ditur “vuajtjet që po hiqin çamët që trej tre vjetësh”, i kishte deklaruar se :

“ Në qoftë se Greqia ka ndër mend me këto masa t’i bëjë çamët që të ikin, atëhere më mirë të na e thotë që tani dhe të marrim masa për këmbimin e tyre me grekofonët e Shqipërisë.”

Më tej Mid’hati i shkruante minisrit të jashtëm edhe këto radhë :

Po marr lirinë, zoti ministër, të përsëris akoma njëherë atë që e kam thënë në më tepër se dyqind herë gjer më sot : Duhet të dijmë të mbrojmë veten tonë. Për këtë qëllim ju lutem :

1-Të emërohet me urgjencë në Gjenevë, pranë shoqërisë së Kombëve, një nëpunës i zoti që të na ndjekë në punët tona.

2-Ti propozohet zyrtarisht Greqisë që të këmbejmë grekofonët tanë me çamët e Epirit. Të fillojë që tani dhe të shkruhen (regjistrohen-red) pasuritë e tundëshme dhe të patundëshme të grekofonëve dhe të ndalohet përkohësisht shitja e tyre.

Këto masa do të kenë dy efekte :

A-Do të bëjmë Greqinë të ndërrojë sjelljet e saj përkundrejt çamëve

B-Do të dëgjohen në Epir dhe do tu japë kurajo dhe shpirt çamëve, të cilët do të kuptojnë se Shqipëria u interesoka për ta.

Duke pritur instruksionet tuaja dhe udhëheqien e shkelqesisë suaj në këtë pikë,

Frashëri

Zoti Kryetar i Republikës e shoh të nevojshme t’ju them

..

Instruksionet nga Tirana përsëri nuk erdhën.

Më 4 nëntor 1925 Mid’hati iu drejtua drejtpësdrejt Presidentit të Republikës Ahmet Zogut. Ky, siç thamë më lart i kishte bërë të ditur Mid’hat Frashërit se mund ti drejtohej atij për çështje që do ti konsideronte të rëndësishme.

Në letërn drejtuar Zogut, Mid’hati shprehej kështu :

“Zotni Kryetar !

1-Punët tona në Shoqërinë e Kombëve sa vete po shtohen dhe e shoh fort të nevojshme të emërohet në Gjenevë një zyrtar i zoti, më vullnet të madh, dhe që të dijë mirë punët e Shqipërisë.

2-Puna e Shqiptarëve të Greqisë dhe më tepër ajo e çamëve ka ardhur në një fazë kritike që nuk mund të durojë më tepër kështu e mvarur.

Kam bërë cdo javë më tepër se një raport në Ministrinë tonë dhe kam rekomanduar masa reciproke.

Edhe dje kuvendonja me një koleg tim mbi këtë punë. Më pyeti në kemi edhe në Shqipëri grekë. I thashë se kem disa mijë. “Po atëhere ç’i mbani ? Pa i përzini, le të vijnë këtu në Greqi, pa atëhere (do të shihni që-red) Qeveria e Athinës do tju lutet juve.

3-Puna e refugjatëve që do të vijnë në Shqipëri ka një importancë fare kryesore për neve. Mjerisht transporti dhe instalimi i refugjatëve nuk po bëhet aspak në rregull dhe nga këto parregullsi mund të na ngjasë ndonjë fatkeqësi e madhe.

Shkëlqesia e Juaj kishte pasur mirësinë të më premetoni se një njëri i zoti, energjik, dhe i ndershëm do të emërohet Drejtori i Përgjithshëm për Instalim dhe Konstruktim. Kjo nevojë sot më duket edhe më e madhe akoma, se çështja na kanoset me një katastrofë”. Nuk di, z.ministër, kjo që bëmë, politikë është apo tradhëti kombëtare ?

Materialet e fundit të Mid’hat Frashërit tregojnë se ai humbi plotësisht besimin tek qeveria shqiptare. Në një letër të tij ai bën të ditur se i kishte kërkuar ministrit të jashtëm shqiptar që problemet që ngrinte të diskutoheshin në senat dhe në parlament por kjo kërkesë nuk ishte parë me vend në Tiranë.

Mid’hati u përpoq të kompensonte këtë qëndrim të mefshtë të Tiranës Zyrtare duke i shkruar drejtpërdrejt personalitetëve kryesore të Lidhjes së Kombëve si dhe duke intensifikuar takimet me autoritetet greke pa i relatuar Tiranës Zyrtare.

Më 19 nëntor ai u justifikua më këto fjalë pata ministrit të jashtëm shqiptar që kërkonte të dinte “heshtjen” e tij :

“Punët e shumta, mungesa e një sekretari të dytë, okupimi i z.Noçka (një nëpunës i Legatës-red) me provimet e shkollës, shifrimi dhe deshifrimi i telegramëve të panumurta më kanë ndalur që t’i paraqes Shkëlqesisë raporte mbi çështjen kaq të hidhur të çamëve”.

Pasi i njoftonte takimet që kishte pasur me autoritetet e larta greke dhe përplasjet që me ta, Mid’hati shkruante :

“Zoti ministër !

Po shoh se Greqia ka një politikë me neve. Pasi Serbisë Shqipëria i dha Shën Naumin dhe Greqia kërkon që të sigurojë një situatë me venome në Shqipërinë e Jugut (këtë gjë e kisha parashikuar dhe pata nderin të ju a telegrafoj me datë 12 tetor), me lutje që telegrami im ti komunikohet Senatit dhe Parlamentit, gjë që nuk u bë.

Greqia tani kërkon, duke shtërnguar çamët që ose këta të ikin (në Turqi-red) dhe Greqia të ketë një fitim material dhe moral ose të na bindë të pranojmë çdo gjë për të forcuar helenizëmën në Korçë dhe Gjirokastër”.

Raporti i tij i kësaj date tregon se Mid’hati ishte dezilionuar krejtësisht nga Qeveria Shqiptare dhe këtë i’a shprehu edhe ministrit të jashtëm. Pasi i kujtoi se pala Shqiptare nuk kishte marrë masat që kishte ai kishte sygjëruar, Mid’hat i tha atij

“Mjerisht, ne gjer më sot kemi punuar si armiq të kombit dhe të shtetit : as në Turqi nuk kemi dashur të çojmë një njeri, as në Gjenevë as edhe masa reciproke dhe reprezalje (nuk-) kemi dashur që të marrim kundër grekofonëve.*Nuk e dij kjo që bëmë gjer më sot politikë është apo tradhëti kundër mëmëdheut?*”

Jini i liri të jepni dorëheqjen, z.minstër !

Raporti i Mid'hatit ra si bombë në Tiranë dhe kjo sigurisht shënoi edhe fundin e tij në shërbimin diplomatik. Ministri i jashtëm, i akuzuar për meftësi, pasi shprehte nervozizmin e vet në shkresën e datës 25 nëntor 1925, kërkonte dorëheqien e Mid'hatit. Për këtë, ai i drejtohej atij si më poshtë :

“Zoti ministër !

Me shkresën tuaj nr. 1553, datë 17 të këtij muaji, shihet se dezaproveni politikën e çështjeve të jashtme. Siç e dini, funksionarët janë organe të shtetit, të cilët janë të detyruar të ekzekutojnë direktivat e politikës së caktuar nga Qeveria Qendrore. Pra, në qoftë se Zotëria Juaj, nuk jeni dispozé të ekzekutoni këto direktiva, atëhere jeni i lirë të jepni dorëheqien”.

Gazeta IMIGRANTI bën të ditur se në dhjetor të vitit 1925 Mid'hati kishte pranuar të jepte dorëheqien nga detyra.

“Sipas një letre që muarrmë këto ditë nga Athina, thuhet në këtë gazetë-lajmërohemi se zoti Mid'hat Frashëri, Ministri i Shqipërisë në Athinë, dha dorëheqien. Dorëheqien e kish dhënë që në Dhjetor 1925, po tani i erdhi pranimi. Flitet se Zotërija e tij nuk do të marrë asnjë post në qeverinë e sotme dhe se ay do të merret me shkrimin shqip. Zoti Mid'hat shkoj për në Tiranë”
(IMIGRANTI, 8 maj 1926)

Hysen Vrioni do të merret me çifligjet e tij në Greqi dhe jo me punët e shtetit

Kërkesa për dorëheqie e ministrit fuqiplotë në Athinë nuk mund të bëhej pa pëlqimin dhe miratimin e Presidentiti të Republikës Ahmet Zogu. Materialet tregojnë se se ai i kishte bërë këto përpjekje me kohë. Këto përpjekje ai i kishte bërë që në fillim të vitit 1924. Njoftimin për këtë jep “GAZETA e KORÇES”, datë 2 shkurt 1924. Gazeta bënte fjalë se ai do të dërgohej me të njëjtën detyrë në në Ëashington. Sipas gazetës pasardhës i tij në Athinë do të ishte Hysen Vrioni. Njoftimi ngjalli një reagim të menjëhershëm në median shqiptare.

“Vrioni, një pinjoll i familjes së njohur të bejlerevë të mëdhenj Vrionas, -thuhej në shtyp-do të mirrej më shumë me çifligjet e tij në Greqi, ndërsa Shqipëria kishte nevojë për një përfaqësues si Mid’hat Frashëri për të mbrojtur interesat kombëtare” .

Shtypi po ashtu bën fjalë në gusht të vitit 1925 për kalimin e Mid’hat Frashërit me “Mision Special” në Egjypt. Sipas gazetës TIRANA që njoftonte këtë lajm thuhej :

“Shkoi pardje për në Tiranë, duke ardhur nga Athina, z.Mid’hat Frashëri, përfaqësonjës i Shqipërisë pranë Qeverisë Greke. Zotërija e tij, thuhet se transferohet në Kajro, po më atë cilësi.

Pardje, të shtunën u pranua në audiencë nga Shkëlqesia e tij, Kryetari i Republikës”.

Lajmi ngjalli entuziazëm të menjëhershëm te shqiptarët e Egjipit.

Më 25 shtator 1925 gazeta e përjavshme “BISEDIMET” i bënte një koment dashamirës lajmit të përhapur duke vënë në dukje kontributin e tij si shrimtar dhe diplomat i talentuar.

“Njoftohet-shkruhet në gazetë- mbërritja e afërt në Egjypt e Mid’ht Frashërit, ministër i Shqipërisë në Athinë, i dërguar nga Qeveria e Tiranës me Mision Special. Përftojmë nga rasti për të dhënë një vështirim biografik për këtë diplomat të shquar që është në të njëjtën kohë edhe shkrimtar i shquar, si dhe për familjen Frashëri, e përbërë nga personalite të dëgjuara dhe shkrimatrë të njohur”.

Gazeta shkruante se Mid’hati kishte një veprimtari të suksesëshme diplomatike.

“Disa kohë para se të emerohej në Athinë, Mid’hat Frashëri ka ushtruar detyra shtetërore të rëndësishme dhe delikate, të cilat gjithmonë i ka kryer më së miri duke u dhënë kënaqësi të plotë atyre që e kishin zgjedhur. Në periudhën e regjimit të mëparshëm cilësitë e tij të çmuara kanë tërhequr simpatitë e qeveritarëve të atëhershëm, të cilët e emëruan në detyra tepër të rëndësishme.

Sot atë e gjejmë në krye të një delagacioni në Athinë, ku drejton me takt, dhe mirësjellje që pëlqehet nga të gjithë dhe që i sugurojnë atij një të ardhme të shkëlqyer”

Gazeta vinte në dukje edhe prejardhjen e Mid’hatit nga familja patriotike e Frashëllinjve të shquar.

“Përveç këtyre cilësive që përmendëm më lart-vijonte gazeta “GAZETA e KORCES”, Mid’hat Frashëri zotëron edhe cilësi të tjera. Ato e bëjnë këtë një personalitet të shquar në fushën e letërsisë. Ai është një dijetar i shquar, autori mjaft veprave. Ka përkthyer në shqip vepra të ndryshme të autorëve europianë, veçanërisht “Vilhelm Tel” Nga kjo pikëpamje Shqipëria i detyrohet shumë atij.

I ati i tij, Abdyl Frashëri, ka qënë udhëheqës i lëvizjes për pavarësinë e Shqipërisë Dihet se Konferenca e Berlinit e 1878-ës kishte projektuar coptimin e Shqipërisë në përfitim të Malit të Zi, Serbisë dhe Greqisë.

Mid’hat Frashëri është djali i vëllait të Naim Frashërit, një nga poetët më të medhenj të Shqipërisë si dhe i Sami bej Frashërit, dijetarit dhe enciklopedistit, autor i librave të parë pedagogjike shqiptarë”.

Gazeta theksonte më tej se “ Me këto të dhëna të shkurtra biografike mund të kuptojmë vendin e nderit që zënë anëtarët e

familjes Frashëri si dhe vlerën e këtij personaliteti të shquar që së shpetji do të presim. Askush nuk dyshon se bashkëatdhetarët tanë do t'i përgjigjen me kënaqësi thirrjes sonë për të pritur në mënyrë të denjë këtë përfaqësues të shquar të vëndit tonë”.

Një dokument nga “Foreign Office”

Lajmin për largimin e Mid’hat Frashërit nga detyra e Ministrit Fuqi plotë në Athinë e jep edhe ambasadori anglez në Durrës Robert Parr, në letrën dërguar ministrit të jashtëm anglez, Austin Chamberlain.

Letra ruhet në Arkivin e Punëve të Jashme të Anglisë “Foreign Office”.

Robert Parr njoftonte më 25 shkurt 1925 Çamberlain-in se Mid’hat Frashëri u largua nga detyra e tij nga Kryetarit i Republikës Ahmet Zogu. Parr-i bënte të ditur se Ahmet Zogu e kishte marrë këtë vendim në mirëkuptim me qeverinë greke. Arsyet e këtij hapi të ndërmarrë nga Zogu mendojmë se duhet te kene qënë të karakterit politik. Zogu duket se nuk mund të përballonte një krizë të thellë në marrdhëniet e tij me Greqinë për çështjen çame. Kjo duket ka qënë edhe arsyeja përse ai nuk ndërmori edhe masat që i propozonte Mid’hat Frashëri në raportet e tij të shumta.

Ambasadori englez në Durrës Robert Parr nuk e fshehte gëzimin e tij për largimin e Mid'hat Frashërit nga detyra. Sipas tij Mid'hati ishte personi që kishte nxjerrë probleme të shumta kundër largimit të çamëve myslimanë si pakicë kombëtare në turqi. Robert Parr njoftonte Chamberlain-in se personi që do të zëvendësonte Mid'hatin ishte një një nëpunës i zakonëshëm dhe pa inisjive, që nuk mund të bënte më shumë se sa të shkëmbente postën zyrtare midis dy vendeve.

Pas kthimit nga Athina Mid'hat Frashëri nuk shërbeu më në administratën e shtetit shqiptar të udhëhequr nga Ahmet Zogu. Ai i'u kthye veprimtarisë së tij të gjërë në fushëm publicistike si gazetar dhe shkrimatar i talentuar.

GREQIA DHE ÇËSHTJA SHQIPTARE NË VITIN 1911

Shtetet ballkanike të gjitha në të njëjtën kohë po përpiqeshin të konsolidonin ekzistencën e tyre duke krijuar perspektiva për zgjerime të mëtejshme territoriale. Motivimi i tyre për këtë për këtë rridhte nga të drejtat etnografike, gjeopolitike, historike, kulturore dhe realitetet ekonomike. Gara e armatimeve dhe militarizmi ishin gjithashtu tipare karakteristike të shoqërisë së Evropës Juglindore²⁰. Të tre shtetet ballkanike (Greqia, Serbia e Mali i Zi) ishin bërë zotër të fatit të tyre. Edhe pse regjimet politike (monarki autoritare), struktura sociale dhe ekonomike ishin mjaft të ngjashme, politika e jashtme i ndante dhe i kundërvinte shtetet e mësipërm, njërin kundër tjetrit²¹. Shpërthimi i kryengritjes së Malësisë së Madhe në pranverën e 1911 i ofronte mundësi Malit të Zi, Serbisë, Bullgarisë dhe Greqisë që të përfitonin prej saj për t'i dhënë fund sundimit osman në gadishullin e Ballkanit²². Çfarë reagimi shkaktoi kryengritja e Malësisë së Madhe e vitit 1911 te kabineti politik i Athinës? Së pari, ajo tregoi se revolta e armatosur kundër pushtetit turk mund të dilte me sukses, kështu që e nxiti Greqinë dhe shtetet e tjera ballkanike të kërkonin me bindje të plotë të drejtat e tyre lidhur me tokat që ende mbaheshin të pushtuara nga Perandoria Osmane. Së dyti kryengritja shënoi ridaljen e çështjes shqiptare dhe së treti, ky fakt e shqetësoi shumë Greqinë, Serbinë, Malin e Zi dhe Bullgarinë, pasi këto shtete kishin synime për aneksimin e territoreve, në të cilat shumica e popullsisë fliste kryesisht gjuhën shqipe²³.

Një vit më parë (1910) në Greqi ishte ndërruar kabineti qeveritar. Me një thirrje drejtuar nga vendlindja e tij Kreta, Venizellosi erdhi në pushtet, duke marrë masa për nxitjen e politikës së brendshme e të jashtme greke. Për këtë arsye ai ndërmori një përpjekje konkrete për ta udhëhequr vendin jashtë politikës së izolimit²⁴ në arenën

²⁰ Valery Kolev and Christina Koulouri *The Balkan Wars*, Thessaloniki 2005, f. 14.

²¹ Henry Bogdan *Storia dei Paesi dell'Est*, SEI, Torino 2004, f. 181.

²² Qamil Gexha *Shtypi i Malit të Zi mbi Lëvizjen Kombëtare Shqiptare 1873-1912*, BliniBK, Gjakovë 2003, f. 178.

²³ Mark Mazower *Ballkani Një histori e shkurtër*, Skanderbeg Books, Tiranë 2003, f. 112.

²⁴ Harry J. Psomiades *The Eastern Question: The last Phase*, IKH 1968, f. 21.

ndërkombëtare. Në politikën e brendshme partia liberale e udhëhequr nga Venizellosi filloi inaugurimin e një serie reformash në institucionet ekonomike, politike dhe ushtarake të vendit. Objektivi ishte të rrisnin kapacitetin luftarak të njerëzve, që të gëzonin të mirat e ngjarjeve të mëdha të ravijëzuara nga zhvillimi i situatës ndërkombëtare²⁵ duke i dhënë Greqisë një hop tjetër në këtë kuadër. Në përçapjet për organizmin e kryengritjes së re në vitin 1911 udhëheqësit e saj në misionin diplomatik për kauzën shqiptare nuk e lanë jashtë vëmendjes së tyre as Greqinë si fqinjin jugor të shqiptarëve. Ismail Qemali që në fillim të muajit shkurt 1911 pati një takim me ambasadën greke në Stamboll ku nënvizoi faktin se Shqipëria ndodhej në gjendje trazire për shkak të përndjekjeve të Turqisë.

Qëllimi i këtij takimi për I. Qemalin ishte që nëpërmjet kësaj bisede të dinte nëse marrëveshja e tij me qeverinë greke ishte ende në fuqi. Pas përfundimit të takimit, Athina e garanoi nacionalistin shqiptar se qeveria greke do ta respektonte marrëveshjen²⁶ dhe për këtë s' duhej patur asnjë dyshim²⁷. Në pasqyrimin e ngjarjeve në Shqipëri nga ana e saj gazeta greke "Athenes" disa ditë pas shpërthimit të kryengritjes bëri një vlerësim dhe analizë të veprimit të shqiptarëve dhe të interesave midis shqiptarëve dhe malazezëve. Në artikullin e saj "Athenes" shprehet: por ne kemi frikë se me zgjedhjen e Malit të Zi si bazë ata (shqiptarët - S. Gj.) kanë bërë një gabim sipas saj. Në fokus të këtij konkluzioni ajo vendoste mosbesimin dhe armiqësinë, të cilat formonin një mur midis shqiptarëve²⁸ dhe malazezve gjatë kryengritjes së vitit 1911. Meqënëse malazezët janë sllavë vazhdon më tej komentin e saj, ata ndjekin interesa sllave dhe nuk mund të jenë miq të shqiptarëve, një pjesë e madhe e të cilëve bazohet në ndihmën e ndërmjetshme austriake.

Ideja ishte për të treguar se as njëra dhe as tjetra mbështetje nuk ishin mjaft të forta dhe se shqiptarët duhej ti drejtonin vështirësitë e tyre me besim dhe të bazohen në vëllazërimin dhe ndihmën kombëtare të grekëve²⁹. Me shpërthimin e kryengritjes shqiptare Greqia shfaqti interes për të kontribuar në zhvillimin e saj me ndihma dhe u angazhua për të qenë e informuar mbi mënyrën e vijimit të lëvizjes së armatosur të

²⁵ *Po aty*; Costantin Botoran Greece në: *Assertion of Unitary Independent National States in Central and Southeast Europe (1821-1923)*, Bucure ti 1980, f. 83.

²⁶ Më hollësisht për këtë marrëveshje shih: Vasilis Kondis *Greqia dhe Shqipëria në Shekullin e XX*, Paratiritis, Selanik 1997, f. 29.

²⁷ *Po aty*, f. 30.

²⁸ *Haus Hof und Staats Archives, Politisches Archives* (më tej - HHStA. PA) në: A.I.H, 14 - C, Athinë 1 prill 1911, f. 13.

²⁹ *Po aty*.

shqiptarëve dhe të kërkesave politike që ata do të adresonin për çështjen e tyre. Ministri i Jashtëm i Greqisë Joanis Griparis nga njëra anë, i nxiti qarqet diplomatike greke të përkrahnin luftën e malësorëve të Shqipërisë së Veriut, por nga ana tjetër të pengonin shtrirjen e saj në veri dhe në jug të Epirit. Fillimisht, qeveria greke përshtati një politikë, që shfaqte hapur qëndrimin e saj të diferencuar ndaj territoreve të Shqipërisë së Poshtme, ku ngërtheheshin pretendimet e saj. Kjo për shkakun se jugun e Shqipërisë, ajo e llogariste tashmë si pjesë të një Greqie të Madhe³⁰. Ndërsa në anën tjetër qeveria greke, sipas marrëveshjes së arritur me I. Qemalin dhe duke dashur t'u vinte në ndihmë malësorëve, u nisi atyre sasira të mëdha armësh dhe municionesh³¹.

Ngjarjet që po ndodhnin në Shqipëri po ndiqeshin nga çdo anë këtu (në Greqi) dhe siç është i informuar gjerenti austro-hungarez Braun në Athinë, ato e shqetësonin qeverinë në një shkallë të lartë. Greqia nuk donte të krijonte asnjë dyshim as te Fuqitë e Mëdha e as te Perandoria Osmane për interesat e saj në lidhje me çështjen shqiptare. Në bisedën e zhvilluar me Braun, Griparis për të mos i dhënë të kuptonte bashkëbiseduesit se ai dhe qeveria greke ishin të interesuar për kryengritjen shqiptare iu përgjigj se: “lëvizjes shqiptare nuk i jepte hëpërhë ndonjë rëndësi, të cilën ajo mund ta merrte në rast se do zgjerohesh në territore të tjera”³². Madje për t'i shërbyer sa më mirë planeve të saj qeveria e Athinës, sipas njoftimit të konsullit austriak Halla në Durrës: nënkonsulli grek i këtushëm Th. Apostolopoulos kishte marrë autorizimin prej qeverisë së tij për të shkuar provizorisht në Shkodër, ku aktualisht nuk ekziston asnjë zyrë konsullore greke³³.

Për shkak të ndryshimeve të vazhdueshme që po viheshin re në gadishullin ballkanik qeveria greke filloi të tregohet më aktive për politikën e saj në rajon. Venizellozi i mbështetur nga Rusia qysh në prill të 1911, i propozoi kryeministrit bullgar Geshov, që të nënshkruanin një aleancë midis të dy vendeve të tyre³⁴. Atdhetarët e shquarë shqiptarë vazhduan përpjekjet për të siguruar përkrahjen e Greqisë për kryengritjen shqiptare. Për këtë qëllim gjatë muajit maj 1911, Faik Konica u takua në Amerikë me Lisimahos Kaftaxoglun, të ngarkuarin me punë *ad interim* të ambasadës

³⁰ Pëllumb Xhufi *Megali-Idea dhe pasqyrimet e saj në marrëdhëniet shqiptaro-greke*, Studime Historike Viti LX (XLIII) nr. 1-2, Tiranë 2006, f. 53-54.

³¹ Vasilis Kondis *Greqia dhe...vep. e përme*. f. 30-31.

³² HHStA. PA, Nr. 14/C Athinë 1 prill 1911.

³³ HHStA. PA, Nr. 19, Durrës 8. 4. 1911.

³⁴ *Historia e Perandorisë Osmane*, grup autorësh nën drejtimin e Robert Mantranit, Dituria, Tiranë 2004, f. 559.

greke në Uashington. Faiku i kërkoi ndihmë dhe mendoi se ky ishte një rast për Greqinë të tregonte simpatinë e saj ndaj Shqipërisë. Diplomati grek vuri në dijeni menjëherë Ministrinë e Jashtme dhe, me këtë rast propozoi që qeveria greke t'u jepte ndihmën e nevojshme shqiptarëve. Dhe, vërtet Athina e miratoi dhe deklaroi se grekët me banim në Shtetet e Bashkuara do të ndihmonin malësorët³⁵. Në muajin maj Ismail Qemali pati bisedime të shpeshta me përfaqësues të diplomacisë greke në lidhje me kryengritjen shqiptare. Nga njoftimet e legatës bullgare, e cila lajmëronte Ministrinë e Jashtme në Sofje, mësojmë se në datën 23 maj në Korfuz kishin arritur disa krerë shqiptarë, midis të cilëve dhe Ismail Qemali dhe kanë zhvilluar bisedime me Greqinë³⁶. Gjithashtu përpara se të shkonte te udhëheqësit luftarak të kryengritjes në Mal të Zi I. Qemali kishte patur një takim tjetër me ambasadorin grek në Stamboll, ku paraqiti një projekt-memorandum të cilin do t'ua parashtronte prijësve të kryengritësve malësorë dhe kërkoi mendimin e qeverisë greke.

Përgjigja që i ktheu Athina I. Qemalit ishte se: interesat e Shqipërisë do të mbështeteshin më mirë nëse pretendimet shqiptare harmonizoheshin me ato të kombësive të tjera, domethënë të drejta të barabarta për të gjithë³⁷. Me rritjen e veprimtarisë luftarake të shqiptarëve kundër Perandorisë Osmane dhe në jug të vendit, në qershor të vitit 1911, grupe të armatosura greke u dukën në Epir si kundërpeshë ndaj çetave të luftëtarëve shqiptarë. Shkaku ishte jo vetëm aksioni i armatosur i shqiptarëve të udhëhequr nga Namik Delvina, Spiro Bellkameni, Musa Demi etj., por edhe propaganda e dëndur që po bëhej në këto vise për autonominë e Shqipërisë³⁸ nga udhëheqësit e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Qarqet drejtuese të Athinës nuk qëndruan indiferente ndaj këtyre veprimeve dhe reagimi i tyre ishte i menjëhershëm. Qeveria greke, ndërkaq në orientimet që u jepte përfaqësuesve të vet diplomatikë në Epir (në Shqipërinë e Jugut), u bënte të njohur se grupet në fjalë duhet të shpërndaheshin dhe të mos u jepej asnjë lloji ndihme. Ky qëndrim nuk ishte i pa menduar. Me këto lëvizje politika greke nuk synonte të ngjallte pakënaqësi te shqiptarët.

³⁵ Vasilis Kondis *Greqia dhe...vep. e përme*. f. 36.

³⁶ Koli Xoxi *Ismail Qemali*, 8 Nëntori, Tiranë 1983, f. 211.

³⁷ Vasilis Kondis *Greqia dhe...vep. e përme*. f. 31.

³⁸ *Historia e Popullit Shqiptar Vëll II*, Toena, Tiranë 2002, f. 454.

Greqia ishte e interesuar që të shpërthente lufta ndërmjet Malit të Zi dhe Perandorisë Osmane, në të cilën ajo shihte një mundësi që të largohej vëmendja e shqiptarëve nga lëvizja dhe programi i tyre politik në Shqipërinë e Jugut. Pasi vëmendja do të përqendrohej në veri të vendit dhe ndaj këtij problemi të ri. Për të provokuar përpjekjen e armëve midis Turqisë dhe Malit të Zi, Greqia nën maskën e luftës për zgjidhjen e çështjes shqiptare u propozonte fuqive Evropiane të luftojnë kundër Turqisë³⁹. Ministria e Jashtme greke më 30 qershor 1911, me anën e një qarkore që u dërgonte të gjitha konsullatave greke, i bënte një analizë të hollësishme çështjes shqiptare dhe vinte në pah qëndrimin e vet kundrejt Shqipërisë: “Është absolutisht e nevojshme t’u bëhet e qartë shqiptarëve se Greqia nuk ka mbajtur kurrë qëndrim kërcënues dhe armiqësor ndaj tyre. Përkundrazi, themelimi i një shteti të pavarur shqiptar përkon me interesat greke, sepse objektivisht do të jetë një mik besnik dhe aleat i domtosdoshëm për ne”⁴⁰. Në muajin korrik qeveria greke e përqëndroi më tepër vëmendjen ndaj kryengritjes shqiptare. Në të vërtetë gjendja e mbretërisë greke ishte përmirësuar. Zoti Venizellos i kishte plotësuar shpresat, që u ushqyen mbi karakterin dhe gjykimin e tij, kurse turbullirat që shkaktuan aq shumë ankth, duket se jo vetëm kanë pushuar në Greqi, por janë pakësuar, bile edhe në Kretë⁴¹.

Lëvizja shqiptare kishte bërë përshtypje në opinionin e Greqisë. Vetë grekët i shikojnë me simpati të gjitha të këqijat që i bëhen Turqisë; dhe gëzimi i tyre do të ishte më i madh sikur mos të frikësoheshin se lëvizja shqiptare mund t’i dëmtonte interesat helenike në atë anë. Ftesës së bëra nga ana e Nikollës, Venizellosi iu përgjigj në këtë mënyrë: se Greqia simpatizon lëvizjen shqiptare po si Mali i Zi dhe i uron atij sukses. Meqë është e zënë me transformimin e brendshëm dhe s’është e përgatitur sa duhet nga pikëpamja ushtarake, Greqia është e detyruar që edhe një kohë të qëndrojë e qetë dhe t’i shmangët çdo konflikti të armatosur⁴², që nuk i përgjigjej potencialit aktual të interesave greke në Ballkan. Ndërsa në muajin gusht 1911 kemi një ndryshim të diplomacisë greke. Ndryshimi ka të bëjë me veprimet e shqiptarëve në jug të vendit dhe kërkesat e tyre

³⁹ I. S. Galkin *Nga historia e Lëvizjes Nacionalçlirimtare në Shqipëri në vjetët 1910-1912* në: Buletini për Shkencat Shoqërore, nr. 1, Mihal Duri Tiranë 1955, f. 29.

⁴⁰ *Po aty*, f. 35.

⁴¹ HHStA. PA, Nr. 63 A-43, Morning Post 9 korrik 1911.

⁴² Legata e Athinës, P. 60, 18-VII-1911 cituar sipas: Zekeria Cana *Lëvizja Kombëtare Shqiptare në Kosovë 1908-1912*, 8 Nëntori, Tiranë 1982, f. 313.

politike të shprehura me anë të memorandumëve të shtuara, ku tani ata identifikohen plotësisht me Memorandumin e Greçës. Propaganda greke po e ndiqte me inkodim të hapët lëvizjen, e cila tani edhe në Shqipërinë jugore po merrte forma gjithnjë e më të theksuara, mbasi kishte frikë se kjo mos rrezikonte synimet e saj politike në Epir.

Në këtë periudhë kujdesi kryesor i përfaqësuesve konsullor grek në Shqipërinë jugore aktualisht më tepër se kurrë i kushtohej asaj që shqiptarët t'i mbajnë larg nga bashkimi me lëvizjen nacionale, futur në një rrugë revolucionare nga bashkatdhetarët e tyre. E gjithë kjo lidhet me përgjigjen e dhënë nga përfaqësuesi grek në artikullin e "Correspondence de l'Agence d'Athènes" se interesat janë argumentat, që shpjegojnë këtë aktivitet të delegatit të mitropolitit të Beratit dhe të djalit të priftit të Nartës sipas orientimeve të marra prej gjerentëve të shtetit grek⁴³.

Në mbyllje mund të shprehemi se pavarësisht shfaqjes së interesimit për të marrë pjesë në këtë zhvillim të ri që po ndodhte në fqinjin e saj verior, Greqia ishte më e përqendruar diku gjetkë. Gjithashtu çështja shqiptare nuk është se zinte vendin kryesor në diplomacinë e Athinës në vitin 1911. Qëllimi kryesor kombëtar për të gjithë politikën greke mbetej megjithatë jo Epiri, por Maqedonia dhe në një shkallë më të vogël Kreta, ku kjo e fundit luajti një rol të madh në politikat e brendshme deri në vitin 1913, kur ishulli u bë pjesë e mbretërisë greke⁴⁴.

Pozicioni politik dhe diplomatik i Greqisë ndaj problemit shqiptar ishte pragmatist. Çështja shqiptare u trajtua nga politikanët qeveria greke sipas vlerësimeve dhe relacioneve që i transmetoheshin nga përfaqësuesit respektiv që ndodheshin në Shqipëri në përgjithësi, dhe nga konsullatat afër zonave kryengritëse në veçanti. Qëndrimi i Athinës ishte i kushtëzuar nga marrëdhëniet ndërshtetërore që ajo kishte me Stambollin, me Fuqitë e Mëdha dhe me shtetet e tjera ballkanike. Greqia nuk mund të kishte një qëndrim tjetër sepse zhvillimi i autonomisë në Shqipëri ishte i papërputhshëm me aspiratat e politikës së saj kombëtare. Ajo sikurse dhe fuqitë e tjera ballkanike e konsideronte veten si trashëgimtare të vetme legjitime të tokave të Turqisë Evropiane në rast të copëtimit të saj⁴⁵. Në rast të kundërt ajo do të ishte plangprishësja e *status-quo* së

⁴³ HHStA. PA, Nr. 56, Vlorë 5 gusht 1911.

⁴⁴ Charles&Barbara Jelavich *Themelimi i Shteteve Kombëtare të Ballkanit, 1804-1920*, Dituria, Tiranë 2004, f. 162.

⁴⁵ Abdul B. Sula *Albania's Struggle for independence*, Waldon Press, New York 1967, f. 51.

“koncertit evropian” dhe e aleancës ballkanike kundër Perandorisë Osmane që po ngjizej në këtë kohë.

Ju faleminderit.

Sokol GJERMENI

MARIGLEN VERLI

POLITIKAT EKONOMIKE NË KOSOVË E ÇAMËRI PAS VITIT 1913*

Në përpjekjet për thyerjen, gjuhëzimin e më tej asimilimin e popujve të tjerë dhe për shkombëtarizimin e trojeve të huaja, pushtuesit kudo dhe kurdoherë kanë përdorur fort armën ekonomike.

Këtë kanë bërë edhe pushtuesit serbë e grekë në trevat shqiptare. Vetëm në 120-130 vitet e fundit, sulmi ekonomik mbi popullsinë shqiptare në trevat që u bënë objekt i ekspansionit dhe pasi u aneksuan nga Serbia dhe Greqia, u bënë përpjekje për t'i spastruar etnikisht, është përsëritur disa herë.

Në vitin 1878 princi i Serbisë Millan Obrenoviçi, pasi aneksoi Sanxhakun e Nishit, shpronësoi tokën dhe pasuritë e rreth 100 mijë shqiptarëve, të cilët i pati dëbuar me zjarr e hekur prej trojeve të veta. Ato kaluan gradualisht në duart e kolonëve serbë. Fat të ngjashëm patën edhe shumë prona të shqiptarëve në viset e aneksuara në këtë kohë nga Mali i Zi.

Shpronësime kolektive të shqiptarëve myslimanë që u gjendën në viset e përfituara nga Greqia, sipas vendimeve të Kongresit të Berlinit, kryen edhe qarqet drejtuese të Athinës.

Lufta Ballkanike në fillim të dekadës së dytë të shek.XX e zhvendosi teatrin e veprimeve më në thellësi të trevave shqiptare. Kosova dhe vise të tjera shqiptare veriperëndimore dhe lindore ranë rishtaz në duart e Serbisë dhe të Malit të Zi. Kurse Greqia okupoi Çamërinë dhe viset e tjera jugore e juglindore.

Shumë shpejt qysh në pranverën e vitit 1914, regjimet pushtuese të krajlëve Peter Karagjeorgjeviç dhe Nikolla Njegosh nxituan të ligjëronin dhe institucionalizonin shpronësimin e popullsisë vendase shqiptare në interes të kolonëve të ardhur serbë e malazezë. Mbreti i ri i Greqisë Kostandini, i cili mori pushtetin në marsin e vitit 1913, pas vdekjes së të atit, Georgit I, bënte ndërkohë

* Kumtesa e mbajtur në Konferencën “Çështja çame në kërkim të një zgjidhjeje”, Tiranë, 21 dhjetor 2006.

përpjekje të ethshme për inskenimin e të ashtuquajturës “Lëvizje autonome Vorioepirote”, për të lehtësuar aneksimin e krahinave të tjera shqiptare, të Korçës dhe Gjirokastrës, të cilat Fuqitë e Mëdha ia kishin njohur Shqipërisë. Por njëherësh edhe ai i kushtoi kujdes të veçantë projektimit të transformimeve pronësore në viset shqiptare që sipas vendimit të Konferencës së Londrës mbetën brenda kufijve të Greqisë.

Shpronësimi agrar i shqiptarëve dhe vendosja në tokën e tyre e kolonëve grekë, sikurse në Kosovë, u nxit dhe filloi arbitrarisht menjëherë pas Luftërave Ballkanike. Mbështetur në një nen të Kushtetutës së vitit 1911, që krijonte shteg për goditjen e pronarëve të mëdhenj të tokës, në kazatë e Filatit, Paramithisë dhe Margëlliçit u shpronësuan 16 çifligje të familjeve të mëdha të Dematëve, Sejkove, Çaparenjve, Dinenjve etj.

Procesi i shpronësimit të shqiptarëve i ndërprerë përkohësisht nga Lufta e Parë Botërore, u ripërtëri në një shkallë edhe më të lartë pas saj. Në Mbretërinë Serbo-Kroato-Slllovene (e cila pas vitit 1929 u quajt zyrtarisht Mbretëria Jugosllave), të porsakrijuar më 1 dhjetor 1918 nën drejtimin e dinastisë së Karagjeorgjeviçëve, në krahasim me vitet 1913-1915 kishte ndryshuar vetëm radha e veprimeve. Ndërsa më parë, në rrethanat e turbullta të luftërave të njëpasnjëshme (Lufta I Ballkanike, Lufta II Ballkanike, Lufta I Botërore) shpërngulja i pati paraprirë shpronësimit, në kushtet e reja të pasluftës botërore, kur faktori ndërkombëtar ishte më i vëmendshëm, dhe një sërë traktatesh ishin nënshkruar, shpronësimi që mund të justifikohet me reforma sociale, sikurse ishte reforma agrare doli në krye.

Gjatë 22 vjetëve të ekzistencës së Jugosllavisë monarkike në Kosovë dhe në trevat e tjera shqiptare të aneksuara, kryesisht nëpërmjet të ashtuquajturës reformë agrare, iu shpronësuan popullsisë shqiptare rreth 381 000 hektarë tokë nga të cilat 280 000 ha në viset etnike shqiptare. Vetëm në Kosovë u shpronësuan gjatë kësaj kohe afro 200 mijë hektarë, ose më tepër se gjysma e tokës së saj bujqësore. Madje gati 3/4 e kësaj sipërfaqeje i përkiste fshatarësisë shqiptare, në formën

private ose kolektive të pronësisë, dhe vetëm 1/4 kishte qenë tokë çifligjesh për të cilën formulohej një arsyetim ligjor me argumente sociale. Llogaritet se deri në vitin 1941 rreth gjysma e popullsisë shqiptare në Jugosllavi, prej 800-900 mijë banorësh, kishte pësuar drejtpërsëdrejti nga goditja ekonomike që i dha pushteti serb nëpërmjet një reforme agrare specifike, që përcaktohej nga projekti i kolonizimit sllav.

Përfituesit, në çdo rast, kuptohet, ishin elementë sllavë, dhe me përparësi, rreth 17 mijë familje kolonësh agrarë ose rreth 70-80 mijë vetë, (rreth 14 mijë familje me mbi 60 mijë vetëm në Kosovë) të sjellë nga Serbia, Mali i Zi dhe vise të tjera sllave të Jugosllavisë, bile edhe nga shtete të tjerë, të cilët me këtë rast përfituan mesatarisht 8,5 ha tokë për familje.

Përveç shpronësimit agrar popullsia shqiptare që jetonte në Kosovë dhe në vise të tjera të aneksuara nga Mbretëria Jugosllave, pësoi edhe goditje të tjera të karakterit ekonomik. Në shumë dokumente të kohës theksoheshin edhe “pengesa në tregëti..., suprimimi i koncesioneve ... etj.”. Shqiptarët bojkotoheshin me gjithfarë mënyrash edhe në marrëdhëniet e ndryshme financiare e të kreditit, ngarkoheshin me gjoba për pretekste nga më absurdet, madje ishin të detyruar të shlyenin taksa e tatime deri 3 herë më të larta në krahasim me serbët etj. Nuk ishin të rralla rastet kur pasurisë së shqiptarëve i vihej zjarri në fshehtësi, ose shkatërrohej nga bandat shoviniste që vepronin me nxitjen dhe nën mbrojtjen e autoriteteve të regjimit.

Pas Luftës së Parë Botërore, njësoj si në Jugosllavi edhe qarqet e larta të Greqisë ligjëruan plotësisht dhe rifilluan intensivisht politikën e shpronësimit të popullsisë shqiptare. Në vitin 1919 u miratua Ligji nr.2952 dhe më pas një varg aktesh ligjore e nënligjore që legjitimuan veprimtarinë specifike agresive të administratës dhe policisë në fushën e shpronësimeve, shitblerjeve, qeradhënies etj. si pasojë e kësaj politike pronat e shqiptarëve myslimanë bënë objekt shpronësimi dhe toka të parashikuara për kolonizim. Për këtë qëllim u shfrytëzuan veçanërisht momenti i shkëmbimit të popullsisë me Turqinë, që pasoi luftën

greko-turke të viteve 1919-1922. Ndër 350 mijë të ashtuquajturit “turq” të shpërngulur nga Greqia në Turqi (në shkëmbim të 1 200 mijë të krishterëve, kryesisht grekë të larguar nga Azia e Vogël) disa dhjetëra mijë ishin shqiptarë të besimit mysliman. Në viset e tyre parashikohej vendosja e 60 mijë refugjatëve grekë. Agresiviteti i autoriteteve greke ishte aq i madh saqë në fshatrat Nihor, Karbunarë, Draganj, Pjadhul, Gurrës, Luarat, Lopës etj., shqiptarëve myslimanë iu morën jo vetëm tokat bujqësore në pronësi private e kolektive, por edhe kopshtet dhe shtëpitë.

Fakti është tepër domethënës për të treguar synimin e njëjtë shovinist, shkombëtarizues të qarqeve drejtuese të Athinës, aq më tepër po të mbahet parasysh se në trevat e aneksuara nga Greqia që shtriheshin matanë kufirit politik shqiptaro-grek, ndërmjet Prevezës dhe Follorinës, në vitin 1913 jetonin rreth 115 mijë shqiptarë (3/4 myslimanë, 1/4 të krishterë). Vetëm nga viset e Follorinës dhe Kosturit brenda një kohe relativisht të shkurtër, duke filluar nga viti 1922, u shpronësuan arbitrarisht pa shpërblim rreth 35-40 mijë shqiptarë, të cilët kishin qenë kryesisht banorë të 38 fshatrave mjaft të zhvilluara.

Prej popullsisë shqiptare myslimane u zbrazën edhe qytetet e Janinës, Prevezës, Pargës etj. Këtu më fatlumët arritën para largimit, të shisnin për pak para pasurinë që vlenë shumë më tepër.

Për gjithë sa ndodhte nuk munguan protestat, por Fuqitë e Mëdha dhe Lidhja e Kombeve nuk ndikuan sa duhet ose nuk qenë në gjendje ta ndalnin këtë eksod të imponuar. Autoritetet greke vetëm në gjysmën e dytë të viteve 30, pasi kishin kryer me dhunë shumë shpronësime dhe një numër të madh shpërnguljesh, kaluan në forma më të buta. Ndoshta pati kundërthënie edhe në elitën politike greke, sikurse përmendet rasti i kreut të shtetit në vitin 1925-1926, gjeneralit Pangalos me origjinë arianite. Që nga kjo kohë autoritetet greke vepruan më tepër duke nxitur përmes propagandës sistematike dhe kredive, blerjen e pronave të shqiptarëve edhe në ato vise të Çamërisë si Paramithia, Gumenica, Margëlliçi etj., ku kompaktësia dhe qëndresa këmbëngulëse e popullsisë shqiptare i kishte

penguar të realizonin projektet e hershme për të finalizuar me një goditje të shpejtë shkombëtarizimin dhe asimilimin e vendit.

Në shpejtimin e procesit të shpronësimit dhe shpërnguljes së shqiptarëve myslimanë nga vendbanimet e tyre të lashta, pa dyshim, luajtën rol dhe kolonët grekë të ardhur gjithë mllef nga Azia e Vogël, ku kishin humbur pronat e tyre. Autoritetet greke qëllimisht i instaluan ata jo vetëm në vendet nga u larguan turqit, por edhe në viset shqiptare, në shtëpitë dhe pronat e shqiptarëve myslimanë, për të nxitur konflikte dhe për të mos u lënë atyre tjetër alternativë përveç shpërnguljes. Është domethënë fakti se 12 500 refugjatët e parë grekë të ardhur u instaluan në tokat nga po shpërngulehin shqiptarët. Sikurse regjimi i Beogradit në Kosovë etj. edhe ai i Athinës, me çdo mjet i denigroi e bojkotoi ekonomikisht shqiptarët myslimanë, madje i terrorizoi ata me gjithfarë mënyrash legale e ilegale për t'ua bërë sa më të vështirë jetën e për t'u ngulitur psikozën e shpërnguljes. Përsa i përket shqiptarëve të krishterë ata nuk u prekën shumë. Ndaj tyre u ndoq politika e prishjes së lidhjeve kombëtare, asimilimit kulturor dhe nxitjes me çdo mjet të urrejtjes fetare.

Pas Luftës së Dytë Botërore arma ekonomike është përdorur sërish kundër shqiptarëve. Qarqe të caktuara drejtuese të Beogradit dhe Athinës duke huajtur nga paraardhësit arsenalin e mjeteve dhe metodave të sprovuara të spastrimit etnik i përshtatën ato armë sipas kushteve të reja. Në Jugosllavi fillimisht u bënë përpjekje për të ripërtëritur në trevat shqiptare rezultatet agrare kolonizuese e Karageorgjeviçëve.

Fshatarët shqiptarë nuk iu njohën shitblerjet e tokës të kryera gjatë luftës, madje i detyruan të ndërtonin dhe kompletonin me orendi shtëpitë e kolonëve të dëmtuara gjatë viteve të luftës (1941-1944), t'i furnizonin familjet e këtyre me sasi të mëdha produktesh ushqimore, që arrinin në mijëra tonë. Fshatarëve shqiptarë iu rekuizuan gjithashtu edhe mijëra tonë drithë për nevojat e forcave të mëdha ushtarake të dislokuara në viset shqiptare, të cilat vetëm në Kosovë kishin një efektiv prej 40 mijë vetësh.

Përsa i përket Greqisë, aty në vitet 1944-1945, nëpërmjet bandave shoviniste të Napolon Zervës, me zjarr e me hekur, u shpërngulën 25 mijë shqiptarët e fundit myslimanë të Çamërisë. Për të shpëtuar nga vdekja e sigurt ata u detyruan të lënë pronat e pasuritë e të braktisin me dhimbje vatrën amtare dhe të shpërndahen në krahina të ndryshme në brendësi të shtetit shqiptar nga Konispoli, Saranda, Delvina, Berati, Vlora, Fieri e Lushnja, deri në Kavajë, Durrës, Elbasan, Tiranë e gjetiu.

Shqiptarët në Jugosllavi u goditën ekonomikisht edhe në mesin e viteve 50, gjatë aksionit famëkeq të mbledhjes së armëve, pësuan humbje të mëdha materiale edhe gjatë procesit të shpërnguljeve masive me dhunë, që zgjatën deri në mesin e viteve 60 duke përfshirë disa qindra mijë vetë. (Mund të dokumentohet se që nga viti 1877-1878 e deri në vitin 1966 nga Kosova dhe viset e tjera shqiptare në Jugosllavi janë detyruar të shpërngulen reth 1 milion shqiptarë).

Por humbjen më të rëndë ua shkaktoi shqiptarëve politika zyrtare konstante e lënies së qëllimtë të Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi në prapambetje ekonomike. Investimet gjithnjë të pamjaftueshme, struktura e papërshtatshme e tyre, ngarkesa e madhe me borxhe si dhe dispariteti i imponuar i çmimeve në marrëdhëniet tregtare, përcaktuan dyfishimin e prapambetjes relative të Kosovës në treguesit kryesorë ekonomikë në raport me mesataren federative. Shpërbërja e Jugosllavisë Federative e gjeti Kosovën me ato degë të ekonomisë, të cilat nuk i siguronin as rentabilitetin e nevojshëm, as zënien me punë të forcave të lira. Kurse viti 1919 e gjeti ekonominë e Kosovës në asfiksi të plotë, të vjedhur e shkatërruar, me një dëm të pallogaritur në afro 20 miliard dollarë, dhe me një popullsi aktive 90% të papunë.

Ndërkohë, gjatë viteve të Pasluftës së Dytë Botërore në Greqi, pasi ishte eliminuar gati tërësisht popullsia shqiptare myslimane, për popullsinë shqiptare të krishtere vazhdoi politika e mosnjohjes së identitetit kombëtar dhe e asimilimit të plotë. Viset e tyre u lanë nën nivelin e zhvillimit të viseve të tjera të shtetit.

Përsa i përket popullsisë myslimane të shpërngulur veçanërisht asaj çame të vendosur në Shqipëri, edhe pasi ranë barrierat e Luftës së Ftohtë dhe u përmirësuan marrëdhëniet zyrtare midis dy shteteve, Shqipërisë dhe Greqisë, ende s'është bërë asgjë për njohjen e të drejtës së rikthimit në vatrën amtare të rizotërimit të pronave dhe të njohjes e respektimit të gjithë atyre të drejtave, të pranuar për minoritetet në kartët ndërkombëtare, të cilat minoriteti grek në Shqipëri nuk i ka patur të pakta.

Bashkimi European, anëtare e së cilës është edhe Greqia, e ku natyrisht aspiron të anëtarësohet edhe Shqipëria, për t'u zhvilluar në rrugën e përcaktuar të integritit, nuk mund të pajtohet e as të lerë të pakorrigjuara pasojat e politikave të tejkaluara shoviniste, që dhunonin komunitetet e ndryshme etnike, të drejtat dhe pronën e tyre të shenjtë. Çatia e përbashkët europiane nuk ka alternativë përveçse korrigjimin e atyre padrejtësive



PARTIA PËR DREJTËSI DHE INTEGRIM

Të nderuar organizator dhe pjesëmarrës të kësaj konference të nderuar, desha t'ju përgëzoj për këtë inisiativë shumë domethënëse, të cilën personalisht, dua ta konsideroj shpresëdhënëse për komunitetin e mrekullueshëm dhe historikisht paqësor Çam.

Në fakt, duke vënë re se pjesëmarrja, në pikëpamjen shkencore dhe politike është shumë dimenisonale, dua të theksoj se Partia për Drejtësi dhe Integrim ka mbështetur dhe mbështet të gjitha inisiativat social-politike në favor të zgjidhjes demokratike të problemit Çam, i mbetur pezull që nga fundi i Luftës së Dytë Botërore midis Greqisë dhe Shqipërisë dhe, ndaj jemi këtu me Ju së bashku.

Por, duke nënvizuar faktin se organizatat si vetë Instituti i Studimeve për Çamërinë, Shoqëria Atdhetare Çamëria, të cilat janë organizma të ideuar dhe ndërtuar nga vetë komuniteti Çam, përbëjnë përparësi për programin dhe inisiativat e PDI-së, në të gjitha takimet ndërkombëtare të cilat ne kemi mundur të realizojmë deri tani në Strasburg dhe Bruksel, i jemi referuar edhe asaj që ka Ju keni mundur të bëni dhe synoni të realizoni për komunitetin paqedashës Çam.

Duke theksuar se jam këtu për t`Ju përshëndetur dhe dëgjuar atë ç`ka Ju do të referoni, dua t`Ju bëjë me dije se në filozofinë e Partisë që unë drejtoj, mbizotëron koncepti politik: e shkuara nuk duhet harruar, por duhet parë domosdoshmërisht me sytë a së ardhmes së përbashkët Europiane; të cilin jam i sigurt se në forma të ndryshme do ta gjej të analizuar edhe në referimet tuaja.

Në takimet e Strasburgut, Brukselit, me Kryetaren e Delegacionit për Europën Jug-Lindore të Parlamentit Europian, Doris Pack, me Baroneshën Sara Ludford, e cila është edhe anëtare e dhomës së Lordëve ne Angli, Ministrën italiane për Politikat Komunitare, znj Emma Bonino, Eurodeputetët Italianë Marco Pannella dhe Marco Cappato, me erudeputeten Gisele Callenbach dhe shumë të tjerë, ne kemi informuar se kjo filozofi e jona politike, mbizotëron edhe në komunitetin Çam dhe padyshim edhe në Organizatat përfaqësuese të tij.

Në fakt të gjithë bashkëbiseduesit tanë ndërkombëtarë të deri tanishëm, kanë përgëzuar faktin se popullsia Çame nuk kërkon rivendikim terriroresh, por vetëm respektimin e Standarteve Ndërkombëtare, pra kthimin e shtetësisë Greke të hequr në mënyrë kolektive dhe pa vullnet individual, dhe gjithashtu edhe rifitimin e të drejtave të patjetërsueshme të pronës, gjuhës dhe kulturës.

Ne si parti politike, duke qenë të qartë se opsioni klasik bilateral i zgjidhjes së këtij impassi me bisedime dypaleshe është i pamundur për shkak të pamundësisë që Shqipëria dhe Greqia të jenë të barabartë në një dialog të mundshëm për këtë çështje, kemi kërkuar në vazhdimësi ndërmjetësimin e Faktorit Ndërkombëtare, dhe ndërsa ishim në Bruksel me këtë optikë diskutuam me zotin Marino Busdachin, Sekretar i Përgjithshëm i Organizatës për Popullsitë e pa Përfaqësuar pranë Selisë së Kombeve të Bashkura në Gjenevë, mundësinë që njëra nga organizatat me bazë komunitetin Çam të bëhej pjesë e kësaj organizate për të shfrytëzuar sa më mirë edhe hapësirat e Kombeve të Bashkura në lidhje me zgjidhjen e çështjes Çame.

Duke i uruar punime të mbara kësaj konference shkencore, desha t'ju them se ashtu si bashkëpunimi i Institutit me personalitete të Shkencës dhe Politikës është absolutisht i nevojshëm, edhe bashkëpunimi ynë i përbashkët institucional dhe shumë planësh është i domosdoshëm për zgjidhjen përfundimtare të këtij problemi historik dhe politik.

Faleminderit,

Tahir Muhedini,

Kryetar i PDI-së

Partia për Drejtësi dhe Integrim, PDI

POTENCIALET EKONOMIKE TË ÇAMËRISË

- Çamët janë për bashkëjetesë dhe prosperitet. Problemet e kaluara ti trajtojnë historia, ata sot kërkojnë të gëzojnë liritë e kohës dhe të drejtat universale.

Dr.As Prof Iljaz MEHMETI

- Përcaktimi i zhvillimit ekonomik-shoqëror të çdo territory ose zone të banuar është një punë që kërkon korelimin e shumë faktorëve dhe ndërthurjen e mjaft të panjohurave, që merren në konsideratë dhe shtrohen për zgjidhje në hapësirë dhe në kohë. Konteksi njerëzor, kulturor dhe pozicioni dominues politik gjithmon përbën hapin e masave stimuluese ose frenuese në arritjen e objektivave për prosperitet, mirëqenie dhe progress në tërë sferat e jetës.

Paraqitja e temës, ka qenë aqë sa e vështirë, por edhe e ndërthurur me faktorë të pa njohur. Synoam në pozimin e një potenciali ekonomikë sa më afër realitetit, nisur nga koncepti i territorit, nga mundësitë që krijon ky territory, gjithmon fenomenet të trajtuara nga ndërthurja e zhvillimit të zonës.

Çamëria, nga pozicioni territorial është një perle e vërtetë, me resurse të jashtëzakonshme, me një mjedis të virgjër, me parametra klimaterik të favorshëm për jetesë e turizëm, me gërshetim të ultësirave bregdetare dhe ato malore, me mjaft vende historike me një vijë bregdetare të madhe. Referim mundet të shfaqet si ëndërr, por erërat e Europës dhe ndihma e vendit të Lirisë për popujt e botës, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, krahas zgjidhjeve që po bën për padrejtësi historike të kohës, njëherazi po afron shanse që edhe kjo çështje të zgjidhet dhe që popullsia e kësaj treve e shpërndarë nëpër Shqipëri të zgjidhë të drejtat e saj. Është më e mirë të të dy popujve, të atyre Grek dhe Çam që të bashkëtojnë dhe t'ja lenë historisë trajtimin e saktë të së kaluarës duke gjetur atë pik kontakti për një bashkëjetesë si shumë zona të Evropës që kanë pasur probleme të tilla dhe i kanë zgjidhur dhe që të bredhurit në shkretëtirë të arrijnë të gëzojnë trojet e bregdetit e çdo gjëje të eterve të tyre, të atyre njerëzve që kanë shumë vite që ëndërrojnë, që kurrë nuk e kanë sharë vendin e tyre të bukur e gjithmon kanë motivuar pozitivisht kohën e jetesës në harmoni me grekët.

Këndvështrimi ekonomik i zhvillimit të krahinës së Çamërisë trajtohet në këndvështrimin makro, si një problem që e kërkon një trajtim të tillë dhe që çdo aspect është parë me metodën e trajtimit në distancë të potencialeve zhvilluese ekonomike. Kuptohet, që pyetjet

që mundet të shtrohen janë aq të shumta dhe me aq shume variante përgjigjeje sa po i abstragojmë duke synuar nga larg në kohë, hapsirë të jemi sa më shumë realiztë në vlerësime. Nga ana profesionale prognozimi i potencialeve ekonomike të çdo territori nisët nga programi politik i regjimeve që drejtojnë territorin, nga situatë gjeopolitike e zonës, nga koha kur kryhet prognozimi dhe motivet që e shtyjnë një brez njerëzish të ëndërrojë për prosperitet. Edhe pse ne kemi vetëm një faktor në dorën tonë, atë të shprehjes së dëshirës për prosperitet të brezave që rrojnë të popullsisë çame, të përcjelljes së realitetit të fatit të tyre në kujtesën e të rinjve. Në se kjo çështje nuk trajtohet me objektivitet nga politika aktuale sot, koha jo e gjatë e futjes së Shqipërisë në familjen e madhe Europiane besoi se këtë çështje do ta zgjidhë institucionalisht. Pikërisht ky moment nuk pritët të bëhet vetë, por politikan të mençur i japin zgjidhje, që çështjet të bëhen sa më të plota e në varjantët më të mira të pranuar nga të dy palët. Prandaj në këtë moment kjo temë do ishte në terrem tjetër dhe do të kishte një vërtetësi reale e jo potenciale. Por edhe sot mendojmë e përbën vision të shikimit të kohës.

Kush ka jetuar në Tiranë që nga 1944 ose pak më von, pas viteve 60 dhe ballafaqon zhvillimin e Tiranës të periferisë deri në Durrës, Fushë- Krujë e deri në Kavajë, shikon në vitin 2007 një përqëndrim të pjesës më të madhe të Shqiptarëve në këtë zonë. Dhe ky përqëndrim është vetëm i shtyrë nga ana ekonomike dhe lirive që hapi ekonomia e tregut në Shqipëri. Po ky fenomen, mendoi ka ndodhur edhe në popullsinë Greke, duke u vendosur kryesisht në Athinë, Pire, Selanik dhe ndonjë qytet tjetër të madh. Pra, nga sa kemi parë, në Greqi, jo vetëm zona të Çamërisë, por edhe zona të tëra në atë shtet që nuk janë zhvilluar njëllëj si në zonat e lartpërmendura. Pra, ekonomia e tregut, detyron politikën vendimarrëse të orientojë shpërndarjen e fondeve, për rrjedhojë edhe tema që ne trajtojmë, ka parasysh këtë gjendje.

Në tërësinë e masave çështja çame ka ende shumë gjëra për tu zgjidhur. Në variantin e zgjidhjes politike të lirisë në të drejtën universale të njeriut për të jetuar e gëzuar çdo gjë të etërve, vjen zinxhiri i pa shkëputur i masave si:

- Zgjidhjen e problemit të pronave, çështje që është themeli i çdo iniciative dhe i çdo hapi për atë që mendon dhe vepron të investojë në një territor të caktuar. Ky faktor është aktualisht negativ për çështjen dhe kërkon një trajtim ligjor European për tu zgjidhur pa krijuar probleme të reja në këtë çështje midis brezave të kohës së tanishme, probleme midis vetë çamëve me njëri tjetrin dhe të çamëve me popullsi Greke që jeton aktualisht në këto troje, për të patur të nesërmen çdo zhvillim të qëndrueshëm e të pa kontestueshëm.

- Vetë popullsia çame duhet të qartësohet me vetëveten që në momentin e dhënies të asaj që i është mohuar, meqenëse janë gati dy tre breza njerëzish të larguar nga faktori jetësor, të gjejnë mirkuptimin me njëri tjetrin e jot ë fillojnë pretendimet, që edhe ligjërisht nuk i zgjidhin dot.

- Zhvillimi i zonës do trajtohet në këndvështrimin e njohjes së situatës konkrete të arritjeve të kohës, për të ndikuar fuqishëm në një kërkesë dhe radordim sa më të mirë të këtij zhvillimi me programet e zhvillimit që ka Qeveria Greke. Pikërisht ky moment është mjaft delikat dhe kërkon një urtësi të komunitetit Çam, duke ju shmangur tendencave të pushtetit, për t'ju përshtatur tendencave të interesave të komunitetit. Aq e vërtet është kjo sa që pa një gërshetim të faktorëve individ- territory dhe investitor çdo gjë që mundet të thuhet ose që kërkohet të arrihet mbetet vetëm dëshirë në çdo rast.

- Zona ka aq njerëz të shkolluar sot, sa që janë në gjendje intelektuale dhe ekonomike të orientohen saktë në zgjedhjen e mundësive investuese efektive.

Disa nga potencialet ekonomike të kësaj treve janë :

- Potencialet për turizëm .
- Vija e madhe bregdetare dhe e pa ndotur
- Kushtet e mira klimaterike për jetesë dhe për zhvillim
- Ekzistenca e materialeve ndërtimore si gurë, inerte, etj.
- Infrastrukturë përgjithësisht e ngritur, por jo e përmasave që kërkon Europa.
- Dëshirën e një brezi populatë që kurrë nuk e ka harruar vendlindjen e prindërve. Vitaliteti i madhi popullsisë çame, aftësitë e saj të jetojë në harmoni me komunitetet në gjithë shqipërinë edhe pse erdhi këtu me leckat e trupit.
- Pozicioni i vendosjes midis shteteve , Shqipërisë dhe Greqisë, ndërthurja me pozicionin e monoritarëve, gjë që të dy shtetet do jenë të interesuar që të ndihmojnë për të patur programe zhvillimi në këtë zonë.

-Munde të ishin evidentuar edhe me dhjetëra faktorë potencial të zonës, por rëndësi merr jo vetëm fakti i pozimit , por edhe vënia në dukje për publikun, për investitorët, për pushtetarët që këto mundësi të zënë një vend në programet afatgjatë të qeverive që ti hapin mundësi rrjedhjes së kapitalit për ti vënë sot si mundësi do bëhet ralitet dhe lumë brezat që do e shijojnë. Në këtë aspect rol të jashtëzakonshëm ka edhe Qeveria Shqiptare që me zgjatjen e akseve rrugore në vijën bregdetare dhe zhvillimin e programuar të një turizmi në zonën e Sarandës deri në Konispol dhe për tërë zonën përreth, do bënte një mbështetje të jashtëzakonshme edhe zhvillimit më të madh e më të shpejtë edhe të pjesëve jugore të tyre. Nga ana tjetër në tavolinat e Evropës atje ku shikohen politikat zhvilluese

territoriale, është po shteti Shqiptar që të kërkojë zhvillimin harmonik, të shpejtë dhe të nxisë e të mbështet në çdo rast shtetin Grek në kërkesat për zhvillimin e territorit të Çamërisë me infrastrukturë të kohës, për ta bërë këtë zonë akoma më kërkuese për turistët dhe turizmin e të gjithë llojeve. Kjo mbështetje ti jepet edhe tani që çështja ende nuk është zgjidhur. Pikërisht këto trajtime që deri më sot nuk kanë qenë në axhendën e punës së shtetit Shqiptar janë kërkesë e kohës, jo vetëm për plotësimin e të drejtës së një populli, por nga ky koncept janë të fituar të dy popujt, që midis tyre rritet fluksi i njerëzve dhe i kapitaleve sa më lirshëm dhe me të njëjtën interes fitimi. Asnjë investitor nuk do rrishte në shekullin 21 të hidhte kapitale në një zonë të varfër, të pa zhvilluar dhe me pak fitime. Intelektualët e kësaj zone duhet të jenë aktiv ndaj qeverisjes lokale e qendrore Shqiptare që këto çështje të zënë një vend në prognozën dhe planet e tyre, duke u larguar nga retorika boshe dhe mos e ngacmo se gjërat “prishen”. Sot gjërat që janë progress për popujt gjithmonë thuhet, trajtohen dhe zgjidhen, që të mos ketë asnjë problem që sjell vonim të progresit. Kjo gjë aq e më shumë duhet bërë për një popullsi si ajo çame s’ka lënë punë pa bërë në Shqipëri, të një popullsie që është paqësore dhe di të jetojë pa eksese në komunitet dhe të një popullsie që sot është nga disa matje në nivel ekonomik mbi mesataren e popullit shqiptar, të një populli që politika i ka bërë të madh dhe që nga momentet më kulmore të këtij vendi nga statistikat e këtij shteti ka më pak se 100 banorë të dënuar me burgje pas vitit 1990 dhe kokrra njerëzve të ngatërruar me fenomenet e 1997 dhe ku prosperitetin e ka mbështetur te puna. Popullsia çame ka njerëz të shkolluar që janë në gjendje të gjejë rrugën më të drejtë për ndërthurjen e zhvillimit të territorit. Kuptohet që zhvillimi i zonës do shoqëruar edhe me garancitë e investimeve të mundshme që të mundet të arrijnë jo vetëm fitimi nga investimi, por edhe garancia e vendosjes së pronës, mundësia e hipotekimit dhe e kreditimit që ti sjellë zonës zhvillim të shpejtë. Do ishim të gabuar të trajtonim në këtë temë gjëra të micros dhe të mënyrës së jetesës së popullsisë në këtë zonë, por në këndvështrimin European, gjë që refugjatët shqiptar e dinë më mirë këtë gjë, që popullsia çame nuk besoi se do e ndërtonte jetën duke u përqëndruar vetëm në bujqësi e blegtori, por do të synonte në ngritjen e një infrastrukture turistike që e mbështetur nga zhvillimi i degëve të tjera do ti jepte një hop të pa parë jo vetëm zhvillimit të zonës, por edhe të zonave për rreth.

Çdo vlerësim potencialesh gjithmonë ka edhe një prognoze të fondeve të nevojshme për të arritur parametrat jetësor dhe ekonomik të zhvillimit. Kështu duke u nisur nga sipërfaqja e zonës, nga terreni dhe pozicioni gjeografik, nga popullsia ka një faturë financiare të vlerësuar në 3-4 miliard Euro, që kjo zonë të kthehet e barabartë siç do zonë e ngjashme në Europë. Në këndvështrimin e sigurisë së

fondeve mendoj se shteti grek është në gjendje të ndikojë në financim qoftë drejtpërdrejtë dhe me fondet e komunitetit çam do ndikojë në arritjen e investimeve ekonomike. Garanci do jetë edhe kreditimi i mundshëm i biznesit mbështetur në pronat e paluejtshme.

Zhvillimi presupozon një harmoni jetësore midis dy popujve me fe të ndryshme që në të kaluarën ka qenë pa probleme dhe marrëzitë e shekullit të kaluar të mos përsëriten më. Besoj se edhe përfaqësuesit e fesë Greke në Shqipëri e kanë ndjerë që brezat e rinjë të popullsisë çame janë tolerant, të kulturuar, janë për miqësi, për harmoni dhe bashkjetesë pa asnjë pengesë me popullsinë ortodokse, fenë e tyre dhe çdo besim tjetër fetar. Dhe kjo është gjë aq sa fisnike dhe njerëzore, që shpejton çdo zgjidhje për të dy palët.

Këto probleme, të ligjshme, nuk realizohen po një system ligjesh dhe mbështetje të pushtetit. Mbi të gjitha, zhvillimi i një territory që banohet dhe që është orientuar me një concept zhbillimi është i vështirë të realizohet me interesa të një grupi tjetër njerëzish, duke u orjentuar në interesa të tjera. Ndaj mbetet domosdoshmëri që prognoza e zhvillimit të zonës, të bëhet pasi të jenë zgjidhur problemet me shtetin Grek. Ky problem mundet ti besohet studjove më të mira që ka në botë të specjaluara në zhvillimin mikro dhe makro, duke e ndërthurur me interesat e bankat që investimet jo vetëm të vetëshlyhen shpejt, por edhe ti rezistojnë kohës, gjë që shkurtojnë kohën e arritjes së prosperitetit dhe të ëndërrave të njerëzve.

Trajtimi i këtij problemi është i vështirë, ndaj kërkon, mirëkuptim midis dy shteteve, popullsisë së interesuar. Njerëz të profesioneve e brezave të ndryshëm, ose politikan mundet të kenë mendime të tjera, kjo paraqitje është vetëm një variant. Ju faleminderit.

Tiranë, dhjetor 2006

Tiranë, më 21.12.2006

Dr. Rustem GJATA

Çështja Çame është çështje mbarëkombëtare

Çamëria si krahina më jugore shqiptare, e banuar që nga lashtësia nga popullsia ilire e pasardhësit e saj shqiptarët, ka qenë kurdoherë pjesë e një tërësie unike kombëtare e territoriale shqiptare. Këtë e dëshmojnë faktet e panumërta historike deri në ditët tona. Fati i popullsisë së Çamërisë ka qënë i pandashëm nga fati i Popullsisë së krahinave të tjera shqiptare. Mirëpo me vendim të Konferencës së Ambasadorëve Çamëria i kaloi shtetit grek. Që nga kjo kohë qeveritë greke e diskriminuan sistematikisht popullsinë shqiptare muslimane kryesisht në Turqi, vetëm pse ishin pjesëtare të një kombi e të një feje tjetër, të ndryshme nga kombësia e feja zyrtare greke.

Popullsia shqiptare çame përbënte pakicë kombëtare në shtetin grek. Çështja e mbrojtjes së pakicave u shtrua në konferencën e Bukureshtit në vitin 1913, pas zgjerimeve territoriale që sollën luftrat ballkanike kryesisht mbi trojet shqiptare, sidomos nga Serbia, Greqia e Mali i Zi. Mirëpo këto shtete kanë bërë të kundërtën, me synimin e krijimit të shtetit homogjen, të përbërë prej një kombi të vetëm dhe feje të vetme ortodokse. Edhe pas marrëveshjeve të paqes në vitet 1919-1920, në Ballkan SKS dhe Greqia kanë kundërshtuar me vendosmëri marrjen përsipër të mbrojtjes së të drejtave të minoriteteve e ka ushtruar Këshilli i Lidhjes së kombeve, të cilit mund t'i drejtoheshin përfaqësues të minoriteteve me anë të peticioneve, gjë që përbënte një shenjë të subjektivitetit ndërkombëtar, ndërsa kompetenca e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ju njoh Gjykatës ndërkombëtare të drejtësisë. Madje aktet ndërkombëtare për mbrojtjen e pakicave formalisht kishin përparësi ndaj normave juridike të brendshme. Mirëpo ato dispozita në fakt ishin për shtete si Greqia e SKS, ishin inekzistente. Këto shtete as donin tia dinin për normat ndërkombëtare lidhur me pakicat dhe ndërmerrnin edhe masa dratike kundër tyre.

Në fund të Luftës së Dytë Botërore terrori e shtypja nuk njohën kufi, duke arritur deri në dëbimin me dhunë të mijra familjeve shqiptare të besimit musliman nga trojet e tyre. Ky ishte një krim tipik kundër njerëzimit, i cili jo vetëm nuk u ndëshkua asnjëherë, por u kalua në heshtje nga qarqet ndërkombëtare. Kështu, krejt jasht vullnetit të tyre shqiptarët e Çamërisë u vendosën si të shpërngulur në territorin e shtetit shqiptar. Ky ishte një veprim i vetë qeverisë greke, e organizuar dhe e drejtuar prej saj. Nuk është i saktë dhe real opinioni i hershëm zyrtar i ruajtur deri më sot se dëbimi i shqiptarëve nga

Çamëria u bë nga qarqe të caktuara reaksionare greke. Po të ishte ashtu dhe shteti grek të ishte dorëjashtë, do të lindte natyrshëm pyetja: përse shteti i sotëm grek nuk mban qëndrim të kundërt nuk e dënon këtë krim të shëmtuar dhe çështje më e keqja nuk lejon kthimin e tyre në trojet e veta, pa folur këtu për shpërblimin e dëmit të shkaktuar.

Shqiptarët e Çamërisë ishin shtetas grek, ashtu sit ë gjithë qytetarët e tjerë të kombësisë greke. Dalloni prej tyre vetëm nga kombësia dhe përkatësia fetare. Dëbimi i tyre nuk mbështetet nga asnjë akt apo marrëveshje ndërkombëtare. Përkundrazi, në një sërë aktesh ndërkombëtare garantohet mbrojtja e shtetasve pa dallim kombësie e feje nga veprimet arbitrare që cënojnë të drejtat dhe liritë themelore të tyre, siç janë Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Pakti ndërkombëtar lidhur me të drejtat civile e politike, Konventa Evropiane Për të Drejtat e Njeriut e Liritë Themelore, etj. Më konkretisht në Protokollin 4 të Konventës Evropiane për të drejtat e Njeriut, garantohet mbrojtja e shtetasve kundër dëbimit nga territori i shtetit të vet. Kështu në nenin 3.1 sanksionohet: “ Askush nuk mund të dëbohet me anë masash individuale ose kolektive nga territori i shtetit, shtetasi i të cilit është , ndërsa në pikën 2 të këtij neni është garantuar e drejta e hyrjes në territorin e shtetit që i përket si shtetas. Për të shmangur çdo dyshim po citojmë: pikën 2 të nenit 3: “Askujt nuk mund t’i hiqet e drejta të hyjë në territorin e shtetit shtetas i të cilit është”. Çështja themelore që mendoj se duhet të shtrohet lidhur me dëbimin me dhunë e popullsisë çame nga shteti grek është: A përbën një veprë kriminale kundër njerëzimit? Në qoftë se nuk do të quhej e tillë atëherë vëmë në dyshim të gjitha të drejtat e tjera të kësaj popullsie që rrjedhin prej saj. Prandaj nuk mund të pajtohem me disa pikpamje që e kufizojë kërkimin e së drejtës së tyre vetëm në kërkimin ose dëmshpërblimin e pronave të uzurpuara, pasi ky uzurpim është vetëm pasojë e dëbimit të dhunshëm shtetëror. Heshtja për dëbimin me dhunë nga shteti grek i asaj kohe do të ishte një deskreditim i vetë çështjes çame si çështje e jonë mbarë kombëtare dhe justifikim në një farë mënyre e kësaj veprë makabre. Këtu nuk shtrohet çështja e dënimit fizik të disa individëve që kryen masakrat, apo urdhëruan dhe zbatuan urdhërin e dëbimit, pasi kjo praktikisht sot është e pamundur objektivisht dhe mbi të gjitha nuk përbën qëllimin themelor të popullsisë çame. Çështja shtrohet që shteti grek të detyrohet të pranojë botërisht dhe me vepra të kërkojë ndjesë për këtë krim të kryer, duke pranuar dhe njohur të drejtën e të dëbuarve dhe pasardhësve të tyre për t’u kthyer në vatrat e veta dhe mbi këtë bazë kthimin e të gjithave pronave e shpërblimin e të gjitha dëmeve të pësuar.

Shteti grek nuk ka e nuk mund të ketë bazë justifikimi as politikisht e as juridikisht. Dëbimi me dhunë është një nga mënyrat e kryerjes së krimit kundër njerëzimit. Ky krim nuk parashkruhet dhe me akte ndërkombëtare është sanksionuar zbatimi i dispozitave penale me fuqi prapavepruese. Prandaj nuk mund të bëhet fjalë për kalimin e kohës

së gjatë . Po ashtu nuk ka rëndësi numri i madh apo më i vogël i popullsisë së dëbuar, por ana subjektive e veprës kriminale. Shteti grek i dëboi të gjithë shqiptarët çamë që i përkisnin fesë muslimane , pa bërë asnjë dallim dhe gjithë sa ishin.

Së fundi nuk mund të mos sugjeroj nevojën e organizimit në një shkallë më të lartë dhe të zhvillimit të një veprimtarie më të ngjeshur e të zhdërvjellët e organizatës atdhetare “ Çamëria” në radhë të parë, nevojën e sensibilizimit politik në vend e sidomos të shteteve të fuqishme si SHBA-ve e të vendeve evropiane, në mënyrë të vazhdueshme. E drejta është me ne , me popullsinë çame, prandaj të shfrytzohen të gjitha mundësitë për të arritur qëllimin e synuar. Për këtë çështje kombëtare kërkohet të angazhohen të gjithë pa përjashtim , pavarësisht nga pikëpamjet e rymat politike, pasi politika e interesi kombëtar është mbi çdo politikë e interes tjetër.

HAJREDIN ISUFI

**MARRËDHËNIET MIQËSORE MES MYSLIMANËVE E TË
KRISHTERËVE NË ÇAMËRI.**

Bashkëjetesa dhe harmonia vallazërore mes dy komuniteteve në Çamëri është aq e hershme, sa historia e tyre. Këto lidhje shprehin kombësinë, lidhjet e gjakut, gjuhën doket, zakonet e përbashkëta si dhe tolerancën fetare. Dasi të fetare asnjëherë nuk u bënë pengesë tek shqiptarët myslimanë që të jenë në krah të krishterëve në ditë të mira dhe anasjelltas. Kjo dukuri gjen shprehjen e vet në shumë burime historike.

Lidhjet e para, që dëshmojnë në aleancë të bejlerëve të Çamërisë dhe kapedanëve të Sulit kundër Ali Pashë Tepelenës, datojnë në pranverën e vitit 1790¹. Ali Pasha bëri shumë përpjekje për ti shkëputur bejlerët myslimanë shqiptarë nga të krishterët e “ pabindur” të Sulit, duke premtuar se shpartallimi i suliotëve do t'i çlironte edhe bejlerët çamë nga trazirat që u sillnin suliotët pronarëve çamë të Margëllëçit dhe të Paramithisë.

Bejlerët e Paramithisë, të Luaratit, të Margëllëçit e të krahinave të tjera të Çamërisë e refuzuan kërkesën e Ali Pashës, dhe kjo bëri që ai të mos e ndërmerre ekspeditën që kishte planifikuar të nënshtrohte Sulin dhe suliotët trima. Shtatë vjet më vonë, në vitin 1799, ai vendosi ti kthehej Sulit për të larë me ta njëherë e përgjithmonë armiqtë e vjetra. Në këtë ndërmarrje, Ali Pasha iu drejtua edhe një herë për aleancë bejlerëve të Çamërisë: Pronjatëve dhe Çaparenjve, Daljanenjve të Konispolit, Dematëve dhe Sejkatëve të Filatit, Ruseve të Margëllëçit³ etj.

Bejlerët çamë, përballë presioneve dhe forcës së Ali Pashës, kundër vullnetit të tyre, rreshtuan forcat me ato të Ali Pashës. Suliotët ishin jo vetëm në numër, por kishin dhe mungesa të mëdha në ushqime dhe armatime. Në këto rrethana të vështira kapedanët e Sulit, që njihnin mirë besnikërinë e çamëve myslimanë dhe rrethanat që ishin ndodhur për krah Ali Pashës, nuk e pengoi parinë suiote që të merreshin vesh me bejlerët çamë, për tu hapur rrugë të lirë në zonën e frzarit dhe për t'u furnizuar me municion e rezerva ushqimore nga Parganjotët. Çamët u dhanë përgjigje positive suliotëve si dhe shprehën gadishmërinë e tyre për ti ndihmuar dhe u dërguan lajm se nuk do t'i ngrenin armët kurrë kundër tyre.

1. Pouqueville, Voyage dela Grece, Vëll. III, faq.192

2. Po aty, faq.197

3. Enciklopedia e madhe Greke “ Pirsos”, Vëll III, faq. 741-742.

Suliotët megjithse të gjitha shtigjet që hynin e dilnin në Sul i kishin të rrethuar nga forcat e Aliut, arritën të siguronin të gjitha mjetet e nevojshme në Pargë dhe ti kalonin pa asnjë vështirësi në zonën e Çamërisë drejt Sulit.

Veziri plak, sapo mësoi për lëvizjet e suljotëve, fajësoi çamët dhe bëri presione të forta mbi ta, duke arrestuar disa nga figurat e shquara të Margëllëcit. Viktima e parë u bë Balo Huso. Ai izolohet në burgjet e kështjellës së Janinës, nën një mbikqyrje të rreptë.

Ali Pasha si moment më të përshtatshëm për të nisur goditjen kundër sulit, zgjodhi verën e vitit 1800; Pashai i Janinës, me anën e presioneve, kishte arritur të mobilizonte edhe këtë rradhë bejlerët e Çamërisë në këtë ekspeditë kundër Sulit.⁴

Çamët, siç dëshmon edhe rapsodi e Ali Pashës në atë kohë, Haxhi Shehreti, u bashkuan me forcat e Ali Pashës, por kurrë nuk do t'i drejtonin armët e tyre kundër suliotëve:

“ Rrinë përtej menduar çamët, të shkasin, të dredhojnë
Pa bërë bam, të çajnë rrethimin dhe Sulin të
shpëtojnë”⁵

Në këtë ekspeditë forcat e bejlerëve të Çamërisë, ishin dislokuar në Malin e Vricahes, një mal i thepisur shkembor në veri të Sulit. Islam Pronjua, një nga bejlerët më me zë të asaj kohe në Paramithi, nga lartësitë e malit Vricahes ndiqte me kujdes të gjitha veprimet që bënte Ali Pasha për sulmin që kishte në plan të filmonte me 4000 forcat e tij kundër Sulit. Islam Pronjua, një nga bejlerët më me zë të asaj kohe në Paramithi, nga lartësitë e malit Vricahes ndiqte me kujdes të gjitha veprimet që bënte Ali Pasha për sulmin që kishte në plan të fillonte me 4000 forcat e tij kundër Sulit. Në këto rrethana dramatike Islam Pronjua me miqtë e tij çam nisi të bluante në mendjen e tij plane për të shpëtuar Sulin dhe suliotët, që edhe këtë rradhë të dështonin planet e Aliut.

Islam Pronjua vendosi t'i dërgonte një letër vëllamit të tij, Foto Xhavellës, kapedanit të Sulit, ku t'i bënte të qartë planet e Ali Pashës dhe rrezikun që u kanosej suliotëve.

4. H. Kristovasilis, Ta eroika Thainata ton Soulition kei Soulition, London, 1887, faq. 73.

5. I. Koçallari, Alipashai dafaq.165.

6. H. Kristovasilis, Ta eroikavep. përm. Faq.90.

H.Perovoi, Istorja tou Soulio, Athinë, 1932,faq.57.

Teksti i letrës është :

“ Vëllame të përshëndes !

U mblodhëm të gjithë këtu në Vricahe, ku ndodhem edhe unë me të mitë. Erdhi Veziri dhe na urdhëroi që nesër të bëjmë një sulm mbi ju. Po hapni sytë, mos humbisni. Ti je i mençur dhe nuk ke nevojë për këshillat e mia. Mendo të marrësh masa dhe në mesnatë të bëjsh një sulm, kur ushtria është në gjumë”⁶.

Foto Xhavella, sapo mori letrën e vëllamit të tij, mbodhi Shtabin Drejtues të qëndresës suliothe, hartoi pa humbur kohë, planin e veprimeve të mësymjes kundër forcave të Aliut, dhe në mesnatën e 12 qershorit 1800, sulmoi forcat e Aliut në Vricahe, ku ato ishin në gjumë të thellë. Taborët e Ali Pashës u gjetën në befasi dhe përballë sulmit të suliotëve, pësuan disfatë të plotë dhe shumë humbje.

Ali Pasha për disfatën e thellë që pësoi, fajësoi Pronjon dhe Çaparin, dhe siç e shpreh dhe bejtexhiu i oborrit të Aliut në veprën e tij voluminoze, “ Alipashaida”:

“ Shih ç,na bënë çamët nga prapa....

Po edhe unë s’do t’ua fal kurrë dhe pak po të jetoj

S’ka dyshim shpejt do t’i gjej mirë t’i “ falenderoj”

Ti, o Pronjo plak dhe ti Hasan Çapari

Që dërmuat birin tim, buzë vdekjes shkoi Myftari.

Të damkosur, ju do të jeni nëpër kohët, që do të vinë

Nuk besoj të kaloj gjatë , për një vit e gjej shtëpinë”.

Bejlerët e Çamërisë , tashmë të deklaruar hapur kundërshtarë të Ali Pashës si dhe suliotët, pas pushtimit të Sulit nga Forcat e Aliut, më dhjetor 1803, braktisën vatrat e tyre dhe nëpërmjet një kalvari vuajtjesh, ndjekjesh dhe persekutimesh nga forcat e Aliut, një pjesë shkuan për në Pargë dhe një pjesë në Lefki të Korfuzit. Në këto kushte, aleatët e vjetër dhe besnikë të njëri – tjetrit, arritën të lidhen e të komunikojnë mes tyre për probleme të përbashkëta që i shqetësonin. Burimet historike na njoftojnë se bejlerët e Çamërisë në vitin 1804 krijuan lidhje të reja me suliotët⁷, Sulejman Çapari i ftoi kapedanët e Sulit të emigruar në Pargë për një aleancë të re kundër Ali Pashës, kërkesë që u prit mirë nga paria suliothe dhe beslidhja u kurorëzua me suksesë. Ajo u nënshkrua nga krerët e parisë së Margëllëçit : Jakup aga Rusi, Deli Hasani, Balo Huso ndërsa nga kapedanët e Sulit e nënshkruan: Dhimo Dhrako, Foto Xhavella, Tushi Zerva ⁸ etj.

7. P. Arvantinoë, Hroëgraphiatis Tpeiroi. 1856,Tem A,faq.294.

8. Nik.G. Zvaglps. O andistasis kei Llambo Xhavelas, Athinë, 1964,faq.164.

Megjithë përkushtimin e të beslidhurve për të kordinuar veprimet të sukseshme kundër Aliut, përpjekjet e tyre qenë të pasukseshme dhe dështuan për shkak të epërsisë që kishte veziri i Janinës. Mes dy komuniteteve në Çamëri shkruan historiani arvanitas, Aristidh Kola, nuk kishte asnjë xhelozitet fetare, por vetëm pas vitit 1821 politika greke mbolli farën e përçarjes mes myslimanëve e të krishterëve dhe grekët kërcënonin të hanin njëri tjetrin e jo më të luftonin të vëllazëruar sundimin osman.

Megjithë propagandën që zhvillohej nga qarqe të caktuara për t'i armiqësuar të krishterët me myslimanët dhe anasjelltas, myslimanët shqiptarë të Çamërisë asnjëherë nuk i shkëputën lidhjet e tyre, as me të krishterët e Çamërisë, as me fqinjët e tyre greke. Është me interes të theksohet se familja e madhe e dinenjve të Paramithisë ka hire në historinë e Greqisë si një mbështetëse e madhe dhe në marrëdhënie të ngushta miqësore me shumë miq jo vetëm të krishterë në Çamëri, por edhe me të krishterë Helen⁹.

TË KRISHTERËT NË MBROJTJE TË MYSLIMANËVE

Historia e marrëdhënieve të çamëve myslimanë me të krishterët edhe në vitet 1940-1945 gjatë pushtimit fashist të Greqisë, duhet paragjykuar dhe vlerësuar mbi bazën e dokumentacionit të gjerë të kohës si dhe të vërtetave të pamohueshme. Është fakt i njohur se në këtë kohë çamët myslimanë dhe të krishterët u gjendën në krah të njëri-tjetrit për t'u mbrojtur nga elementët keqdashës, keqbërës dhe të pandërgjegjshëm. Masat e para të parisë së fshatrave myslimane e të krishtera filluan qysh në vitin 1939, kur Italia fashiste pushtoi Shqipërinë. Duke u mbështetur në traditën e hershme shqiptare, midis dy komuniteteve në Çamëri u krijuan beslidhje. Beslidhja e parë midis myslimanëve e të krishterëve ishte ajo që u krijua në kazanë e Margëllëçit në vitin 1940. Sipas kësaj beslidhjeje, fshatrat myslimane të Margëllëçit dhe të fshatrave të krishtera të Frarit, Shenicës, Morfatit, Livadhias, Llurit etj; do të zinin pozicione të përbashkëta mbrojtëse për të smprpsur çdo kërcënim, që do t'u vinte fshatrave të tyre. Madje pleqësia e fshatrave caktoi dhe pikat kyçe ku do të ziheshin pozicionet. Beslidhja u shtri dhe në kazanë e paramithisë dhe në atë të Filatit.

9. Shih për më shumë hollësi, H. Isufi " Çamëria, studime historike – sociologjike shek.XIII-XX, Tiranë 2006, faq. 244.

Në vitin 1940, kur qeveria greke bëri internimin e parë të parisë myslimane të Çamërisë, disa të krishterë të fshatrave të thella të Filatit, Margëllëcit, menduan se u erdhi çasti i volitshëm për të plaçkitur gjenë e placket e familjeve të pa mbrojtura çame. Në këtë kohë ishin shumë të krishterë ata që morën në mbrojtje shumë familje myslimane dhe u arrit që të mbrohej pasuria e tyre.

Paria e të krishterëve në Çamëri, e frymëzuar nga dëshira për të bashkëjetuar në harmoni dhe në një fqinjësi të mirë me minoritetin mysliman çam jo vetëm, me aq sa munda mori në mbrojtje çamët myslimanë nga elementet keqbërës, por shkoi edhe më tej. Kështu p.sh. Kristo Pituli, një përfaqësues i njërës prej familjeve më me zë të arhondëve të krishtera vllahe të Çamërisë. Ai në shenjë proteste të qeverisë së Metaxas, që kishte ndërmarrë kundër minoritetit shqiptar çam, shkoi në fshatin Grikohor, pranë miqve të tyre mysliman dhe me sa do të mundet do të dilte në mbrojtje të tyre. Ai në fshatin Grikohor pati një debat të ashpër me komandantin e Korofillaqisë, Vardhallaqin, një grek nga thellësitë e Greqisë, që kishte në Grikohor për të arrestuar parinë myslimane të fshatit dhe për ti nisur nëpër kampet e përqëndrimit.

Kristo Pituli, që kishte jetuar mes myslimanëve çam ua njihte vlerat, prandaj e revoltuan së tepërmi veprimet që kishte ndërmarrë qeveria fashiste e Metaxas dhe zbatuesi i verbër, Vardhallaqis. Kristua në shenjë proteste me një ton të revoltuar i thotë komandantit grek: Vendimi që keni marrë për të internuar parinë e këtij fshati nuk është i drejtë. Juve jeni të huaj, sot jeni këtu, nesër shkoni, ndërsa ne kemi rrojtur e rrojmë bashkë me ta. Ne nuk duam që gjynahet tuaja ti paguajmë ne¹⁰.

Mesazhi që përcillinin fjalët e Kristo Pitulit ishin të qarta: një perspektivë e zymtë vërtitej në hapësirën çame për minoritetin shqiptar që kanoste shkatërrim e derdhje gjaku të njerëzve të pafajshëm¹¹.

Gjatë shpërnguljes me dhunë të popullsisë çame nga trojet e tyre nën kërcënimin për jetën një ndër çamët që ndiqej ishte edhe Hizder nga paria e Grikohorit. Në një mbrëmje këtij i ishte stisur një komplot i dhunshëm për ta marrë peng kundrejt një shume të Ahmeti madhe. Ishte pikërisht një bashkfshatari i tij i krishterë, Strati Vrasi që informoi me anën e të shoqes së tij, që të mos dilte nga shtëpia se një rrezik i madh e priste.

10. J. Sarros Istorja tis perhios IGOUMENITSIS 1500-195, Athinë, 1985, faq.617.

11. Shih për më shumë hollësi, H. Isufi, vep. e përmendur, faq.182

Fal ndërhyrjes së këtij miku të krishterë që në çaste të vështira iu gjend pranë Hizder Ahmetit dhe i shpëtoi jetën nga vdekja e sigurtë. Shumë prej këtyre fakteve nuk i gjejmë të shkruara në dokumente historike, por në dëshmitë e njerëzve, që përbëjnë një burim autentik që hedhin dritë në lidhjet e vjetra e të reja shpirtërore midis çamëve myslimanë e të krishterë në Çamëri.

Çamët myslimanë në mbrojtje të krishterëve.

Sprova e madhe e marrjes në mbrojtje të krishterëve nga myslimanët çamë, u manifestuan fuqishëm në vitet 1941-1944. Më 6 prill 1941 Gjermania naziste sulmoi Greqinë dhe më 9 prill pushtoi Selanikun. Ndërkohë armata e Epirit shkëputi kontaktet me forcat italiane natën e 13-14 prillit. Më 21 prill 1941 në Larisa u nënshkrua akti i armëpushimit ndërmjet Komandantit të Korporatës së Dytë Greke dhe gjermanëve, ndërsa më 23 prill u nënshkrua protokollin i pushimit të rezistencës së ushtrisë greke dhe kapitullime pa kushte i Greqisë¹². Në maj të atij viti u bë e mundur nga gjermanët lirimi i masës së burrave çamë, që ishin internuar nga qeveria greke. Kthimi i burrave çamë nga internimi, u përball me dhimbje e vështirësi të mëdha. Ata gjetën shtëpitë të plaçkitura, bagëtitë të rrëmbyera, gra e vajza të përdhunuar, pjestarë të familjeve të vrarë, si dhe përballimin e vështirësive ekonomike.

Të krishterët prisnin që çamët të hakmerreshin, por çamët myslimanë, shkruan një historian grek, Niko Ziagos, me logjikë dhe mençuri, nuk ju drejtuan kurrë mërisë dhe hakmarrjes ndaj të krishterëve të pafajshëm¹³. Ky historian grek historinë e marrëdhënieve të çamëve mysliman ndaj të krishterëve, gjatë pushtimit fashist të Greqisë, e ka parë dhe vlerësuar mbi bazën e të vërtetave të pamohueshme dhe mbi këtë bazë ai ka arritur në konkluzionin absolute:

“ Sikur shqiptarët çam të ishin vrasës dhe kriminelë, do të ishin zhdukur të gjitha fshatrat myslimanë”¹⁴ përkundrazi, vazhdon më tej i njëjti autor, fshatarët e fshatit Varfaj dhe fshatit Slice, shkuan në fshatin e krishterë të Kastrizes të Gumenicës për t, u kërkuar të krishterëve, në mënyrë paqësore, gjënë dhe plaçket që u kishin grabitur.¹⁵

Në pranverën e vitit 1943 situata politike në Çamëri u acarua së tepërmi. Elementi keqbërës qoftë mysliman, qoftë i krishterë, doli sheshit.

12. Lufta Italo – Greke, 1940-1941, Tiranë 1977, faq.183.

13. Nik.G. Zvagkos, Anglikos- Imperializmos kai Ehniki Andistasi, vëll. I, faq. 138.

14. Po aty faq.146.

15. Po aty faq.138.

Bandat greke vrisnin njerëz të pafajshëm, grabisnin e vritnin myslimanë rrugës. Por edhe nga elementi myslimanë nuk mungonin individë të veçantë, që ndërmerrnin sulme grabitjesh ndaj të krishterëve.

Në këto rrethana as elementi i shëndoshë i krishterë, as paria e fshatrave myslimanë nuk pajtohej me ato veprime të dhunshme, që ishin të huaja dhe të papëlqyeshme në marrëdhëniet mes dy komuniteteve në Çamëri¹⁶. Në maj të vitit 1943, fshati Kastri u sulmua nga disa individë çam për hakmarrje ndaj të krishterëve, që kishin kryer grabitje e reprezalje ndaj familjeve myslimane. Pleqësia e krishtere të parisë së fshatit, përballë rrezikut që kërcënonte fshatin dhe fshatarët, kërkuan ndihmën e parisë myslimane të Varfanjit, Salicës, Grikohorit, Graves etj. Paria e fshatrave myslimane iu përgjigj menjëherë kërkesës për ndihmë dhe menjëherë në ndihmë të fshatrave të kastrizës shkuan me dhjetra çamë të armatosur të drejtuar nga njerëit më më zë të kazasë së Gumenicës si Bido Taho, Nazif Vejseli, Alush Ziguri, Isuf Izeti nga Varfanj, Hizder Ahmeti dhe Adem Idrizi nga Grikohori nga Salica, Mulla Demiri, Ali Hajro e Refat Ruska. Këtyre iu nënshtrua edhe Mehmet Abazi nga Shulashi dhe nga Spatari Selman Izet (Kushi)¹⁷.

Në ato ditë të trazuara shumë fshatarë myslimane çamë morën në mbrojtje në shtëpitë e tyre individë e familje të krishtera duke iu afruar mbrojtje dhe bujari për javë të tëra¹⁸. Le të përmendim disa prej tyre: Rexhep Hasani, mori në shtëpinë e tij në mbrojtje: Pilo Dhimën, Ilia Dashin e Thoma Dadon nga fshati Kastri, Avdul Nurçja nga Spatari mori në mbrojtje në shtëpinë e tij: Aleks Athanasin e Gogo Gjeorgjiun e shumë të krishterë të tjerë, duke iu afruar besë e bujari për javë të tëra¹⁹. Të njëjtën gjë bëri edhe Selman Izet Kushi nga fshati Spatar, që strehoi për disa muaj të krishterët e një gjaku nga Kastria. Koço Gjika nga fshati Skupicë (Sajadhë), që ndiqej për hakmarrje nga disa çam mysliman, por që ishte i pafajshëm, i doli në mbrojtje Rustem Izetit nga fshati i Koskës²⁰ Xhevis Isufi (Ibrahimi) në fshatin Rrezanj duke e marrë në mbrojtje të krishterin nga Grikohori, Strati i Vrisit, i shpëtoi jetën: Mehmet Abazi nga Shulashi mori në mbrojtje Jani Sharrën nga Kastriza dhe më pas e përcolli jashtë rrezikut, në fshatin Pleshovicë²².

Kur flitet për çamër që u janë ndodhur pranë të krishterëve në ditët më të vështira, nuk duhet lënë pa përmendur edhe Sali Meton (Qemalin) nga Njihori. Ai iu ndosh pranë shumë miqve të tij të krishterë si Mitro Kiços nga fshati Peshtan, etj.

Mund të mbushja faqe të tëra me episode të kësaj natyre, dhe nuk është e tepërt ti përmend, por u kufizova në disa prej tyre²³.

22. Shih për më shumë hollësi, H. Isufi, Çamërinë, vep. e përmendur, faq 231-302.

23. Nik.G. Zvagkos, Imperializmos, vep. e përmendur, vëll.4,faq.199.

Rreth problemit që trajtojmë e shoh me interes të theksoj edhe një episod që më duket se ja vlen si një ngjarje që konkretizon më së miri temën që po shtjellojmë. Në vitin 1943, 24 fshatrat e Frarit, zbarkonin armë e municion për forcat e EDES-it të Napoleon Zervës, që sulmonte forcat gjermane. Tërë banorët e fshatrave të Frarit të frikësuar, braktisën shtëpitë e tyre dhe morën përpjetë maleve të Sulit për të shpëruar jetën nga sulmet e gjermanëve të egërsuar. Në malet e Sulit, familjeve të krishtera, që kishin ikur me ç’kishin veshur, u mungonte edhe buka, edhe strehimi, edhe veshja. Banorët pleq të fshatrave të Frarit më kanë treguar me gojën e tyre se uria po i sfiliste dhe vdekja merrte çdo ditë jetë njerëzish të uritur e të sëmurë.

I vetmi ushqim për të mbijetuar ishin barishtet, që mblidheshin nëpër pyje e aheshin të gjalla se s’kishin as enë për t’i zier.

Në ato ditë mjerimi për të krishterët frariotë, të habitur, i dolën përpara karvanit dhe shumë shpejt mësuan se ishin të ngarkuara me miell misri dhe ishin dërguar nga Avdulla agai i Margëllëçit, për tu ardhur në ndihme në ato ditë të vështira të krishterëve. Kjo histori, që shpreh dashuri, respekt dhe humanizëm të myslimanëve ndaj të krishterëve kujtohet edhe në ditët tona në pleqtë e fshatrave të Frarit që i kanë jetuar ato kohra të trazuara..

Xhesti fisnik i agait të Margëllëçit bëhet edhe më domethënës, pot ë kemi parasysh se dy vjet më parë, në vitin 1941, Avdulla Agait bandat greke i kishin vrarë vëllain e tij, Jahjain, tek pinte kafe në një nga lokalet në Paramithi.

Me të , duke vazhduar për marrëdhëniet e myslimanëve me të krishterët, do të ndalem edhe në ndodhi tepër interesante që mësojmë nga një burim grek: Ngjarja që trajtohet ka ndodhur në fshatin Arpicë më ditët e fundit të qershorit 1944, fill pas masakrës ç’njerëzore që bënë bandat e Napoleon Zervës kundër familjeve të pafajshme të shqiptarëve në Paramithi.

Fshati Arpicë ishte një fshat i përzier me familje myslimane e të krishtera. Epërsinë numerike të familjeve në fshat e kishin familjet myslimane shqiptare. Të dy komunitetet ishin në harmoni dhe në bashkjetesë për tu admiruar.

Arpiciotët thuhet në burimin që i referohemi kishin lidhur beslidhje me të krishterët e Pargës që në çdo kohë do të ishin në mbrojtje e në përkrahje të njëri – tjetrit, dhe ajo marrëveshje kishte funksionuar mëse korrekte nga të dy palët derin në 8 qershor 1944.

Por fill pas masakrës së Paramithisë, arpiciotët ndërmorën disa veprime që në rrethet e krishtera të Pargës u krijua bindja se arpiciotët kishin tradhëtuar marrëveshjen (Simfoninë) me parganjotët.

Ajo që parganjotët e quanin tradhëti e shkelje të marrëveshjes nga ana arpiciotëve ishte për ta se nuk i kishin filluar “ hakmarrje” në

shenjë të asaj që kishte ndodhur në Paramithi. Shkak për këto mendime në rrethet e krishtera të Pargës ishte bërë se më 28 qershor 1944 çamët myslimanë të Arpicës morën disa masa për të krishterët e fshatit të tyre: gjashtëdhjetë burrat e krishterë që kishte fshati i mbyllën në kishën e Shën Jorgjit, ndërsa gratë vajzat dhe fëmijët i sistemuan në shtëpinë e Jorgo Zografos. Parganjotët e krishterë, sapo mësuan këtë masë që kishin ndërmarrë myslimanët arpiciotë menduan se ai veprim binte erë hakmarrje....

Kryetari i parisë së këshillit të krishterë të Pargës, Theodhori Kosta hyri në bisedime me parinë myslimane të Arpicës, dhe u kërkoi shpjegim për veprimet që kishin ndërmarrë ndaj të krishterëve të Arpicës. Paria e të krishterëve të Pargës, njëkohësisht dërgoi në fshatin Arpicë dy myslimanë parganjot, Omer Buqin dhe Abaz Shuaipin që të hynin në bisedime me pleqësinë e fshatit të Arpicës për fatin e të krishterëve të izoluar. Dy myslimanët parganjotë që në kontaktet e tyre të para që patën me parinë e Arpicës mësuan së ajo masë që ishte marrë, kishte për qëllim mbrojtjeje nga elementë të veçantë myslimanë, që kërkonin të hakmerreshin ndaj tyre për ato masakra që ishin kryer në Paramithi ndaj myslimanëve²⁴.

Historiani grek konsideron veprimin që ndërmorrën arpiciotët “ si një shprehje të hapur të dashurisë së atij komuniteti ndaj të krishterëve, si në kohë qetësie ashtu në kohë të trazuara mes myslimanëve të Arpicës dhe të krishterëve”²⁵.

Autori i këtyre shënimeve nuk mjaftohet vetëm më trajtimin e lidhjeve të shëndosha që kishin myslimanët me të krishterët, po shkon edhe më tej duke i treguar lexuesit të veprës së tij vlerat e mëdha që kishin çamët e Arpicës:

“ Ndërmjet myslimanëve të Arpicës kishte shumë njerëz besnikë e paqësor dhe e kishin për zakon ta mbanin fjalën, kur e jepnin, gjë që nuk ndodhte e njëjta gjë me krishterët”²⁶.

Niko Zhango në veprën e tij shpreh edhe një brengë që me sa duket e lëndon shumë kur thotë se të krishterët kur erdhi rasti i fundit nuk e mbajtën marrëveshjen dhe nuk u kujtuan për mbrojtjen e myslimanëve të Pargës...²⁷ dhe të Margëllëçit²⁸.

Përfundimi logjik i këtyre episodeve, edhe pse të pjesshme, shprehin karakterin e fortë të myslimanëve shqiptar në Çamëri në marrëdhëniet korrekte me të krishterët. Është për të ardhur keq se qeveria greke nuk i respekton shtetasit e vetë, me kohë që të krishterët çamë i kujtojnë me respekt e nderim deh nuk i harrojnë kurrë nderet dhe të mirat që kanë patur prej tyre. Këto lidhje vazhdojnë të jenë të gjalla edhe në ditët tona.

23. Po aty.

24. Po aty.

25. Po aty.

26. Po aty.

27. Po aty, faq. 199.

Prof. dr. Ferit DUKA

**SUNDIMI OSMAN NË TREVËN E ÇAMËRISË:
KAZATË E AJDONATIT DHE MAZRAKUT
(Gjysma e dytë e shek. XVI)**

Është e ditur se ndriçimi i periudhës osmane të historisë së shqiptarëve nuk ka pushuar së qeni një sfidë reale për studiuesit. Me gjithë arritjet e shënuara nga historiografia në këtë fushë të rëndësishme të studimeve, ende mbetet shumë për t'u bërë, veçanërisht kur është fjala për areale të caktuara për të cilat njohuritë e deritanishme ose janë të zbehta ose mungojnë fare.

Në një raport të tillë të pajustificueshëm me studimet historike qëndrojnë edhe viset e Çamërisë gjatë shekujve të parë osmanë (shek. XV-XVI). Rrethana të tilla janë të mjaftueshme për të nxitur studiuesit e periudhës osmane që ta kthejnë vështrimin drejt Çamërisë, këtij areali sa interesant aq edhe të rëndësishëm. Kjo është arsyeja që edhe ne, nëpërmjet kësaj trajtесе, zgjodhëm të përqëndrohemi në shqyrtimin analitik të disa aspekteve thelbësore të gjendjes politike dhe ekonomiko-shoqërore të dy prej krahinave kryesore të Çamërisë: Ajdonatit (Paramithisë) dhe Mazrakut (Mazrekut, Mazarakut).

Fillimisht duhet të vemë në dukje se analizat dhe vlerësimet tona rreth këtij subjekti do të kufizohen kohësisht në gjysmën e dytë të shek. XVI, gjë që diktohet nga gjendja reale e burimeve osmane të disponueshme nga ne deri në momentet që po kryhet ky studim.

*

* *

Krahinat e Ajdonatit (Paramithisë – F.D.) dhe Mazrakut (Mazarakut, Mazrekut) pas vendosjes së sundimit osman në Çamëri u përfshinë në juridiksionin e sanxhakut të Janinës. Nga pikëpamja administrative ato formonin dy kaza homonime, të cilat aty rreth mesit të shek. XVI (v. 1550-1551) kaluan në përbërje të sanxhakut të ri të Delvinës. Sanxhaku në fjalë u krijua rishtas nëpërmjet bashkimit të tokave jugperëndimore të Shqipërisë, të cilat u shkëputën përkatësisht nga sanxhakët e Janinës dhe të Vlorës. Krijimi i këtij sanxhaku duhet të jetë nxitur nga nevojat e shtetit osman për stabilizimin e qeverisjes së tij në këto pjesë të territorit shqiptar të tronditur jo pak herë nga kryengritjet e popullsisë vendore, veçanërisht në krahinat e Kurveleshit dhe të Himarës⁴⁶.

Me sa duket, menjëherë pas këtij ndryshimi të natyrës administrative, shteti osman kreu regjistrimin e hollësishëm të vitit 1551 në sanxhakun e Delvinës⁴⁷. Në këtë kuadër janë regjistruar edhe vendbanimet çame të kazave të Ajdonatit dhe Mazrakut⁴⁸.

⁴⁶ F. Duka, *Fasada bregdetare e Shqipërisë osmane*, “Studime historike”, 2004 (3-4), Tiranë, 2004, f.10.

⁴⁷ *Istanbul Ba bakanlık Osmanlı Ar ivi (më tej: BOA), Tapu Tahrir Defterleri*, Defter-i mufassal-i livai-i Delvine, nr. 273.

⁴⁸ *Po aty*, f. 137-244.

Mbi tridhjetë vjet më vonë, sanxhaku i Delvinës i është nënshtruar një regjistrimi të ri i cili ka gjetur pasqyrim në defterin e hollësishëm osman të vitit 1583 (viti hicri 991)⁴⁹. Në të vërtetë, asgjë nuk ka ndryshuar përsa i përket të kazave të Ajdonatit dhe Mazrakut, përveç ndryshimit të emërimit, dmth se tashmë nuk quhen më “kaza” por “nahije”. Një shqyrtim i vemendshëm i të dhënave të këtij defteri nxjerr në pah faktin se nahija e Ajdonatit përfshinte një numër të madh vendbanimesh: 91 fshatra, qytetin e Ajdonatit (më vonë është quajtur *Paramithi*), si dhe qytezën e Ozdinës.

Në morinë e vendbanimeve çame të regjistruara në defterin e mësipërm, shquhet **qyteti i Ajdonatit**. Në vitin 1583 qyteti në fjalë numëronte rreth 600 shtëpi të ndara në shtatë mëhallë (lagje)⁵⁰. Mëhallët e qytetit mbanin emra të tillë si Paramita, Paskal, Shën Parashqevia, Çezma, Murkia (Morfia), Murkotelo dhe Agjitopullo. Sipas mëhallëve, popullsia e Ajdonatit ishte e ndarë në këtë mënyrë: lagjja *Paramita* figuron në defter me 91 shtëpi dhe 43 beqarë (rreth 700 banorë, në se një shtëpi e marrim të barabartë afërsisht me 7 banorë); në mëhallën *Paskal* janë regjistruar 46 shtëpi dhe 6 beqarë (rreth 330 banorë); mëhalla *Shën Parashqevi* paraqitet e regjistruar me 125 shtëpi dhe 25 beqarë (rreth 900 banorë); mëhalla *Çezëm* me 103 shtëpi dhe 36 beqarë (rreth 760-800 banorë); mëhalla *Murki (Morfi ?)* me 66 shtëpi dhe 30 beqarë (rreth 500 banorë); mëhalla *Morkotello* me 57 shtëpi dhe 23 beqarë (rreth 430 banorë) si dhe mëhalla *Agjitopullo* me 91 shtëpi dhe 26 beqarë (rreth 660 banorë). Gjithsej qyteti i Ajdonatit duhet të kishte një popullsi prej rreth 4500-5000 banorë.

Një tjetër vendbanim i rëndësishëm i kazasë së Ajdonatit ishte edhe **qyteti i Ozdinës**⁵¹. Ashtu si Ajdonati, edhe qyteti në fjalë përbëhej në këtë kohë nga shtatë mëhallë të emërtuara në këtë mënyrë: Çajërli (Çabirli?), Stara, Sotira, Shën Nikolla, Neksarhia, Tepama (?) dhe Shën Dhimitri. Megjithatë, në pikëpamje demografike, qyteti i Ozdinës regjistron popullsi më të pakët në numër se sa Ajdonati. Sipas përlllogaritjeve të bëra mbi bazën e të dhënave të defterit në shqyrtim, numri i përgjithshëm i banorëve të qytetit arrinte në rreth 2 800 vetë.

Në mënyrë më të detajuar, sipas mëhallëve, popullsia e kësaj qyteze çame paraqitet e tillë:

Nr.	Mëhallët	Nr. i shtëpive	Nr. i beqarëve	Nr. i përafërt i banorëve
1.	Çajërli (Çabirli ?)	23	1	170
2.	Stara	23	5	180
3.	Sotira	37	6	270
4.	Shën Nikolla	83	9	600

⁴⁹ *Ankara Tapuve Kadastro Genel Müdürlüğü ü Ar İvi, Defter-i mufassal-i liva-i Delvine*, nr. 91, viti 991/1583.

⁵⁰

⁵¹ Po aty, f. 86-87. Janë bërë rumbullakime të lehta të shifrave të banorëve duke pasur parasysh se një pjesë e vogël e popullsisë qytetare, kryesisht fisnikëria, nuk është regjistruar në defterin e sipërpërmendur, pasi nuk bënte pjesë në masën e popullsisë taksapaguese.

5.	Neksahria	77	13	560
6.	Tehama (?)	64	-	450
7.	Shën Dhimitri	66	11	480

Veç kryefamiljarëve dhe beqarëve të regjistruar sipas mëhallëve të qytetit të Ozdinës, janë regjistruar më vete 12 kryefamiljarë dhe beqarë me statusin e *myselemëve*, d.m.th. të popullsisë së përjashtuar nga taksat kundrejt shërbimeve të caktuara⁵². Po ashtu, ndryshe nga qyteti i Ajdonatit, për qytetin e Ozdinës, defteri i Delvinës regjistron pesë kisha dhe pikërisht: kisha e Sotirës, kisha e Tepamës (?), kisha e Shën Thanasit, kisha e Avramit (?) dhe ajo e Melanakijas(?)⁵³.

Edhe vendbanimet rurale të nahijes së Ajdonatit paraqiten përgjithësisht me një dendësi popullore të konsiderueshme. Shumë syresh e tejkalojnë numrin e 50 shtëpive. Si të tilla mund të përmenden fshatrat Katune, Karbunarë, Arxhes, Curila (100 shtëpi), Vreniko, Suli (181), Verosina (149), Turkopaloko (100), etj.

Në dallim nga nahija e Ajdonatit, ajo e Mazrakut në vitin 1583 kishte më pak vendbanime në juridiksionin e vet, gjithsej 40 syresh. Midis tyre nuk shihet të jetë regjistruar asnjë qendër urbane. Një veçori tjetër dalluese e nahijes së Mazrakut është fakti se në krahasim me vendbanimet e nahijes së Ajdonatit, vendbanimet e kësaj nahijeje kanë përgjithësisht popullsi më të pakët. Kështu p.sh. një nga fshatrat e nahijes së Mazrakut, Margëlliçi, sipas defterit në fjalë, nuk kishte veçse 10 shtëpi.

Nëse krahasohen të dhënat demografike të defterit osman të vitit 1583 me ato të defterit të vitit 1551 shihet se ndryshimet në numrin e popullsisë së vendbanimeve të nahijeve të Ajdonatit dhe Mazrakut në rrjedhën e më se tri dekadave janë të konsiderueshme vetëm për një pjesë të tyre, ndërsa për pjesën tjetër të tyre ndryshimet ose janë të vogla, ose janë në sensin negativ, dmth, se në vitin 1583 disa vendbanime regjistrojnë rënie për nga numri i popullsisë në krahasim me vitin 1551. Për të krijuar një ide më të plotë në lidhje me këtë çështje, në tabelën e mëposhtme ne po i paraqesim në trajtë të detajuar të dhënat e regjistrimeve për popullsinë sipas vendbanimeve përkatëse të kryera në vitet e lartpërmendura.⁵⁴

⁵² Për këtë kategori të popullsisë në shekujt e parë të sundimit osman më gjërësisht shih: H. Inalcik, 835 tarihli *suret-i defter-i sancak-i Arvanid*, Ankara, 1987 (bot. i dytë), f. XIII, XV, XVI-XVII.

⁵³ *Defter-i mufassal-i liva-i Delvine*, Nr. 91, f. 87/b

⁵⁴ Tabela është kompozuar me të dhënat e përfuara nga *defteri i hollësishëm osman i vitit 1551* (kazaja e Ajdonatit: f. 137-212 dhe kazaja e Mazrakut: f. 213-244), si dhe *defteri i hollësishëm i vitit 1583* (nahija e Ajdonatit: f. 76-112 dhe nahija e Mazrakut (f. 114-128)

Popullsia e kazasë (nahijes) së Ajdonatit

Nr.	Vendbanimet	Viti 1551		Viti 1583	
		Shtëpi të krishtera	Shtëpi myslimane	Shtëpi të krishtera	Shtëpi myslimane
1	Radoniz	41		30	
2	Katune	55		60	
3	Visoka ose Alsardha	23		30	
4	Labanica	7		20	
5	Karburnara (e quajtur ndryshe Gjon Gjeta ?)	85		100	
6	Grazhdani	44		40	
7	Mazhani	212		100	
8	Muzhakat	29		15	
9	Agjitopullo	74		50	
10	Agjeliqi	24		20	
11	Petrokalin (mezra)	20		15	
12	Ajdonati (nefs – qytet)	470		600	
13	Volaiti	17		25	
14	Malun	40		40	
15	Granica	23		25	
16	Vreniko	30		25	
17	Curila	260		100	
18	Fsh. Vetë Ozdina	244		344	
19	Myselemë të zëvendësuar (müselleman-i mensuh)	12		12	
20	(I) Vreniko i Madh dhe (1) Vreniko i Vogël	40*		60	
21	Orvid ose Karoan	-		49	
22	Suha ose Sushi	35		45	
23	Palasa ose Sevasto	8		14	
24	Gllloboçjar (mezra)			-	
25	Alesja (Alista ?)	22		32	
26	Kisha e Luganit (Potjanit)	-		-	
27	Kisha e Qiries	-		-	
28	Suli	210		180	3
29	Longjon Katuna (Petro Komile)	33		20	
30	Verosina	110		139	
31	Veremo Nikadhi	13		14	
32	Mazhi (Madhi)	15		15	

* Fshati (I) Vreniko është shënuar edhe në f. 159 (nr. 152) të def. Nr. 273, v. 1551. Ndërsa këtu (në f. 167) shënohet si fshati (I) Vreniko i Madh që përfshin edhe një mëhallë të emërtuar “Vreniko i Vogël”. Me këtë rast theksojmë gjithashtu se regjistruesi osman përpara emrave që në fillim të tyre kanë dy bashkëtingëllore njëra pas tjetrës, ka vendosur një “P” për lehtësi shqiptimi. Ky është një rregull fonetik i gjuhës turke. “P”-në fillestare të lartpërmendur ne e kemi vendosur në kllapa për të nxjerrë në dukje trajtën origjinale vendase të emrit.

33	Valanidhja	18		15	
34	Turkopaloko	50		100	
35	Medika	-		120	
36	Kariot	70		60	
37	Mezra-ja e Astorit	-		20	
38	Petrovicë	47		-	
39	Popova	80		85	
40	Stergonit ose (I) Spatradha ?	20		10	
41	Qeresta (Kreshta)	-		4 (neferë)	
42	Kotro (Kutero ?)	6		7 sht.	
43	Lugani	79		81	2
44	Dragomi	80	5	120	
45	Shëndëlli ose Lefterhor	18		30	
46	Karbunar ose (I) Skura	25		30	
47	Karbunara (tjetër) ose Mikal	24		20	
48	Kozun	6		9	
49	Kokuçe ose Pangrat	-		9	
50	Pelesh	37		20	
51	Selanik	22		18	
52	Vojnuka (Vojnika)			8	
53	Revanid ose Alsardha			36	
54	Kumilla ose Huntaçara	21		37	
55	Kondat	24		63	
56	(I) Skandal, (I) Skandil (1551)	40		96	2
57	Gardhiq	80		23	
58	Shalesh	21		42	
59	(I) Flakohor (Vlakor)	11		74	
60	Gorovania	40		74	
61	Zagoria	20		23	
62	Lalidha	10		19	
63	Usteniq ose Sulka (Puthuleka)	10		15	
64	Kerasovë	60		61	

65	(I) Sterganicë	12		13	
66	Apano Zalongo (Zalongo i Sipërm)	20		20	
67	Kato Zalongo (Zalongo i Poshtëm)	35		48	
68	Duvera	14		26	
69	Naribon	9		12	
70	Zaraveci i Madh	22		24	
71	Zaraveci i Vogël	8		4	
72	Haliqadhes	28		25	
73	Pradela	60		31	
74	Koprita (Koprina ?)	32		30	
75	Romanat	18		32	
76	Strun (Pastron ?) i Madh	71		83	
77	Struni i Vogël	20		30	
78	Markopulo i quajtur ndryshe Gllavica	84		60	
79	Liviacovë	60		84	
80	Livikestra	70		79	
81	Koristiani (Karistiani ?)	102		110	
82	Anamica	20		25	
83	Gonia (Gojna)	24		23	
84	Odan (?) i quajtur ndryshe Dumolesa	25		38	1
85	Ristil			18	
86	Draguçi me mezra në Kunaq	52		49	
87	Gjurkani	25		25	
88	Ropalat	2		3	
89	Gramatiko ose Kukli	51		81	
90	Dhomeniko	19		28	
91	(I) Psardha e Madhe	85		103	
92	(I) Psardha e Vogël	78		82	
93	Zeleso	60		72	
94	Veliani	56		63	
95	Mazhani [ose (I) Stanova]	29		25	
96	Paskal Seliani	110		156	

Popullsia e nahijes së Mazrakut

Nr.	<i>Vendbanimet</i>	Viti 1551		Viti 1583	
		Shtëpi të krishtera	Shtëpi myslimane	Shtëpi të krishtera	Shtëpi myslimane
1	Bihorishta	24		30	
2	Margëlliçi (Margariti)	14		10	
3	Gorma	32		25	
4	Arila	80		50	
5	Radojana (Zadojana ?)	108		50	
6	Vela	72		27	
7	Zeri (Dheri ?)	38		26	
8	Murkia	4		4	
9	Lavadar	28		20	
10	Agallar (shenjtorët - F.D.)	100		60	
11	Arvanica (Arvenica ?)	65		50	
12	Nutesh (Tutesh ?)	34		54	
13	Kondoishari	52		40	
14	Shanica (më vonë Senica - F.D.)	88		100	
15	Zemeri ose Grikohori	74		50	
16	Kurtes	74		70	
17	Nikolica	60		50	
18	Dragani i Madh	40		49	2
19	Kaiua	16		27	
20	Dragani i Vogël	34		61	
21	Kurjani	76		73	3
22	Madhe (Nadhe ?)			35	
23	Arsekala (?) ose (Stojan)	84		139	
24	Samotase (Samonase ose Simonase ?)	45		40	
25	Gjrkupar (Gjorkumer, Gjorkunar)	6		72	
26	Korshovicë	31		24	
27	Dobra	100		80	
28	(I) Smokovina	38		37	
29	Krushovica ose Thoma Milica	15		10	
30	Gllboçar	18		22	

31	Koleshta ose Memli Leka	18		24	
32	Peshtani	30		30	
33	Kuçi me myselemët e mëparshëm	28		23	3 *
34	Bunadis (Tomadhes, Bumadhes ?)	34		40	
35	Dukavarfëri (mund të jetë fjala për Dugaratin - F.D.)	21		20	
	Bihorkukli (?) ⁵⁵	70			
	Prodan (Borodan ?)	20			
	Baze (Jaze ?)	40			
	Karaglina	7			
	Biluç (Niluç, Biloç, Niloç ?)	11			

Sikundër shihet nga pasqyra e mësipërme, vendbanime të tilla si Radonizi, Arxhesi (Ardhësi?), Mazhani, Muzhakati, Curila, Suli, Petrovica, Stergoniti, Peleshi, Markopulo, Arila (nah. Mazrakut), Radojana, Vela, Dheri, Murkia, Ajallari (Shenjtorët), Arvanica, Kondoishari, Zemer (Grikohori), Nikolica, Dobra, etj., në harkun e viteve 1551-1583 shënojnë rënie të ndjeshme të numrit të popullsisë. Ndërkohë, vendbanime të tjera si Karbunara, Suha, Verosina, Turkopaloko, Dragomi, Shëndëllia, Kondati, Skandali, Gardhiqi, Flakohori, Gorovanica, Lalidha, Romanati, Liviaçova, Nuteshi (nah. Mazrakut), etj., shfaqin rritje të theksuar të popullsisë në harkun kohor të lartpërmendur. Ajo që bie në sy gjatë kundërimit të tabelës së lartpërmendur është fakti se dy qendrat urbane, Ajdonati dhe Ozdina, në të njëjtin segment kohe regjistrojnë një shtim befasues të numrit të popullsisë. Kështu psh, ndërsa në vitin 1551 Ajdonati numëronte 470 shtëpi, në vitin 1583 numri i shtëpive të qytetit në fjalë arrinte në 603 syresh, ndërkohë që nga 244 shtëpi që kishte më 1551, në vitin 1583 popullsia e Ozdinës arrinte në 344 shtëpi. Në të kundërt, një nga qendrat e njohura sikurse është Margëlliçi, nga pikëpamja demografike, në gjysmën e dytë të shek. XVI, renditej midis vendbanimeve me popullsinë më të pakët (14 shtëpi më 1551 dhe 10 shtëpi më 1583). Kështu psh, në defterin osman të vitit 1551 fshati Margëlliç regjistrohet si has i kreut të sanxhakut të Delvinës, me 17 individë, nga të cilët 14 syresh ishin kryefamiljarë dhe 3 të tjerë ishin beqarë: Duka Brun-i, (I) Spani Deda, Gjon Ilia, Qesar Dhima, Menksh Leka, Tupe (Popa) Todr-i, Gjin Jorga, Popa Brush-i, Gjin

* Regjistruesi duhet të ketë gabuar në këtë rast, pasi nga përlllogaritja del që numri i shtëpive të fshatit duhet të jetë 37.

⁵⁵ Fshatrat Bihorkukli, Prodan, Baze, Karaglina dhe Biluç, nuk i kemi gjetur të regjistruar në defterin osman të vitit 1583. Në lidhje me këtë mund të mendohet se fshatrat në fjalë ose kanë ndërruar emrat, ose nuk ekzistojnë më.

Gjon-i, Gjon Jani, Andria Qesar-i, Gjin Popa (Tope), Jani Nika, Papa Mihal-i (b), Gjon Shorri, Gjon Nika (b).⁵⁶

Me interes të veçantë është edhe shqyrtim i antroponimisë së vendbanimeve të këtyre dy njësive administrative të Çamërisë. Duhet theksuar se ajo është e njëjtë për nga karakteri me atë të viseve të tjera shqiptare. Këtë pohim e mbështet para së gjithash fakti se popullsia e kësaj treve mbart emra karakteristikë shqiptarë si Gjin, Gjon, Lekë, Pal, Dedë, Gjike, Gjokë etj.

Nga ana tjetër, antroponimia ortodokse e popullsisë çame është e pranishme në variantin shqiptar të saj. Madje në shumë raste shumë elementë të kësaj antroponime janë të shprehura në trajtat e saj të krishtera të Shqipërisë veriore dhe qendrore. Kështu p.sh. rëndom hasen emra të tillë si *Nika* (në vend të *Niko*), *Lazër* (në vend të *Llazar*), *Kond* (në vend të *Kondo*), etj.

Hulumtimet në dy burime relevante të gjysmës së dytë të shek. XVI sikundër janë defterët osmanë të lartpërmendur, japin një mundësi të shkëlqyer për të nxjerrë përfundime të drejta edhe në lidhje me gjëndjen fetare të trevës së Çamërisë rreth dy shekuj pas vendosjes së sundimit osman. Nga ky këndvështrim, popullsia e kësaj treve, ndryshe nga shumë treva të tjera shqiptare, spikat për ruajtjen deri aty nga fundi i shekullit XVI të përkatësisë fetare të krishterë, duke manifestuar raste të rralla të kalimeve në islam. Madje edhe popullsia e qytetit të Ajdonatit, sipas të dhënave të regjistruara në defterin e vitit 1583, paraqitet në shumicën e vet dërrmuese popullsi e besimit të krishterë. Vetëm në ndonjë mëhallë ndeshen rrallë banorë të islamizuar. Kështu p.sh. në mëhallën Paskal janë regjistruar tre kryefamiljarë të sapoislamizuar: *Jani Abdullahu*, *Ali Abdullahu* dhe *Uruç Abdullahu*.⁵⁷ Këtë e tregon mbiemri “*Abdullahu*”, të cilin, sikundër është pranuar në studime të ndryshme osmanistike, e mbanin persona që e kishin përqaftuar rishtas fenë islame. Po të shihen me kujdes edhe vendbanimet e tjera si të nahijes së Ajdonatit ashtu edhe asaj të Mazrakut, bëhet e qartë se islamizimi ishte një dukuri ende e papërfillshme për krahinat çame të kësaj kohe.

⁵⁶ *Defter-i mufassal-i liva-i Delvine*, Nr. 273, f. 214

⁵⁷ *Defter-i mufassal-i liva-i Delvine*, Nr. 91, f. 81/a